

# Lialona



**Vetëm Ai Mund të Bëhet  
Shpëtimtari Ynë, f. 8**

Çfarë të Vërtetash Mësojmë rreth  
Trupit nga Ringjallja? f. 14

Të Gjesh Liri prej Peshës së Rëndë  
nga Abuzimi Seksual, f. 22

Njihe Armikun Tënd: Si t'u Bësh Ballë  
Katër Strategjive të Satanit, f. 30



*Punëtorët vendosin një tabelë te sheshi i ndërtimit të Tempullit të Bernës në Zvicër. Tempulli që përkushtuar në shtator 1955 nga Presidenti Dejvid O. Mek-Kei. Që tempulli i parë i ndërtuar jashtë Amerikës së Veriut dhe i pari ku u dhanë ordinancat në një gjuhë që s'ishte anglisht.*

Fotografi me mirësinë e Bibliotekës së Historisë së Kishës



## MESAZHET

- 4 Mesazhi i Presidencës së Parë: I Drejti do të Jetojë me Anë të Besimit**  
Nga Presidenti Diter F. Uhtdorf
- 7 Mesazhi i Vizitave Mësimore: Betimi dhe Besëlidhja e Priftërisë**



**NË KAPAK**  
*Tri Maritë të Varri*, nga William-Adolphe Bouguereau

## ARTIKUJT KRYESORË

- 8 Shlyerja e Shpëtimtarit: Themeli i Krishterimit të Vërtetë**  
Nga Plaku Robert D. Hejls  
*Për shkak se Ai jeton, të gjithë ne do të jetojmë përsëri.*
- 14 Ringjallja e Jezu Krishtit dhe të Vërtetat rreth Trupit**  
Nga Dejvid A. Eduards  
*Ringjallja e Jezu Krishtit na mëson të vërteta thelbësore rreth natyrës së përjetshme dhe të shenjtë të trupit.*
- 22 Një Urë drejt Shpresës dhe Shërimit**  
Nga Nanon Talli  
*Si mundet që ju dhe të dashurit tuaj të gjeni paqe, shpresë dhe shërim pas diçkaje aq të keqe dhe tronditëse si abuzimi seksual?*
- 28 Albumi i Vjetër i Familjes: Fuqia e Historive Familjare**  
Nga Amneris Puskasu  
*Historitë dhe jeta e paraardhësve të mi vazhdojnë të më forcojnë.*

## 30 Lufta Vazhdon

Nga Plaku Leri R. Lorens  
*Plaku Lorens tregon për katër strategji të Satanit dhe se si t'u bëjmë ballë atyre.*

## RUBRIKAT

### 20 Muzika: Eja tek Ai

Nga Steven K. Jones dhe Michael F. Moody

### 38 Portrete Besimi: Skaidrite Bokuma

### 40 Zëra të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme

### 80 Kur Prapë të Takohemi: Fuqia e Perëndisë

Nga Plaku Brus R. Mek-Konki



#### 44 Të Kuptuarit e Bekimit Tuaj Patriarkal

Nga Elli Arnell dhe Margaret Uillden  
*Bekimet patriarkale janë si hartat tona udhëzuese vetjake. Ja disa këshilla për të ndjekur [hartën] tuaj.*

#### 48 Përgatitja për një Udhëtim të Ri

Nga Karina Martins Pereira Korreia de Lima  
*Dyshimet dhe frika e fillimit të familjes sime më shqetësuan. Si mund të gjeja paqe?*



*Shihni nëse mund ta gjeni Liahonën e fshehur në këtë botim. E dhënë: A shkëlqen?*

50



#### 50 Si Mund të Studioj në Mendjen Time dhe me Zembrën Time?

*Cila është mënyra e Zotit për marrjen e përgjigjeve ndaj pyetjeve të mia dhe të kuptuarit më mirë të shkrimeve [të shenjtja]?*

#### 52 Përshtatani për Vetën Studimin Tuaj të Ungjillit

*Mësoni se si të mund të merrni më shumë nga studimi juaj i ungjillit.*

#### 56 Përgjigje nga Udhëheqës të Kishës: Si të Gjejmë Paqe të Vërtetë

Nga Plaku Kuentin L. Kuk

#### 57 Libra të Harruar, Dëshmi e Mbajtur Mend

Nga Abigeil D. Ferrer  
*Dita kur m'u kërkua të jepja informacion rreth Kishës, ishte e njëjta ditë që kisha harruar materialet [informuese rreth] Kishës. A do të mjaftonin fjalët e mia të thjeshta?*

#### 58 Ata e Panë Atë

*Lexojini këto dëshmi për Shpëtimtarin e Ringjallur dhe mendoni se si ju mund të jeni dëshmitarë të Ringjalljes së Tij gjithashtu.*

#### 62 Hapësira Jonë

#### 63 Afishe: Përpara, Ushtarë të Krishterë

#### 64 Pyetje e Përgjigje

*Si mund ta di se Perëndia po i dëgjon lutjet e mia?*



79

#### 66 Andrei dhe Fjala e Keqe

Nga Xhuli C. Donaldson  
*Një fjalë e vogël e keqe nuk do të prishte shumë punë, apo jo?*

#### 68 Përgjigje nga një Apostull: Si mund ta ndihmoj familjen time të jetë e fortë?

Nga Plaku Dejvid A. Bednar

#### 69 Përgatituni për Tempullin Çdo Ditë

Nga Xhoni D. Khons  
*Mësoni se si motra Xhons vendosi një synim të rëndësishëm.*

#### 70 Yllka Ndrifon

Nga Xhejn Mek-Brajd  
*Yllka ishte nervoze rreth vajtjes në fillore për herë të parë. A do të ishte në gjendje të gjente një shoqe?*

#### 72 Ji një Dritë!

Nga Jan Pinboru  
*Tetë mënyra për të qenë një mik i mirë.*

#### 73 Figura të Historisë së Kishës: Misionarët e Parë

#### 74 Duke Menduar për Jezusin

Nga Lindsej Taner  
*Mia mëson rreth sakramentit.*

#### 76 Historitë e Jezusit: Jezusi Na Dha Sakramentin

Nga Kim Ueb Raid

#### 79 Zambakët e Pashkës

# Ide për Mbrëmje Familjare

*Ky botim përmban artikuj dhe veprimtari që mund të përdoren për mbrëmje familjare. Në vijim janë dy shembuj.*



**“Ata e Panë Atë”, f. 58:** Çfarë do të thotë të jesh një dëshmitar i Krishtit? Pas leximit të artikullit si familje, ju mund të diskutoni mbi mënyrat se si ju mund të jeni dëshmitarë të Krishtit edhe pa e parë fizikisht Atë. Ju mund të mendoni mbi ide për t'u afruar më pranë Shpëtimtarit si gjetja e mundësive për t'u shërbyer refugjatëve në komunitetin tuaj, të nxënit rreth jetës së Shpëtimtarit gjatë studimit të shkrimeve, përkujdesja [për fëmijët e] një çifti që ata të mund të frekuentojnë tempullin ose ndihmesa ndaj një shoku/shoqeje në nevojë. Ju gjithashtu mund të shihni një material filmik që gjendet në [mormon.org/easter](http://mormon.org/easter), dhe të përsiatni mbi rëndësinë e Krishtit dhe Ringjalljes së Tij në jetën tonë.

**“Përgatituni për Tempullin Çdo Ditë”, f. 69:** Motra Xhoi D. Xhons na kujton mbi rëndësinë e bërjes së tempullit përparësi në jetën tonë dhe kryerjes së historisë familjare për të na ndihmuar për të hyrë [në tempull]. Ju mund të merrni parasysh mbajtjen e një “mbrëmjeje për tempullin dhe historinë familjare” si një mbrëmje familjare në shtëpi. Ju mund të mësoni rreth indeksimit të emrave dhe të kërkoni anale të familjes ose të diskutoni rreth rëndësisë së ordinancave të tempullit dhe të shihni fotografi të tempujve nëpër botë. Nëse jetoni pranë një tempulli, ju mund t'i vizitoni rrethinat e tempullit dhe të diskutoni se si tempujt mund të na sjellin më pranë Atit Qiellor dhe se si na ndihmojnë të ndiejmë dashurinë e Tij.

## MË SHUMË GJENDEN NË INTERNET

*Liahona* dhe materiale të tjera të kishës janë në dispozicion në shumë gjuhë në faqen [languages.lds.org](http://languages.lds.org). Vizitoni [facebook.com/liahona.magazine](https://www.facebook.com/liahona.magazine) (në dispozicion në anglisht, portugalisht dhe spanjisht) për të gjetur mesazhe frymëzuese, ide mbi mbrëmjen familjare në shtëpi dhe materiale të cilat mund t'i ndani me miqtë dhe familjen tuaj.

## TEMAT NË KËTË BOTIM

*Numrat përfaqësojnë faqen e parë të artikullit.*

**Abuzimi seksual,** 22  
**Adhurimi në tempull,** 69  
**Bekimet patriarkale,** 44  
**Besëlidhjet,** 7  
**Besimi,** 4, 38, 41, 48, 80  
**Dëshmia,** 38, 50, 57, 58  
**Dituria,** 50, 52  
**Familja,** 28, 42, 48, 68  
**Fryma e Shenjtë,** 50  
**Fuqia shpirtërore,** 4, 30, 63, 80  
**Guximi,** 40, 57, 63

**Gjuha,** 40, 66  
**Historia e Kishës,** 73  
**Historia familjare,** 28  
**Jeta e përrjeshme,** 8, 14  
**Jezu Krishtit,** 8, 14, 30, 56, 58, 74, 76, 79  
**Lufta në Qiell,** 30  
**Lutja,** 41, 62, 64  
**Miqësia,** 70, 72  
**Paqja,** 48, 56, 62, 66  
**Pashka,** 14, 58, 76, 79  
**Pritëria,** 7, 80

**Ringjallja,** 8, 14, 58, 76, 79  
**Sakramenti,** 74, 76  
**Studimi i shkrimeve të shenjta,** 43, 52, 57  
**Shembulli,** 72  
**Shërbimi,** 4, 42, 68  
**Shërimi,** 22  
**Shlyerja,** 8, 22, 74, 76  
**Shpresa,** 22, 48  
**Trupi,** 14  
**Tundimi,** 30, 63



**Nga Presidenti  
Diter F. Uhtdorf,**

Këshilltar i Dytë në  
Presidencën e Parë

# I DREJTI DO TË JETOJË ME ANË TË BESIMIT

## Rabini dhe Sapunbërësi

**E**kziston një rrëfenjë e vjetër judease rreth një sapunbërësi që nuk besonte në Perëndi. Një ditë, teksa po ecte me një rabi [mësues], ai tha: “Ka diçka që s’e kuptoj. Feja ka ekzistuar për mijëra vite. Por kudo që hedh vështrimin, ka ligësi, korrupsion, pandershmëri, padrejtësi, dhembje, uri dhe dhunë. Duket sikur feja nuk e ka përmirësuar fare botën. Ndaj po të pyes: “Çfarë të mire ka feja?”

Rabini [mësuesi] nuk u përgjigj menjëherë, por vazhdoi të ecte me sapunbërësin. Më në fund ata iu qasën një këndi lojërash ku fëmijët, të mbuluar me dhe, po luanin në pisllek.

“Ka diçka që s’e kuptoj”, tha rabini. “Shikoj ata fëmijë. Kemi pasur sapun për mijëra vite dhe prapëseprapë ata fëmijë janë të pistë. Çfarë të mire ka sapuni?”

Sapunbërësi u përgjigj: “Por mësues, nuk është e drejtë të fajësosh sapunin për këta fëmijë të pistë. Sapuni duhet të përdoret përpara se të mund ta përmbushë qëllimin e tij.”

Rabini buzëqeshi dhe tha: “Saktë”.

## Si do të Jetojmë?

Apostulli Pal, duke cituar një profet nga Dhiata e Vjetër, përmbloodhi se çfarë do të thotë të jesh një besimtar kur shkroi: “I drejti do të jetojë me anë të besimit” (Romakëve 1:17).

Ndoshta me këtë deklaratë të thjeshtë ne kuptojmë ndryshimin midis një feje që është e brishtë dhe e pafrytshme, dhe një feje që ka fuqinë për ta shndërruar jetën.

Por, për të kuptuar se çfarë do të thotë të jetosh me anë të besimit, ne duhet të kuptojmë se çfarë është besimi.

Besimi është më shumë sesa bindje. Është mirëbesim i plotë në Perëndi i shoqëruar me vepra.

Është më shumë sesa dëshirë.

Është më shumë sesa thjeshtë të rrimë duarkryq, të tundim kokat dhe të themi se jemi dakord. Kur themi: “I drejti do të jetojë me anë të besimit”, ne duam të themi se udhëhiqemi dhe drejtohem me anë të besimit tonë. Ne *veprojmë* në një mënyrë që është në përputhje me besimin tonë – jo për shkak të bindjes së pamenduar, por për shkak të mirëbesimit dhe dashurisë së sinqertë për Perëndinë tonë dhe për urtësinë e paçmueshme që Ai u ka zbuluar fëmijëve të Tij.

Besimi duhet të shoqërohet nga veprat; përndryshe nuk ka jetë (shih Jakob [Bibla] 2:17). [Përndryshe] nuk është fare besim. Ai nuk e ka fuqinë për të ndryshuar një individ të vetëm e jo më botën.

Burrat dhe gratë besimtare mirëbesojnë në Atin e tyre të mëshirshëm Qiellor – madje gjatë kohëve të pasigurisë, madje gjatë kohëve të dyshimit dhe fatkeqësisë, kur ata mund të mos shohin përsosurisht ose të kuptojnë qartësisht.

Burrat dhe gratë besimtare ecin me zell në shtegun e dishepullimit dhe orvaten ta ndjekin shembullin e Shpëtimtarit të tyre të dashur, Jezu Krishtit. Besimi na shtyn dhe, me të vërtetë, na frymëzon që t’i kthejmë zemrat tona drejt qiellit dhe në mënyrë aktive t’i ndihmojmë, t’i ngremë moralisht dhe t’i bekojmë bashkëqeniet tona.

Feja pa vepra është si sapuni që mbetet në kuti. Ai mund të ketë potencial të mahnitshëm, por në të vërtetë ka pak fuqi për të sjellë një ndryshim derisa ta përmbushë qëllimin e tij të synuar. Ungjilli i rivendosur i Jezu Krishtit është një ungjill veprash. Kisha e Jezu Krishtit e jep mësim fenë e vërtetë si një mesazh shprese, besimi dhe dashurie hyjnore, duke përfshirë ndihmën ndaj bashkëqenieve tona në mënyra shpirtërore dhe materiale.



*Presidenti Uhtdorf dhe e bija, Antja, vizituan refugjatët në një kamp pranë Athinës në Greqi.*

Disa muaj më parë, bashkëshortja ime, Harieta, dhe unë ishim në një udhëtim familjar me disa nga fëmijët tanë në zonën e Mesdheut. Ne vizituam disa kampe refugjatësh dhe u takuam me familje nga vende të shkatërruara nga lufta. Këta njerëz nuk i përkisnin besimit tonë, por ata ishin vëllezërit e motrat tona dhe kishin nevojë urgjentisht për ndihmë. Zemrat tona u prekën shumë kur përjetuam personalisht se si besimi aktiv i anëtarëve tanë të Kishës sjell ndihmë, lehtësim dhe shpresë të bashkëqeniet tona në nevojë, pavarësisht nga feja, kombësia ose arsimimi i tyre.

Besimi i shoqëruar nga vepra të vazhdueshme e mbush zemrën me mirësi, mendjen me urtësi e mirëkuptim dhe shpirtin me paqe e dashuri.

Besimi ynë mund t'i bekojë dhe të ndikojë në mënyrë të drejtë si te

njerëzit përreth nesh edhe tek ne.

Besimi ynë mund ta mbushë botën me shpirtmirësi dhe paqe.

Besimi ynë mund ta shndërrojë urrejtjen në dashuri dhe armiqtë në miq.

Të drejtët, atëherë, jetojnë duke

vepruar me besim; ata jetojnë duke mirëbesuar në Perëndi dhe duke ecur në udhën e Tij.

Dhe ky është lloji i besimit që mund t'i shndërrojë individët, familjet, kombet dhe botën. ■

#### **MËSIMDHËNIA NGA KY MESAZH**

**P**residenti Uhtdorf shpjegon se besimi është më shumë sesa një shprehje e bindjes. Besimi i vërtetë tek Ati Qiellor dhe te Jezu Krishti kërkon vepra dhe të jetuarit me anë të besimit ka fuqinë për ta shndërruar jetën dhe shtëpinë. Ju mund t'i ftoni ata, të cilëve u jepni mësim, që të tregojnë çaste kur i kanë parë bekimet dhe fuqinë e të jetuarit me anë të besimit – ose nga shembuj vetjakë ose nga vrotimet e të tjerëve. Nxitini ata të lutën për udhërrëfim që të dinë se si ta jetojnë më mirë ungjillin.

## Shërbimi Ndaj të Tjerëve me Besim

**P**residenti Uhtdorf na thotë se besimi ynë në Perëndi *duhet* të “shoqërohet nga veprat”. Kur besimi ynë “shoqërohet nga vepra të vazhdueshme”, shpjegon ai, kjo “e mbush . . . shpirtin me paqe e dashuri”. Me premtimin për këtë bekim, ne *mund* të sjellim një ndryshim dhe mund ta shohim këtë në jetën tonë nëse gjejmë kohën për të bërë shërbim të mbushur me besim. Ju mund të luteni çdo mëngjes që t’i kërkonti Zotit ndihmë për t’u shërbyer të tjerëve. Për shembull, kërkonte Atij që t’ju tregojë se kur një motër apo vëlla ka nevojë për ndihmë për një detyrë ose kur një mik ka nevojë për një kompliment. Pastaj, kur të merrni një nxitje, veproni sipas saj. Nëse këto lutje dhe këtë shërbim i bëni zakon, atëherë veprat tuaja besnike e të vazhdueshme do ta bekojnë jetën tuaj dhe jetën e të tjerëve. Presidenti Uhtdorf premtonte se ju “mund t’i shndërroni individët, familjet, kombet dhe botën”.




## FËMIJËT

### Mirëbesimi

**P**rovoje këtë veprimtari me një mik. Ti duhet t’u mirëbesosh udhëzimeve të tij dhe t’i ndjekësh ato me kujdes.

Me një stilolaps ose laps në dorë, mbylli sytë. Lëre mikun tënd të tregojë se ku t’i vizatosh sytë, hundën, gojën dhe flokët në këtë fytyrë. Pastaj hidhi një sy. Si doli vizatimi? Ti mund ta ngjyrosësh fytyrën dhe të vizatosh një tjetër për të luajtur përsëri.

Ndonjëherë është e vështirë t’i ndjekësh udhëzimet. Por, kur ne përpiqemi ta ndjekim Atin Qiellor duke e dëgjuar Frymën e Shenjtë, Ai do të na ndihmojë. Ne mund t’i mirëbesojmë përherë Atij.





# Betimi dhe Besëlidhja e Priftërisë

*Studiojeni këtë material me lutje dhe kërkoni frymëzim për të ditur se çfarë të tregoni. Si mund t'i përgatitë kuptueshmëria e qëllimit të Shoqatës së Ndihmës bijat e Perëndisë për bekimet e jetës së përrjetshme?*

Sa më shumë që ta kuptojmë si motra se betimi dhe besëlidhja e priftërisë gjen zbatim për ne personalisht, aq më shumë do t'i përqafojmë bekimet dhe premtimet e priftërisë.

Plaku M. Rasëll Ballard, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, tha: “Të gjithë ata që kanë bërë besëlidhje të shenjtë me Zotin dhe që i nderojnë ato besëlidhje, kanë të drejtë të marrin zbulesë vetjake, të bekohen nga shërbesa e engjëjve, të bisedojnë me Perëndinë, të marrin plotësinë e ungjillit dhe, përfundimisht, të bëhen përkrah Jezu Krishtit trashëgimtarë të gjithçkaje që ka Ati ynë”<sup>1</sup>.

Bekimet dhe premtimet e betimit dhe besëlidhjes së priftërisë iu takojnë si burrave edhe grave. Motra Sheri L. Dju, ish-këshilltare në Presidencën e Përgjithshme të Shoqatës së Ndihmës, tha: “Plotësia e priftërisë që përfshin ordinancat më të larta të shtëpisë



Besim  
Familje  
Ndihmë

së Zotit, mund të merret vetëm nga një burrë dhe një grua së bashku”<sup>2</sup>.

Motra Linda K. Barton, Presidente e Përgjithshme e Shoqatës së Ndihmës, ka lëshuar këtë thirrje: “Unë ju ftoj juve ta mësoni përmendsh betimin dhe besëlidhjen e priftërisë, e cila mund të gjendet te Doktrina e Besëlidhje 84:33–44. Duke e bërë këtë, unë ju premtoj se Fryma e Shenjtë do ta zgjerojë kuptueshmërinë tuaj për priftërinë dhe do t’ju frymëzojë e lartësojë në mënyra të mrekullueshme.”<sup>3</sup>

Udhëzimet e Jozef Smithit drejtuar Shoqatës së Ndihmës kishin për qëllim t’i përgatitnin gratë që t’i “zotëronin privilegjet, bekimet dhe dhuratat e Priftërisë”. Kjo do të arrihej nëpërmjet ordinancave të tempullit.

“Ordinancat e tempullit [janë] ordinancat e priftërisë, por ato nuk u japin burrave ose grave detyrë kishtarë. [Këto ordinanca përmbushin] premtimin e Zotit se njerëzve të Tij – grave dhe burrave – do t’ju ‘dhurohet fuqi nga lart’ [DeB 38:32].”<sup>4</sup>

## Shkrime të Shenjta dhe Informacion i Mëtejshëm

Doktrina e Besëlidhje 84:19–40; 121:45–46; [reliefsociety.lds.org](http://reliefsociety.lds.org)

## SHËNIME

1. M. Russell Ballard, “Men and Women and Priesthood Power”, *Liahona*, shtator 2014, f. 36.
2. Sheri L. Dew, në *Daughters in My Kingdom: The History and Work of Relief Society* (2011), f. 128.
3. Linda K. Burton, “Priesthood Power—Available to All”, *Ensign*, qershor 2014, f. 39–40.
4. Gospel Topics, “Joseph Smith’s Teachings about Priesthood, Temple, and Women”, [topics.lds.org](http://topics.lds.org).



Merreni  
Parasysh Këtë

Çfarë mund të bëni ju për ta kuptuar më plotësisht dhe për të pasur të drejtën për bekimet e premtuara të betimit dhe besëlidhjes së priftërisë?



GJETSEMANI, NGA J. KIRK RICHARDS

# Shlyerja e Shpëtimtarit:

## THEMELI I KRISHTERIMIT TË VËRTETË

*Ne të gjithë vërtet do të ringjallemi e do të bëhemi të pavdekshëm për shkak të flijimit shlyes të Jezu Krishtit.*



**Nga Plaku Robert D. Hejls,**  
i Kuorunit të Dymbëdhjetë Apostujve

**P**rofitet Jozef Smith (1805–1844) iu bë pyetja: “Cilat janë parimet themelore të fesë suaj?” Ai u përgjigj: “Parimet themelore të besimit tonë janë dëshmia e Apostujve dhe Profetëve në lidhje me Jezu Krishtin, që Ai vdiq, u varros, u ngrit sërish ditën e tretë dhe u ngjit në qiell; dhe gjithë gjërat e tjera që i përkasin besimit tonë janë vetëm shtojca të kësaj”<sup>1</sup>.

Dua t’ia bashkoj zërin tim thënies së Profetit Jozef. Thelbi i gjithçkaje që besojmë, është Shpëtimtari ynë dhe flijimi i Tij shlyes – “denjimi [i] Perëndisë” (1 Nefi 11:16) nëpërmjet të cilit Ati dërgoi Birin e Tij në tokë për ta përmbushur Shlyerjen. Qëllimi thelbësor për jetën e Jezu Krishtit ishte të përmbushte flijimin shlyes. Shlyerja është themeli i krishterimit të vërtetë.

Përse është Shlyerja e Shpëtimtarit parimi thelbësor i ungjillit në Kishë dhe në jetën tonë?

### **Nenet e Besimit 1:3**

Neni i tretë i besimit shpall: “Ne besojmë se nëpërmjet Shlyerjes së Krishtit, i gjithë njerëzimi mund të shpëtohet, me anë të bindjes ndaj ligjeve dhe ordinancave të Ungjillit”.

“Shpëtohet” në këtë kontekst i drejtohet arritjes së shkallës më të lartë të lavdisë në mbretërinë çelestiale. Ringjallja u jepet të gjithëve që vijnë në tokë, por që të marrë jetë të përjetshme, bekimet e plota të përparimit të përjetshëm, çdo njeri duhet t’u bindet ligjeve, të marrë ordinancat dhe të bëjë besëlidhjet e ungjillit.

Përse Jezu Krishti dhe vetëm Ai, mund të shlyente për mëkatet e botës? Ai i plotësoi të gjitha kualifikimet.

## Perëndia e Deshi Atë dhe Pati Besim tek Ai

Jezusi u lind nga Prindër Qiellorë në një botë paratokësore. Ai ishte i Parëlinduri i Atit tonë Qiellor. Ai u zgjodh që nga fillimi. Ai ishte i bindur ndaj vullnetit të Atit të Tij. Shkrimet e shenjta shpesh flasin për gëzimin që Ati Qiellor ka në Birin e Tij.

Te Mateu lexojmë: “Dhe ja një zë nga qielli që tha: ‘Ky është Biri im i dashur, në të cilin jam kënaqur’” (Mateu 3:17).

Lluka shënon: “Dhe një zë dilte nga reja duke thënë: ‘Ky është Biri im i dashur; dëgjojeni!’” (Lluka 9:35).

Dhe në tempullin në tokën Begati pas Ringjalljes së Shpëtimtarit, njerëzit dëgjuan zërin e Atit: “Vini re Birin tim të Dashur, në të cilin unë jam shumë i kënaqur” (3 Nefi 11:7).

Veçanërisht prekem në zemër kur lexoj se, ndërkohë që Jezusi po vuante në Kopshtin e Gjetsemanit, Ati, për shkak të dashurisë e dhembshurisë së Tij të madhe për Birin e Tij të Vetëmlindur, dërgoi një engjëll që ta ngushëllonte e forconte Atë (shih Lluka 22:43).

## Jezusi e Përdori Lirinë e Tij të Zgjedhjes për t’u Bindur

Jezusit iu desh ta jepte në mënyrë të vullnetshme jetën e Tij për ne.

Në Këshillin e madh në Qiell, Luciferi, “bir[i] i agimit” (Isaia 14:12; DeB 76:26–27), tha:

“Vër re, ja ku jam unë, dërgomë mua, unë do të jem biri yt dhe do ta shëlbej gjithë njerëzimin, që asnjë shpirt të mos humbasë, dhe sigurisht do ta bëj atë; si rrjedhim, ma jep mua lavdinë tënde.

Por, vër re, Biri im i Dashur, që ishte i Dashuri dhe i Zgjedhuri im që nga fillimi, më tha: Atë, vullneti yt u bëftë dhe lavdia qoftë e jotja përgjithmonë” (Moisiu 4:1–2; shih edhe Abraham 3:27).

Për shkak të dashurisë së madhe që Biri e ka për Atin e Tij dhe për secilin prej nesh, Ai tha: “Dërgomë mua”. Kur tha “dërgomë mua”, Ai përdori lirinë e Tij të zgjedhjes.

“Ashtu siç më njeh Ati mua dhe unë e njoh Atin dhe lë jetën time për delet. . . .

Prandaj Ati më do, sepse unë e lë jetën time që ta marr përsëri.

Askush nuk mund të ma heqë, por e lë nga vetja; unë kam pushtet ta lë e pushtet ta marr përsëri; ky është urdhri që kam marrë nga Ati im” (Gjoni 10:15, 17–18).

Nëse Shpëtimtari do të dëshironte, legjione engjëjsh mund ta kishin çuar Atë nga kryqi drejtpërsëdrejti në shtëpi tek Ati i Tij. Por Ai e përdori lirinë e Tij të zgjedhjes për ta flijuar Vetveten për ne, për ta përmbushur misionin e Tij në vdekshmëri dhe për të duruar deri në fund, duke përfunduar flijimin shlyes.

Jezusi donte të vinte në tokë dhe Ai ishte i kualifikuar. Dhe, kur erdhi, Ai tha: “Sepse unë kam zbritur nga qielli jo për të bërë vullnetin tim, por vullnetin e atij që më ka dërguar” (Gjoni 6:38).

## Jezusi u Parashugurua

Pjetri dha mësim se Jezusi ishte “[i] paranjohur përpara krijimit të botës” (shih 1 Pjetër 1:19–21).

Profetët, në të gjitha periudhat e kujdestarisë ungjillore, paratreguan ardhjen e Jezu Krishtit dhe se cili do të ishte misioni i Tij. Nëpërmjet besimit të madh, Enokut iu tregua një vegim i mrekullueshëm i lindjes, vdekjes, Ngjites në



ECCE HOMO [A NIERUJ, NGA J. KIRK RICHARDS

Qiell dhe Ardhjes së Dytë të Shpëtimtarit:

“Dhe vini re, Enoku pa ditën e ardhjes së Birit të Njeriut, madje në mish; dhe shpirti i tij u gëzua, duke thënë: I Drejti është ngritur dhe Qengji është therur nga krijimi i botës. . . .

Dhe Zoti i tha Enokut: Shih, dhe ai pa e vuri re Birin e Njeriut të ngritur në kryq, sipas mënyrës së njerëzve;

Dhe ai dëgjoi një zë të lartë; dhe qiejt u mbuluan, dhe gjithë krijimet e Perëndisë mbajtën zi, dhe toka rënkoj, dhe shkëmbinjtë u çanë, dhe shenjtoret u ngritën e u kurorëzuan në të djathtën e Birit të Njeriut, me kurora lavdie. . . .

Dhe Enoku vuri re se Biri i Njeriut u ngjit tek Ati. . . .

Dhe ndodhi që Enoku pa ditën e ardhjes së Birit të Njeriut, në ditët e fundit, për të banuar në tokë në drejtësi për hapësirën e një mijë vjetëve” (Moisiu 7:47, 55–56, 59, 65).

Rreth 75 vjet përpara lindjes së Krishtit, Amuleku dëshmoi: “Vini re, unë ju them, se unë e di se Krishti do të vijë mes fëmijëve të njerëzve, për të marrë përsipër shkeljet e popullit të tij dhe se ai do të shlyejë për mëkatet e botës; pasi Zoti Perëndi e ka thënë atë” (Alma 34:8).

### Jezusi Kishte Kualifikime të Pashoqe

Vetëm Jezu Krishti mund ta kryente flijimin shlyes – ngaqë u lind prej një nëne të vdekshme, Maries, dhe kishte marrë fuqinë e jetës nga Ati i Tij (shih Gjoni 5:26). Për shkak të kësaj fuqie të jetës, Ai e mposhti vdekjen, fuqia e varrit u asgjësua dhe Ai u bë Shpëtimtari e Ndërmjetësi ynë dhe Zoti i Ringjalljes – mjeti me anë të të cilit shpëtimi dhe pavdekësia na jepen neve të gjithëve. Ne të gjithë vërtet do të ringjallemi e bëhemi të pavdekshëm për shkak të flijimit shlyes të Jezu Krishtit.

### Jezusi në Mënyrë të Vullnetshme Shleu për Mëkatit Fillestar

Neni i dytë i besimit thotë: “Ne besojmë se njerëzit do të ndëshkohen për vetë mëkatet e tyre dhe jo për shkeljen e Adamit”.

Nëpërmjet përdorimit të lirisë sonë të zgjedhjes, ne zgjedhim ta ushtrojmë besimin tonë. Po të kemi zell, ne mund të pendohemi; pa Shlyerjen, nuk mundemi.



GOLGOTA E DITËS SË ZYMTË, NGA J. KIRK RICHARDS

Te Moisiu na jepet mësim: “Nga kjo doli gjerësisht mes njerëzve thënia se Biri i Perëndisë ka shlyer për fajin origjinal, me anë të të cilit mëkatet e prindërve nuk mund të marrin përgjigje mbi kokat e fëmijëve” (Moisiu 6:54).

Te 2 Nefi na jepet një mësim i madhërishëm:

“Pasi, sikurse vdekja ka kaluar mbi të gjithë njerëzit, për të plotësuar planin e mëshirshëm të Krijuesit të madh, duhet patjetër të jetë një fuqi e ringjalljes dhe ringjallja duhet të vijë te njeriu për shkak të rënies dhe rënia erdhi për shkak të shkeljes, dhe për shkak se njeriu ra, ata u përjash-tuan nga prania e Zotit.

Kështu që, duhet të ketë një shlyerje të pafund – se pa këtë shlyerje të pafund, ky korrupsion nuk do të mund të vishej me pakorrupsion. Prandaj, gjykimi i parë që erdhi mbi njeriun do të kishte zgjatur për një periudhë të pafund. Dhe po të ishte kështu, ky mish do të qëndronte për t’u kalbur dhe për t’u shpërbërë në tokën mëmë, për të mos u ngritur më” (2 Nefi 9:6–7).

### Jezusi ishte Qenia e Vetme e Përsosur

Te Doktrina e Besëlidhje, Shpëtimtari thotë: “Atë, vër re vuajtjet dhe vdekjen e atij që nuk bëri asnjë mëkat, në të cilin ti ishe kënaqur; vër re gjakun e Birit tënd që u derdh, gjakun e atij të cilin e dhe që ti vetë të mund të përlëvdohesh” (DeB 45:4).

Jezusi ishte qenia e vetme njerëzore që ishte i përsosur, pa mëkat. Flijimi në Dhiatën e Vjetër do të nënkuptonte një flijim gjaku – duke treguar drejt flijimit të Zotit dhe

Shëlbuesit tonë në kryq për të përmbushur flijimin shlyes. Kur bëheshin flijime gjaku në tempujt e lashtë, priftërinjtë flijonin një qengj të patëmetë, të përsosur në çdo mënyrë. Shpëtimtari shpesh në shkrimet e shenjta njihet si “Qengji i Perëndisë” për shkak të pastërtisë së Tij (shih, për shembull, Gjoni 1:29, 36; 1 Nefi 12:6; 14:10; DeB 88:106).

Pjetri dha mësim se ne shëlbohemi “nga gjaku i çmuar i Krishtit, si të Qengjit të patëmetë dhe të panjollë” (1 Pjetër 1:19).

### Jezusi Hoqi Mëkatet e Botës

Vargjet vijuese e bëjnë të qartë se, nëpërmjet Shlyerjes së Tij, Shpëtimtari e pagoi çmimin për mëkatet tona:

“Ne të gjithë, si dele, kemi shkuar në udhën e gabuar; secili prej nesh ka vajtur në udhën e vet; dhe Zoti ka vënë mbi të, paudhësitë e ne të gjithëve” (Mosia 14:6).

“Por Perëndia e tregon dashurinë e tij ndaj nesh në atë që, kur ende ishim mëkatarë, Krishti vdiq për ne. . . .

Në fakt, ndërsa ishim armiq, u pajtuam me Perëndinë nëpërmjet vdekjes së Birit të tij, akoma më shumë tani, që jemi pajtuar, do të shpëtohem nëpërmjet jetës së tij.

E jo vetëm kaq, por edhe mburremi në Perëndinë, nëpërmjet Zotit tonë Jezu Krisht, me anë të të cilit tani kemi marrë pajtimin. . . .

Në fakt, ashtu si nga mosbindja e një njeriu të vetëm të shumtët u bënë mëkatarë, ashtu edhe nga bindja e një të vetmi të shumtët do të bëhen të drejtë” (Romakëve 5:8, 10–11, 19).

“Që kështu të përmbushet fjala e profetit Isaia kur tha: ‘Ai i mori lëngatat tona dhe i mbarti sëmundjet tona’” (Mateu 8:17).

“Por, Perëndia nuk pushon së qeni Perëndi dhe mëshira kërkon të penduarin; dhe mëshira jepet për shkak të shlyerjes; dhe shlyerja shkakton ringjalljen e të vdekurve; dhe ringjallja e të vdekurve i çon njerëzit në praninë e Perëndisë; dhe kështu ata rikthehen në praninë e tij, për t’u gjykuar sipas veprave të tyre, sipas ligjit dhe drejtësisë. . . .

Dhe kështu Perëndia i realizon qëllimet e tij madhështore dhe të përjetshme që u përgatitën që nga krijimi i botës.

Dhe kështu vjen shpëtimi dhe shëlbimi i njerëzve, si edhe shkatërrimi dhe mjerimi i tyre” (Alma 42:23, 26).

### Jezusi Duroi deri në Fund

Jezu Krishti duroi sprovat, vuajtjen, sakrificën dhe pikëllimet e Gjetsemanit, si edhe ankthin e Golgotës në kryq. Më pas, më së fundi, Ai mundi të thoshte: “U krye!” (Gjoni 19:30). Ai e kishte përfunduar punën e Tij në vdekshmëri dhe duroi deri në fund, duke e përmbushur në këtë mënyrë flijimin shlyes.

Në kopsht Ai tha: “Ati im, në qoftë se është e mundur, largoje prej meje këtë kupë; megjithatë, jo si dua unë, por si do ti” (Mateu 26:39).

Te Doktrina e Besëlidhje na jepet mësim:

“Vuajtje që më bëri mua, madje Perëndi, më i madhi i të gjithëve, të dridhem për shkak të dhembjes e të më dalë gjak nga çdo por dhe të vuaj si në trup e në shpirt – dhe të dëshiroj që të mos e pi kupën e hidhur e të mpakem –

Megjithatë, lavdi i qoftë Atit dhe unë mora pjesë e i mbarova përgatitjet e mia për fëmijët e njerëzve” (DeB 19:18–19).

Jezusi i tha Atit të Tij: “Unë të kam përlëvdur mbi tokë; unë e kam kryer veprën që më ke dhënë të bëj” (Gjoni 17:4).



KU E KANË ÇUAR ATË? NGA J. KIRK RICHARDS

Më pas, në kryq, “kur Jezusi e mori uthullën, tha: ‘U krye!’ Dhe duke ulur kryet, dha frymën” (Gjoni 19:30).

Jezusi erdhi në tokë, e ruajti hyjnueshmërinë e Tij që të mund të kryente fljimin shlyes, dhe duroi deri në fund.

### Kujtojeni Atë nëpërmjet Sakramentit

Sot ne e kujtojmë fljimin shlyes të Shpëtimtarit me anë të emblemave të bukës dhe ujit – simbole të trupit e gjakut të Tij – siç u paraqitën në Darkën e Fundit të Zotit me Apostujt e Tij.

“Pastaj mori bukën, falënderoi, e theu dhe ua dha atyre duke thënë: ‘Ky është trupi im, që është dhënë për ju; bëni këtë në përkujtimin tim’.

Po kështu, pas darkës, mori kupën duke thënë: ‘Kjo kupë është besëlidhja e re në gjakun tim, që është derdhur për ju’” (Lluka 22:19–20).

Te Gjoni 11:25–26 lexojmë:

“Unë jam ringjallja dhe jeta; ai që beson në mua, edhe sikur të duhej të vdesë do të jetojë.

Dhe ai që jeton e beson në mua, nuk do të vdesë kurrë përjetë.”

Gjithashtu lexojmë: “Unë jam buka e gjallë që zbriti nga qielli; nëse një ha nga kjo bukë do të jetojë përjetë; buka që unë do të jap është mishi im, që unë do ta jap për jetën e botës” (Gjoni 6:51).

“Jetën e botës” do të thotë jeta e përjetshme.

Na duhet t’i përgatitim veten tonë dhe familjet tona çdo javë që të jemi të denjë për ta marrë sakramentin dhe për t’i ripërtërirë besëlidhjet tona me zemra të penduara.

### Ati dhe Biri na Duan

Ati e dërgoi Birin e Tij në tokë – denjimi – që ta lejonte Atë të kryqëzohej dhe të kalonte përmes gjithçkaje që Atij i duhej të kalonte. Te Gjoni lexojmë:

“Jezusi . . . tha: ‘Unë jam udha, e vërteta dhe jeta; askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet meje.

Po të më kishit njohur, do të kishit njohur edhe Atin tim; qysh tani e njihni dhe e keni parë’” (Gjoni 14:6–7).

“Në këtë është dashuria: jo se ne e kemi dashur



MOS DYSHO, THOMA, NGA J. KIRK RICHARDS

Perëndinë, por që ai na ka dashur ne dhe dërgoi Birin e tij për shlyerjen e mëkateve tona” (1 Gjon 4:10).

*Shlyerje* do të thotë pajtimin ose lehtësimin.

### Përfundimi

Kushdo që vjen në tokë dhe merr një trup të vdekshëm, do të ringjallet, por neve na duhet të veprojmë që ta marrim bekimin e ekzaltimit nëpërmjet besnikërisë sonë, lirisë sonë të zgjedhjes, bindjes sonë dhe pendimit tonë. Mëshira do të jepet me drejtësinë, duke lejuar pendimin.


Ngaqë kemi zgjedhur ta ndjekim e pranojmë Jezu Krishtin si Shëlbuesin tonë, ne marrim mbi vete emrin e Tij në pagëzim. Ne e pranojmë ligjin e bindjes. Ne premtojmë se gjithmonë do ta kujtojmë Atë dhe do t’i zbatojmë urdhërimet e Tij. Ne i ripërtërijmë besëlidhjet tona kur marrim sakramentin.

Me anë të ripërtëritjes së besëlidhjeve tona, neve na jepet premtimi që ta kemi Shpirtin e Tij që të jetë me ne gjithmonë. Nëse e lejojmë Shpirtin e Tij të hyjë në jetën tonë dhe ta drejtojë jetën tonë, ne mund të kthehemi te prania e Atit Qiellor dhe Birit të Tij, Jezu Krishtit, që është plani i Tyre i lumturisë për ne – plani i shpëtimit. ■

*Nga një bisedë, “The Atonement” [“Shlyerja”], e mbajtur gjatë seminarit për presidentët e rinj të misioneve në Qendrën e Trajnimit të Misionarëve në Provo, më 24 qershor 2008.*

### SHËNIM

1. *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 52.





# Ringjallja E Jezu Krishtit

## DHE TË VËRTETAT RRETH TRUPIT

**Nga Dejvid A. Eduards**

Revistat e Kishës

“**[Ai]** tha: ‘U krye!’ Dhe duke ulur kryet, dha frymën” (Gjoni 19:30). Në atë çast, shpirti i Jezu Krishtit u largua nga trupi i Tij – një trup që kishte duruar vuajtje me qëllim që Ai të mund të shlyente për mëkatet e gjithë njerëzve dhe për t’i ndihmuar ata në dobësitë e tyre (shih Alma 7:12–13). Atë trup, tani një enë e zbrazët, e hoqën nga kryqi, e mbështollën me të linjta dhe më së fundi e vendosën në një varr. Në ditën e tretë, gratë që po i afroreshin varrit, ishin atje për t’i përfunduar përgatitjet e varrimit për atë trup.

Por trupi ishte larguar.

Zbulimi i varrit të zbrazët ishte veçse fillimi. Maria Magdalena, Apostujt dhe shumë të tjerë më vonë dëshmuan diçka të mrekullshme: Jezu Krishtin e ringjallur, të përsosur, në formë të prekshme dhe njerëzore.

Shpëtimtari u siguroi që ata, të cilët e dëshmuan Atë pas Ringjalljes së Tij, e kuptuan tërësisht se çfarë lloj trupi kishte Ai. Ai i ftoi Apostujt, për shembull, që ta preknin trupin e Tij që të mund të siguroheshin se Ai kishte një trup fizik dhe nuk ishte një

fantazmë (shih Lluka 24:36–40)<sup>1</sup>. Ai madje hëngri me ta (shih Lluka 24:42–43).

Teksa më pas Apostujt e përmbushën porosinë e dhënë atyre që të predikonin ungjillin e Jezu Krishtit, ata hasën kundërshtim e përndjekje, një pjesë e të cilave erdhën ngaqë ata dhanë mësim se Jezu Krishti u ringjall dhe se i gjithë njerëzimi do të ringjallej si rrjedhojë (shih Veprat e Apostujve 4:1–3).

Sot, Ringjallja e Jezu Krishtit është po aq thelbësore për mesazhin e shpallur botës nga Kisha e Tij sa ishte në atë kohë. Sikurse tha Profeti Jozef Smith: “Parimet themelore të besimit tonë janë dëshmia e Apostujve dhe Profetëve në lidhje me Jezu Krishtin, që Ai vdiq, u varros, u ngrit sërish ditën e tretë dhe u ngjiti në qiell; dhe gjithë gjërat e tjera që i përkasin besimit tonë janë vetëm shtojca të kësaj”<sup>2</sup>.

Ringjallja ndihmon që t’u jepen përgjigje pyetjeve themelore rreth natyrës së Perëndisë, natyrës sonë dhe marrëdhënies sonë me Perëndinë, qëllimit të kësaj jete dhe shpresës që kemi te Jezu Krishti. Ja disa të vërteta të theksuara nëpërmjet Ringjalljes së Jezu Krishtit.

*Nëpërmjet  
Ringjalljes së Tij,  
Jezu Krishti na  
mësoi të vërteta  
të rëndësishme  
rreth trupit.*



**K**ushdo që hedh poshtë konceptin e një Perëndie me trup hedh poshtë qoftë Krishtin e vdekshëm, qoftë Krishtin e ringjallur.”

– Plaku Xhefri R. Holland

### Ati Qiellor Ka një Trup të Përlëvdur

Ideja që Perëndia ka një formë njerëzore sigurisht është e rrënjosur në Bibël<sup>3</sup>, si edhe në përfytyrimin e mirënjohur, por shumë tradita filozofike, teologjike dhe fetare e kanë mohuar atë në përkrahje të një Perëndie “pa trup, gjymtyrë ose pasione”<sup>4</sup>, përderisa, në këtë pikëpamje, trupi (apo materia në përgjithësi) është i lig ose i pavërtetë, ndërkohë që shpirti, mendja ose idetë janë lënda e vërtetë e qenies ose realitetit përfundimtar.

Sa e thjeshtë dhe revolucionare në mënyrë të lavdishme, atëherë, ishte zbulesa e natyrës së Perëndisë nëpërmjet Birit të Tij, Jezu Krishtit.

Gjatë shërbesës së Tij, Shpëtimtari tha: “Kush më ka parë mua, ka parë Atin” (Gjoni 14:9). Kjo ishte edhe më e vërtetë pas Ringjalljes së Tij me një trup të përsosur, të pavdekshëm, i cili tregoi se “Ati ka një trup prej mishi e kockash, po aq të prekshëm sa edhe të një njeriu; Biri gjithashtu” (DeB 130:22).

Pra u zbulua kështu natyra fizike e Atit Qiellor. Sikurse shpjegoi më vonë Jozef Smithi: “Ai që nuk ka trup ose pjesë s’është asgjë. Nuk ka Perëndi tjetër në qiell përveç Perëndisë që ka mish e kocka.”<sup>5</sup>

Plaku Xhefri R. Holland, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, e ka shprehur në këtë mënyrë: “Nëse pasja e një trupi, jo vetëm është e panevojshme, por e padëshirueshme nga Hyjnia, përse Shëlbuesi i njerëzimit e shëlboi trupin e Tij, duke e shëlbuar nga kthetrat e vdekjes dhe të varrit, duke garantuar se ai nuk do të ndahej kurrë më nga shpirti i Tij në kohë ose përjetësi? *Kushdo që hedh poshtë konceptin e një Perëndie me trup hedh poshtë qoftë Krishtin e vdekshëm, qoftë Krishtin e ringjallur.*”<sup>6</sup>

### Ati Qiellor Është i Gjithëfuqishëm, i Gjithëdijshëm dhe Gjithëdashës

Tiparet e pashoqe të karakterit të Atit Qiellor zbulohen edhe në vetë faktin e Ringjalljes së Jezu Krishtit. Siç ka thënë Plaku D. Tod Kristoferson, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve: “Për shkak se Ringjallja e Krishtit është realitet, dyshimet rreth plotfuqisë, gjithëdijënisë dhe mirëdashjes së Perëndisë, Atit – i cili dha Birin e Tij të Vetëmlindur për shëlbimin e botës – janë të pabazuara”<sup>7</sup>.

Fuqia, dituria dhe mirësia e Perëndisë provohen me anë të Ringjalljes së Jezu Krishtit, e cila jep provë për urtësinë dhe dashurinë në planin e Atit Qiellor dhe aftësinë e Tij (dhe të Birit të Tij) për ta zbatuar atë plan.

### Ne Jemi Fëmijët e Perëndisë

Siç na mëson Bibla, ne u formuam “simbas shëmbëlltyrës së Perëndisë . . . mashkull e femër” (Zanafilla 1:27). Ringjallja e Jezu Krishtit e përforcoi këtë të vërtetë. Në fakt, pikërisht në kohën e Ringjalljes së Tij, Jezu Krishti e theksoi marrëdhënien tonë me Atin Qiellor, duke thënë: “Unë po ngjitem tek Ati im *dhe Ati juaj*, te Perëndia im dhe Perëndia juaj” (Gjoni 20:17; theksimi i shtuar).

Shpëtimtari dha zbulësë se Perëndia dhe njerëzimi nuk janë tërësisht të pangjashëm me njëri-tjetrin në qenien e tyre thelbësore. Forma bazë e trupave tanë është e ngjashme me atë të

shpirtrave tanë<sup>8</sup> dhe shpirtrat tanë u krijuan në shëmbëlltërinë e Perëndisë, sepse ajo është natyra e marrëdhënies prind-fëmijë.

### **Një Trup Është një Dhuratë Aftësuese dhe Fisnikëruese**

Nëpërmjet Ringjalljes së Tij, Shpëtimtari na tregoi se një ekzistencë fizike, trupore është pjesë përbërëse e qenies së përjetshme të Perëndisë dhe të fëmijëve të Tij. Sikurse Zoti ia zbuloi Jozef Smithit: “Elementet janë të përjetshëm dhe shpirti dhe elementet, të lidhur në mënyrë të pandashme, marrin plotësi të gëzimit” (DeB 93:33). Kjo lidhje e pandashme i shkrin së bashku shpirtin dhe materien fizike, kështu që ato janë një trup i pavdekshëm, i pakorruptueshëm, i lavdishëm dhe i përsosur – i vetmi lloj i trupit i aftë për të marrë plotësinë e gëzimit që e zotëron Perëndia.

Në krahasim, pasi kishin pasur një trup fizik dhe më pas ishin veçuar prej tij që të hynin në botën e shpirtrave, “të vdekurit e [panë] mungesën e . . . shpirtrave të tyre nga trupat e tyre si një robëri” (DeB 138:50; shih edhe DeB 45:17).

Madje trupat tanë të vdekshëm janë një pjesë thelbësore e planit të Atit Qiellor dhe janë një dhuratë hyjnore. Kur shpirtrat tanë paratokësorë vijnë në këtë tokë, atyre iu “shtohet” (Abraham 3:26) një trup. Sikurse dha mësim Profeti Jozef Smith: “Ne erdhëm në këtë botë që të mund të kemi një trup dhe ta paraqesim atë të dëlirë përpara Perëndisë në mbretërinë celestiale. Parimi i madh i lumturisë qëndron në pasjen e një trupi. Djalli nuk ka trup dhe ky është dënimi i tij.”<sup>9</sup>

Siç na ka mësuar Plaku Dejvid A. Bednar, i Kuoromit të Dymbëdhjetë Apostujve: “Trupat tanë fizikë bëjnë të mundur një llojshmëri, thellësi dhe fuqi përvoja që thjesht nuk mund të fitohet në ekzistencën tonë para lindjes. Kështu, marrëdhëniet tona me

njerëz të tjerë, zotësia jonë për të njohur dhe vepruar në përputhje me të vërtetën dhe aftësia jonë për t’iu bindur parimeve e ordinancave të ungjillit të Jezu Krishtit, përforcohen nëpërmjet trupave tanë fizikë. Në shkollën e vdekshmërisë, ne përjetojmë dhembshuri, dashuri, mirësi, lumturi, hidhërim, zhgënjim, dhembje dhe madje sfidat e kufizimeve trupore në mënyra që na përgatitin për përjetësinë. E thënë thjesht, ka mësim që duhet t’i mësojmë dhe përvoja që duhet t’i kemi, siç i përshkruajnë shkrimet e shenjta, ‘sipas mishit’ (1 Nefi 19:6; Alma 7:12–13).”<sup>10</sup>

Përveç kësaj, sikurse Jozef Smithi dha mësim: “Të gjitha qeniet që kanë trupa, kanë fuqi mbi ato që nuk kanë”<sup>11</sup>. Satani mund të na tundojë, por ai nuk mund të na detyrojë. “Djalli nuk ka fuqi mbi ne, [përveçse] kur ne e lejojmë atë.”<sup>12</sup>

Më së fundi, dhurata e një trupi të përsosur, të ringjallur ndihmon që të mos ndikohemi nga fuqia e Satanit përgjithmonë. Nëse nuk do të kishte Ringjallje, “shpirtrat tanë do t’i nënshtroheshin . . . djalli[t], për

**T**rupat tanë të vdekshëm janë një pjesë thelbësore e planit të Atit Qiellor dhe janë një dhuratë hyjnore. Kur shpirtrat tanë vijnë në këtë tokë, atyre iu “shtohet” (Abraham 3:26) një trup.



të mos u ngritur më. Dhe shpirtat tanë do të bëheshin si ai dhe ne do të bëheshim djaj, engjëj të një djalli, të dëbuar nga prania e Perëndisë sonë dhe të qëndronim me atin e gënjeshtreve në mjerim, sikurse ai” (2 Nefi 9:8–9).

### **Fryma dhe Trupi Nuk Janë Armiq**

Edhe pse janë të ndryshëm, fryma dhe trupi nuk u përkasin dy realiteteve thelbësisht të ndryshme dhe të papajtueshme. Sikurse e mësoi Jozef Smithi: “Nuk ka diçka të tillë si materie jomateriale. Gjithë shpirti është materie, por është më i pastër e më i përpunuar dhe mund të dallohet vetëm me anë të syve më të pastër; ne nuk mund ta shohim atë; por kur trupat tanë të pastrohen, ne do ta shohim se është i tëri materie” (DeB 131:7–8).

Në gjendjen e Tij të përlëvduar, të ringjallur, Jezu Krishti përfaqëson bashkimin e përsosur të frymës dhe të trupit, duke ilustruar për ne se “fryma e trupi janë shpirti i njeriut” (DeB 88:15). Në këtë jetë ne përpiqemi të jemi “mendjekontrolluar nga shpirti” në vend që të jemi “mendjekontrolluar nga mishi” (2 Nefi 9:39), të “zhvesh[im] njeriun e natyrshëm” (Mosia 3:19) dhe t’i “frenol[im] të gjitha pasionet [tona]” (Alma 38:12). Por kjo nuk do të thotë se fryma dhe trupi janë armiç. Sikurse na tregoi Jezu Krishti, trupi nuk duhet të përbuzet dhe lihet pas dore, por të zotërohet dhe ndryshohet.

### **Jeta në një Trup të Vdekshëm Ka një Qëllim Domethënës**

Koncepti që kjo jetë është një provë, ka më shumë kuptim kur marrim parasysh atë që ne e dimë rreth jetës sonë



përpara dhe pas saj. Ne jetuam si shpirta përpara se të vinim në tokë dhe Ati Qiellor ka për qëllim që ne të bëhemi si Ai dhe të jetojmë përgjithmonë me trupa të pavdekshëm fizikë. Këto të vërteta duan të thonë se koha jonë e vënies në provë në këta trupa të vdekshëm nuk është e paarsyeshme, por ka domethënie dhe qëllim të vërtetë.

Sikurse ka shpjeguar Plaku Kristoferson: “Nëpërmjet zgjedhjeve tona, ne do t’i tregojmë Perëndisë (dhe vetes sonë) zotimin dhe aftësinë tonë për ta jetuar ligjin e Tij çeshtial, ndërkohë që ishim jashtë pranisë së Tij dhe në një trup fizik me të gjitha fuqitë, orekset dhe pasionet e tij. A mund ta frenonim mishin me qëllim që të bëhej një mjet, në vend që të bëhej zotëruesi i shpirtit? A mund të na mirëbesoheshin, si në kohë ashtu edhe në përjetësi, fuqitë e perëndishme, përfshirë fuqinë e krijimit të jetës? A do ta mposhtnim ne si individë ligësinë? Ata që e bënë, do të [kishin] lavdi të shtuar mbi kokat e tyre përherë e përgjithmonë” [Abraham 3:26] – një aspekt shumë i rëndësishëm i asaj lavdie do të ishte një trup fizik i ringjallur, i pavdekshëm dhe i përlëvduar.”<sup>13</sup>

Përvojat tona brenda trupave tanë të tanishëm, përfshirë marrëdhëniet tona me njëri-tjetrin, janë domethënëse ngaqë ato janë një ngjashmëri e asaj që do të vijë. Sikurse e mësoi Jozef Smithi: “Dhe po ai shoqërim që ekziston mes nesh këtu, do të ekzistojë mes nesh atje, veçse do të jetë me lavdi të përjetshme, lavdi të cilën nuk e gëzojmë tani” (DeB 130:2).

### **Ne Kemi Shpresë te Jezu Krishti**

Që nga pamja e varrit të zbrazët, Ringjallja e Jezu Krishtit ka sjellë shpresë ngaqë ne dallojmë në Ringjalljen e Tij

**N**ë gjendjen e Tij të përlëvduar, të ringjallur, Jezu Krishti përfaqëson bashkimin e përsosur të frymës e trupit, duke ilustruar se “fryma e trupi janë shpirti i njeriut” (DeB 88:15).



**Q**ë nga pamja  
e varrit të  
zbrazët, Ringjallja  
e Jezu Krishtit  
ka sjellë shpresë  
ngaqë ne dallojmë  
në Ringjalljen e  
Tij perspektivën e  
vetes sonë.

perspektivën e vetes sonë, në të cilën “të gjitha humbjet [tona] do [të na] plotësohen . . . , po qe se vazhdojmë] besnikërisht”<sup>14</sup>.

Apostujt e hershëm të Shpëtimtarit ishin në gjendje të jepnin një dëshmi të guximshme për Ringjalljen e Tij, sepse ata e kishin parë dhe prekur trupin e Tij. Por kishte edhe më shumë në atë dëshmi sesa kjo. Ashtu si Jezu Krishti i kishte shëruar dobësitë shpirtërore me qëllim që të tregonte se Ai kishte fuqi për të falur mëkatet (shih Lluca 5:23–25), Ringjallja e Tij – prova e prekshme e fuqisë së Tij për ta mposhtur vdekjen fizike – u bë siguria e pasuesve të Tij për fuqinë e Tij për ta mposhtur vdekjen shpirtërore. Premtimet që Ai i dha në mësimet e Tij – falja e mëkateve, paqja në këtë jetë, jeta e përjetshme në mbretërinë e Atit – u bënë reale dhe besimi i tyre u bë i patundur.

“Në qoftë se Krishti nuk është ringjallur, i kotë është besimi [ynë]” (1 Korintasve 15:17). Por ngaqë Ai u ngrit *vërtet*

së vdekuri, ne mund të “ke[m]i shpresë nëpërmjet shlyerjes së Krishtit dhe fuqisë së ringjalljes së tij, që të ngrihe[m]i në jetën e përjetshme dhe kjo për shkak të besimit [tonë] në të, sipas premtimit” (Moroni 7:41).

Gjatë jetës së Tij në vdekshmëri, Jezu Krishti i ftoi njerëzit ta ndjekin Atë. Pas vdekjes dhe Ringjalljes së Tij, vendmbërritja u bë edhe më e qartë. Nëse ne, me anë të bindjes ndaj ligjeve dhe ordinancave të ungjillit, kultivojmë një “shpirt çelestial” brenda nesh, ne mund të “marri[m] të njëjtin trup që ishte një trup natyror” dhe të “gjallërohe[m]i nga një pjesë e lavdisë çelestiale [dhe] të m[arrim] më pas nga e njëjta, madje një plotësi” (DeB 88:28–29). Ai e ka treguar udhën. Ai është udha. Është me anë të fuqisë së Tij – nëpërmjet Shlyerjes dhe Ringjalljes së Tij – që kjo plotësi çelestiale është e mundur, e cila përfshin një plotësi të gëzimit në një trup të ringjallur. ■

#### SHËNIME

1. Kur Jezu Krishti iu shfaq njerëzve në Botën e Re, Ai u kërkoi atyre – mijërave prej tyre – që të vinin, “një nga një”, dhe t’i preknin duart, këmbët dhe ijën e Tij, që ata të mund të dëshmonin se e kishin prekur e parë Zotin e ringjallur (shih 3 Nefi 11:14–15; 18:25).
2. *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 52.
3. Shih Zanafilla 1:27; Eksodi 33:11; Veprat e Apostujve 7:56.

4. Edhe pse ide të ngjashme u përfshinë në besimet e hershme të krishtera, ky formulim i veçantë vjen nga Tridhjetë e Nëntë Nenet e Kishës Anglikane (1563).
5. *Mësimet: Jozef Smith*, f. 44.
6. Xhefri R. Holland, “I Vetmi Perëndi i Vërtetë dhe Jezu Krishti të Cilin Ai Ka Dërguar”, *Liahona*, nëntor 2007, f. 40.
7. D. Tod Kristoferson, “Ringjallja e Jezu Krishtit”, *Liahona*, maj 2014, f. 113.
8. Madje zbulesa e Jezu Krishtit paratokësor

ishte një dëshmi e këtij fakti, përderisa tregoi se trupi i shpirtit të Tij ishte njerëzor në formë (shih Ethëri 3:16).

9. *Mësimet: Jozef Smith*, f. 221.
10. Dejvid A. Bednar, “Ne Besojmë në Qenien të Dëlirë”, *Liahona*, maj 2013, f. 41.
11. *Mësimet: Jozef Smith*, f. 222.
12. *Mësimet: Jozef Smith*, f. 224.
13. D. Tod Kristoferson, “Përse Martesa, Përse Familja”, *Liahona*, maj 2015, f. 51.
14. *Mësimet: Jozef Smith*, f. 53–54.

# Eja tek Ti

Me zemër ♩ = 44-48

Fjalët nga Steven K. Jones  
Muzika nga Michael F. Moody

*mp* Dora e Djathhtë

1. Te  
(2. A) -  
(3. Si)

5

ne A - i erdh'; aq shum' na desh. S'ka as - një shpirt që A - i  
i erdh' në tok'; si nje - ri je - toi. S'ka breng' to - kë - so - re që  
ne je - toi, m'su - ar me pik' - llim. A - tij që be - son, i

8

*rall.*

nuk do ta prek'; S'ka jet' të zyrt' që dot s'e ndri - çon; As  
s'mund ta ku - ptoj'; S'ka dhem - bje në tok' që nuk pro - voi; As  
of - ron leh' - t'sim. A - i hap syt'; fal më - ka - tin Për t'bin-

11

*a tempo*

mër - zi, trish - tim që dot s'rre - gu - llon. E - ja tek A -  
u - ri, as hidh' - rim që s'mund të shë - roj'. E - ja tek A -  
du - rit, bes - ni - ket që e ndje - kin. E - ja tek A -

2



14

i. \_\_\_\_\_  
i. \_\_\_\_\_ M'so prej Tij. Shko tek A - i. \_\_\_\_\_ A -  
i. \_\_\_\_\_

17

i është' ze - mër - but, i pë - ru - lur. E - ja tek A -

20

i. \_\_\_\_\_ 1, 2. 3. \_\_\_\_\_  
2. A - \_\_\_\_\_  
3. Si \_\_\_\_\_ O,

23

e - ja tek A - i. \_\_\_\_\_

© 2016 nga Steven K. Jones dhe Michael F. Moody. I rezervohen të gjitha të drejtat.  
Kjo këngë mund të kopjohet për t'u përdorur me raste në kishë ose në shtëpi, jo për tregti.





# NJË URË DREJT Shpresës DHE Shërimit

*Me ndihmën e  
duhur, viktimat e  
abuzimit seksual  
mund ta gjejnë  
shërimin që e  
dëshirojnë  
kaq fort.*

## **Nga Nanon Tali**

Shërbimet Familjare SHDM, Teksas, SHBA

**P**ërfytyroni që po qëndroni në buzën e një rrëpire dhe dëshironi të kaloni në anën tjetër të një kanioni të thellë, ku ju është thënë se ju pret lumturi e madhe. Teksa kërkoni një mënyrë për të kapërcyer, ju gjeni një grumbull materiale që, nëse vendosen së bashku saktësisht, do të ndërtojnë një urë për të kaluar në anën tjetër të kanionit.

Nëse nuk dini se si ta ndërtoni urën, materialet do të jenë të padobishme dhe ju do të ndiheni të zemëruar dhe të pashpresë. Por, nëse merrni ndihmë nga dikush që ka përvojë në ndërtimin e urave, njohuria dhe kuptueshmëria juaj mund të rriten dhe së bashku mund të përmbushet detyra.

Përgjatë 18 viteve të kaluara, profesioni im ka qenë që të siguroj mjete dhe udhërrëfim për t'i ndihmuar njerëzit që ta kapërcejnë humnerën e vuajtjes emocionale ose mendore. Nga të gjithë njerëzit që i kam këshilluar, asnjë klient tjetër nuk duket të ketë ardhur aq i lënduar sa ata që kanë qenë viktime të abuzimit seksual. E kam parë ndikimin që kjo sfidë ka mbi aftësinë e individit për të duruar mirë deri në fund.

Megjithatë, unë gjithashtu kam arritur ta di se lehtësimi afatgjatë nga vështirësitë tona dhe nga vuajtja jonë është i mundshëm nëpërmjet Shpëtimtarit tonë. Dashuria e Tij i nxjerr njerëzit nga errësira në dritë.

## Përse Abuzimi Seksual Shkakton kaq Shumë Dëmtim?

Viktimat e abuzimit më tregojnë për një jetë plot depresion, vetëdyshim dhe dhembje të tjera të thella emocionale. Presidenti Gordon B. Hinkli (1910–2008) na ndihmoi të kuptojmë përse abuzimi seksual shkakton lëndim kaq të thellë:

“Ekziston praktika e tmerrshme, e ashpër e abuzimit seksual. Ajo është përtej të kuptuarit. Është një fyerje ndaj mirësjelljes që duhet të ekzistojë brenda çdo burri e gruaje. Është *një dhunim i asaj që është e shenjtë dhe hyjnore*. Është shkatërruese në jetën e fëmijëve. Është e dënueshme dhe *meriton ndëshkimin më të rëndë*.”

Turp qoftë mbi çdo burrë ose grua që do të abuzonte seksualisht me një fëmijë. Duke bërë kështu, abuzuesi nuk *kryen vetëm llojin më të rëndë të plagosjes*. Ai ose ajo gjithashtu mbetet i/e dënuar përpara Zotit.”<sup>1</sup>

Fuqia për të krijuar jetë është një fuqi e shenjtë dhe hyjnore që Ati ynë në Qiell ua ka dhënë fëmijëve të Tij. Plaku Dejvid A. Bednar, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dha mësim: “Fuqia [për të krijuar jetë] është domethënëse nga ana shpirtërore. . . . Ati ynë Qjellor dhe Biri i Tij i

Dashur janë krijuar dhe i kanë besuar secilit prej nesh një pjesë të fuqisë së Tyre krijuese.”<sup>2</sup> Nuk është çudi, atëherë, që dhunimi i kësaj fuqie të shenjtë “meriton ndëshkimin më të rëndë” dhe shkakton “llojin më të rëndë të plagosjes”.

## Të Kuptuarit e Lëndimit

Abuzim seksual është çfarëdo ndërveprimi pa pëlqim, i cili përfshin sjellje që kryhen ose jo nëpërmjet prekjës, në të cilat një njeri përdoret për vetëkënaqjen seksuale të një njeriu tjetër. Tepër shpesh, viktimat e abuzimit seksual lihen me mendime të pështjelluara, si edhe ndjenja të padenjesisë e të turpfit, të cilat mund të jenë pothuajse shumë të rënda për t’u duruar. Dhembja dhe vuajtja që përjetojnë viktimat, shpesh shtohet nga komentet e të tjerëve që janë të rrënjosura në një keqkuptim të abuzimit seksual dhe të pasojave të tij. Disa viktimat akuzohen se gënjejnë ose atyre u thuhet se abuzimi ishte në njëfarë mënyre faji i tyre. Të tjerë në mënyrë të gabuar bëhen të besojnë se duhet të pendohen, sikur ata të kishin mëkatuar në njëfarë mënyre ngaqë kishin qenë viktimat.

Shumë klientëve, me të cilët kam punuar, që përjetuan abuzim seksual në fëmijërinë ose rininë e tyre, iu thuhet “t’i japin fund asaj”, “ta lenë atë në të shkuarën” ose “thjesht të falin e të harrojnë”. Këto lloje thëniesh – veçanërisht kur vijnë nga miq të afërm, pjesëtarë të familjes ose udhëheqës të Kishës – mund ta çojnë viktimën drejt fshehtësisë dhe turpfit në rritje në vend të shërimit dhe paqes. Në mënyrë të ngjashme me një plagë fizike ose infeksion të rëndë, këto plagë emocionale thjesht nuk largohen nëse lihen pas dore. Përkundrazi, rritet pështjellimi që fillon gjatë abuzimit, dhe, së bashku me emocionet e dhimbshme që pasojnë, të menduarit e një njeriu mund të ndryshohet, duke çuar më së fundi drejt zhvillimit të sjelljeve të pashëndetshme. Është e zakonshme që viktimat e abuzimit të mos ta kuptojnë se ajo që u ndodhi atyre, ishte abuzive, prapëseprapë ata mund të zhvillojnë ende sjellje të pashëndetshme dhe emocione të dhimbshme.

Hana (emri është ndryshuar) përjetoj abuzim seksual herët në fëmijërinë e saj. Si viktimat e tjera, ajo u rrit duke ndier se ishte një njeri i tmerrshëm, që nuk kishte asnjë vlerë. Ajo e kaloi shumicën e jetës së saj duke u përpjekur t’u shërbente të tjerëve aq sa të kompensonte për ndjenjat



se ajo nuk ishte “mjaft e mirë” saqë Ati Qiellor ose dikush tjetër ta donte. Në marrëdhëniet e saj, pati frikë se, nëse njerëzit do ta njihnin atë me të vërtetë, ata do të mendonin se ishte po aq e keqe sa e besonte edhe vetë se ishte. Ajo përjetoi një frikë të fuqishme mospranimi, e cila çoi drejt të qenit e frikësuar për të provuar gjëra të reja në jetë apo për të bërë detyra të thjeshta si marrja e dikujt në telefon. Ajo u bekua me një talent për punë artistike, por hoqi dorë prej tij nga frika se nuk do të ishte në gjendje t'i bënte ballë kritikës.

Për më shumë se 50 vjet ndjenjat e saj të padobishmërisë, pafuqishmërisë, frikës, zemërimit, pështjellimit, turpit, vetmisë dhe izolimit i udhërrëfyen vendimet e saj të përditshme.

### Zëvendësimi i Dhembjes me Paqen

Shpëtimtari vuajti “dhimbje dhe hidhërimi dhe tundime të çdo lloji”. Ai e bëri këtë që të “di[nte], sipas mishit, sesi [ta] ndihmo[nte] popullin e tij” (Alma 7:11–12). Vuajtja e Tij nuk ishte vetëm për mëkatet tona, por edhe për shërimin tonë kur mëkatet e dikujt tjetër na bëjnë të vuajmë.

Nëse Ai do të ishte sot këtu, unë përfytyroj që Shpëtimtari do të qante me ata që janë abuzuar seksualisht dhe do t'i bekonte ata, sikurse qau me nefitët dhe i bekoji ata (shih 3 Nefi 17). Ndërsa Ai nuk është këtu fizikisht, Shpirti i Tij mund të jetë me ne dhe Ai ka siguruar një mënyrë për ne që të shërohemi, të ndiejmë paqe dhe të falim.



Për shumë veta që janë lënduar, ideja se dhembja që mbartin, mund të zëvendësohet me paqe është pothuajse e pamundur për ta besuar. Shpesh plagët e të abuzuarve kalojnë pa u vënë re dhe pa u dalluar nga të tjerët për vite. Lëndimi maskohet nga fytyra të qeshura, një gatishmëri për të ndihmuar të tjerët dhe për ta jetuar jetën sikur asgjë të mos shkonte keq, prapëseprapë dhembja është vazhdimisht atje.

Le ta krahasojmë procesin e shërimin emocional me atë të përkujdesjes për një plagosje fizike dhe të trajtimit të saj. Hamendësoni se kur ishit i ri, ju thyet këmbën. Në vend që të shkonit te mjeku që ta bënit kockën të vihej në vend, ju çaluat derisa dhembja e madhe u largua, por mbetet gjithmonë një dhembje e lehtë në secilin hap që ndërmerreni. Vite më vonë ju dëshironi që dhembja të largohet, prandaj shkoni te një mjek. Mjeku duhet ta rivendosë kockën, të pastrojë ndonjë formim që është rritur, ta vërë atë në allçi dhe t'ju dërgojë për terapi fizike që ta forconi këmbën tuaj.

Procesi i shërimin nga abuzimi është i ngjashëm me atë që viktima fillimisht duhet ta kuptojë se dhembja është e

### SJELLJET E ZAKONSHME TË VIKTIMAVE

Viktimat shpesh ndeshin vështirësi në marrëdhënie dhe mund të kërkojnë vazhdimisht miratim nga të tjerët, bëhen pasivë, ngrënë pengesa për t'i mbajtur njerëzit në largësi që të shmangin lëndimin, bëhen të shturur duke kërkuar përbushje nëpërmjet aktivitetit seksual (përfshirë pornografinë dhe vetënxitjen) ose bëjnë pikërisht të kundërtën dhe i shmangen çdo gjëje që lidhet me seksin. Turpi i shoqëruar me këto sjellje shpesh i pengon individët që të kërkojnë ndihmë prej prindërve, udhëheqësve të priftërisë ose profesionistëve, sepse ata nuk e kuptojnë lidhjen midis asaj që u ndodhi atyre, dhe sjelljeve të tyre.

Në të jetuarin e ungjillit, viktimat priren të shkojnë drejt njërit skaj ose drejt skajit tjetër: Disa bëhen jashtëzakonisht fetarë. Në përpjekje për të mbuluar atë që e mendojnë se është padenjësia e tyre, ata përpiqen ta bëjnë gjithçka siç duhet. Të tjerët ndiejnë se ata kurrë nuk do të jenë të denjë për jetë të përjetshme dhe në disa raste heqin dorë nga përpjekja.

## MËSIMET NGA DOKTRINA E BESËLIDHJE 123

Ndërkohë që Profeti Jozef Smith ishte i burgosur në burgun në Liberti të Misurit, ai i shkroi një letër Kishës, që përmbledh seksionet 121–124 të Doktrinës e Besëlidhjeve, të cilët përfshijnë “Detyr[ën] e Shenjtorëve në lidhje me përndjekësit e tyre” (DeB 123, kreu i seksionit). Ai nuk u tha shenjtorëve që kishin vuajtur përndjekje dhe dëmtime fizike, që ta mbanin brenda vetes lëndimin e tyre dhe të shtireshin se nuk kishte ndodhur asgjë. Merrni parasysh se si këshilla e dhënë në seksionin 123 mund të zbatohet ndaj problemit të abuzimit.



vërtetë dhe se mund të bëhet diçka rreth saj. Procesi përfshin pohimin e asaj që ndodhi, dhe lejinin e ndjenjave të të qenit të lënduar, të frikësuar dhe të trishtuar që të ndihen, pranohen e vlerësohen. Shpesh është e dobishme që të punohet me një profesionist me përvojë në këtë proces shërimi. (Kontrolloni me udhëheqësin tuaj të priftërisë që të mësoni nëse Shërbimet Familjare SHDM janë në dispozicion në zonën tuaj.)

Qoftë nëse viktimat ka mundësi ose jo për ndihmë profesionale, gjëja më e mirë është që të lutet, ta studiojë jetën e Shpëtimtarit dhe Shlyerjen e Tij dhe të takohet rregullisht me një udhëheqës të priftërisë. Ai mund të ndihmojë që të lehtësohen barrët dhe të merret frymëzimi për t'i ndihmuar viktimat që të kuptojnë vlerën e tyre hyjnore dhe marrëdhënien e tyre me Atin në Qiell dhe Shpëtimtarin. Sikurse na mësoi kohët e fundit Motra Karol M. Stivens, Këshilltare e Parë në Presidencën e Përgjithshme të Shoqatës së Ndihmës: “Shërimi mund të jetë një proces i gjatë. Për të do të nevojitet që ju ta kërkonit plot lutje udhërrëfimin dhe ndihmën e duhur, përfshirë këshillimin me mbajtësit e priftërisë që janë shuguruar siç duhet. Ndërsa

mësoni të komunikoni hapur, vendosni kufijtë e duhur dhe ndoshta kërkonit këshillë profesionale. Ruajtja e shëndetit shpirtëror gjatë gjithë procesit është jetike!”<sup>3</sup>

Për Hanën, jeta e saj ishte bërë kaq e parehatshme sa ajo kërkoi ndihmë. Ajo e dinte nga dëshmia e vet se mund të ndiente paqe dhe kënaqësi në jetë, por nuk i ndiente ato në mënyrë të vazhdueshme. Nëpërmjet lutjes dhe bisedës me peshkopin e saj, ajo u udhëzua që të shkonte në këshillim, ku ishte në gjendje të fitonte mjetet që i nevojiteshin për ta nxjerrë të vërtetën nga errësira dhe për të treguar për barrën e tmerrshme që e kishte mbartur e vetme. Duke e bërë këtë, ajo që në gjendje ta largonte dhembjen dhe të gjente paqen e premtuar nga Shpëtimtari (shih Gjoni 14:27). Së bashku me këtë paqe e ngushëllim erdhi dëshira dhe aftësia për të falur.

### Nevoja për të Falur

Ideja e faljes është shpesh e vështirë që të dëgjohet nga viktimat e abuzimit dhe shpesh keqkuptohet. Nëse mendojnë për faljen si lënien e abuzuesit pa e ndëshkuar apo thënien se ajo që bënë, nuk ka më rëndësi, viktimat nuk do të ndiejë vlerësim. Ndërkohë që urdhërohemi të falim (shih

DeB 64:10), në situatat ku dëmtimi është i rëndë, në mënyrë tipike shërimi duhet të fillojë përpara se viktimat mund ta falë tërësisht abuzuesin.

Ata që po vuajnë dhembjet e shkaktuara nga abuzuesi, mund të gjejnë ngushëllim në këtë këshillë nga Libri i Mormonit: “Unë, Jakobi, dua t’ju flas juve që jeni të kulluar në zemër. Shikoni te Perëndia me fortësi të mendjes dhe lutjuni atij me besim të jashtëzakonshëm dhe ai do t’ju ngushëllojë në pikëllimet tuaja, dhe ai do të mbrojë çështjen tuaj, dhe do të dërgojë drejtësi mbi ata që kërkojnë shkatërrimin tuaj” (Jakobi 3:1 [LiM]). Nevoja për drejtësi dhe e drejta për dëmshpërblim mund t’i lihen në dorë Zotit, që Ai të mund ta zëvendësojë lëndimin tonë me paqe.

Hana më së fundi gjeti se ajo mund t’ia linte nevojën për drejtësi Shpëtimtarit dhe në këmbim të gjente një ndjenjë paqeje në jetën e saj që nuk e kishte përjetuar kurrë më parë. Më parë ajo kishte pasur frikë të merrte pjesë në mbledhjet e familjes ku abuzuesi do të ishte i pranishëm. Tani, për shkak të gatishmërisë së saj që të përballet me plagët e vështira emocionale në udhën e saj drejt shërimit, ajo nuk ka më frikë të ndodhet në praninë e tij dhe madje të mund të ketë dhembshuri për të në moshën e tij të thyer.

### Të Çliruar nga Barrë të Panevojshme

Plaku Riçard G. Skot (1928–2015), i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, tha se “shërimi i plotë do të vijë nëpërmjet besimit tuaj në Jezu Krishtin,

në fuqinë dhe aftësinë e Tij, nëpërmjet Shlyerjes së Tij, që të shërojnë shenjat e asaj që është e padrejtë dhe e pamerituar. . . .

Ai ju do. Ai dha jetën e Tij që ju të mund të çlirohemi nga barrët e panevojshme. Ai do t’ju ndihmojë ta bëni këtë. E di se Ai ka fuqinë për t’ju shëruar.”<sup>4</sup>

Kundërshtari dëshiron t’i mbajë njerëzit të lidhur me anë të dhembjes dhe vuajtjes, ngaqë ai është i mjeruar (shih 2 Nefi 2:27). Me ndihmën e Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit, dhembja me të vërtetë mund të zëvendësohet nga paqja, vetëm ashtu si Shpëtimtari është në gjendje ta japë, dhe ne mund të jetojmë me gëzim. “Adami ra që njerëzit të mund të jenë; dhe njerëzit janë, që ata të mund të kenë gëzim” (2 Nefi 2:25). Të jetuarit me gëzim do t’i lejojë kohët e sprovës që të jenë më të durueshme dhe do të na aftësojë që të mësojmë e rritemi dhe të bëhemi më shumë si Ati ynë në Qiell.

Unë jam përlurur nga bekimi që kam pasur në jetën time, për t’u takuar me ata që janë dëmtuar nga abuzimi, dhe për të parë mrekullinë e shërimit që me të vërtetë vjen vetëm nëpërmjet Shpëtimtarit. Nëse po vuani, ju lutemi të kërkonit ndihmë me anë të lutjes. Ju nuk duhet ta mbartni barrën e rëndë të vetëm. Unë e di se Ai shëron, sepse e kam dëshmuar atë shumë herë. ■

### SHËNIME

1. Gordon B. Hinckley, “Save the Children”, *Ensign*, nëntor 1994, f. 54; theksimi i shtuar.
2. Dejvid A. Bednar, “Ne Besojmë në Qenien të Dëlirë”, *Liahona*, maj 2013, f. 42.
3. Karol M. Stivens, “Mësuesi Shërues”, *Liahona*, nëntor 2016, f. 11.
4. Richard G. Scott, “To Be Free of Heavy Burdens”, *Liahona*, nëntor 2002, f. 88.

## KËSHILLË PËR UDHËHEQËSIT, FAMILJEN DHE MIQTË

Kur viktimat ju mirëbesojnë aq sa t’ju tregojnë për vuajtjet e tyre dhe abuzimet ndaj tyre, bashkëbisedimet me ta duhet të fillojnë me dashuri e mirëdashje për ta. Tepër shpesh viktimat më kanë treguar se, kur i janë drejtuar peshkopit të tyre për ndihmë, përqendrimi filletar ishte mbi nevojën për ta falur fyesin. Kjo mund ta bëjë viktimën të ndiejë sikur gjithçka që ka rëndësi, është fyesi. Kur kjo ndodh, individët rrallë kthehen te peshkopët e tyre për ndihmë dhe nuk e arrijnë shërimin shpirtëror që është i mundshëm me anë të dashurisë dhe mbështetjes kishtare.

Falja është pjesë jetike në procesin e shërimit dhe është një urdhërim – por ju lutemi, kini besim se lejimi i dikujt që fillimisht ta pranojë vuajtjen e tij, t’i ndiejë ndjenjat e tij dhe të flasë rreth tyre me një njeri të mirëbesuar, do të çojë me kalimin e kohës drejt shërimit që vjen nga të qenit në gjendje për ta falur abuzuesin.

Udhëheqësit e Kishës mund t’i drejtohen [ministering.lds.org](http://ministering.lds.org) për të gjetur “Abuse: Help for the Victim” [“Abuzimi: Ndhimja për Viktimën”] për më shumë informacion.

# Albumi

## i Vjetër i Familjes: Fuqia e Historive Familjare

*Trashëgimitë e paraardhësve të mi vazhdojnë të jetojnë nëpërmjet meje, duke ndikuar vazhdimisht për mirë në jetën time.*

**Nga Amneris Puskasu**

Një mëngjes vere para Luftës II Botërore, stërgjyshi im u zgjua para agimit – siç bënte përherë. Ai shkoi jashtë shtëpisë së tij në një kodër me pamje nga një luginë e gjelbër dhe nga fshati i tij në Rumani dhe u ul mbi barin e mbuluar nga vesa e mëngjesit, i zhytur thellë në mendime – të njëjtat mendime që kishin qenë në mendjen e tij për njëfarë kohe. Si një burrë i shkolluar me një zemër të madhe dhe me një mendje kureshtarë, atë e donin dhe e respektonin të gjithë në fshat.

Fshati i tij, që ndodhej në tokën e lumit të lashtë Olt, ishte prototipi i pamjes së përrjetshme të një fshati rumun,

ku lashtësia bashkohet me peizazhet përrallore, një thesar të zakoneve piktoreske dhe përgjegjësinë e natyrshme për t'u kujdesur për objektet dhe traditat që njeriu trashëgon nga etërit e tij dhe ia kalon brezit tjetër.

Pasi lindi dielli, ai shkoi brenda shtëpisë dhe i rrëfeu gruas së tij se ai kishte qenë kureshtar të shihte se si do të ishte funerali i tij dhe se donte të bënin një funeral provë. Ai caktoi datën, bleu arkivolin, punësoi priftin dhe vajtes profesionistë dhe siguroi të gjithë artikujt e tjerë kërkuar nga tradita ortodokse greke. Dita e funeralit provë erdhi. Tavolinat ishin vënë në mes të fshatit për banketin përkujtimor, familja ishte e veshur e gjitha me të zeza, erdhi prifti, stërgjyshi im rrinte shtrirë në arkivol, duke rregulluar jastëkun që të kishte një pamje të rehatshme dhe kortezhi i funeralit filloi. Kur ceremonia mbaroi, i gjithë fshati u ftua në gostinë ku stërgjyshi im realizoi ëndrrën e tij, që të kërcente në vetë funeralin e tij. Ai jetoi edhe 20 vite të tjera, duke kontrolluar shpesh për të parë nëse arkivoli e nxinte akoma.

### Jo Thjesht Emra dhe Data

Nuk e kam takuar kurrë stërgjyshin tim por historia e tij ka qenë gjithmonë më e parapëlqyera për mua. Ajo më kaloi mua nëpërmjet gjyshërve të mi. Çdo ditë ata do të më tregonin mua dhe vëllezërve e motrave të mia rreth



paraardhësve tanë: nga erdhën ata, si ishin ata, vlerat, ëndrrat dhe shpresat e tyre. Pas çdo vakti të diele, gjyshërit e mi nxirrnin albumin e vjetër të familjes. Me çdo kthim faqeje historitë vinin në jetë, e shkuara dhe e tashmja, ndërsa zemrat thureshin së bashku në një tapiceri dashurie që i reziston provës së kohës.

Ato nuk ishin thjesht fotografi të vjetra me emra dhe data të shkruara me ngut nga mbrapa. Pas çdo fytyre ishte një atë apo një nënë, një bir apo një bijë, një vëlla apo një motër. Për ne ata qenë njerëz të vërtetë me shpresa dhe ëndrra, mundime dhe zhgënjime, suksese dhe dështime. Megjithëse nuk janë më të pranishëm me trup, historitë e tyre vazhdojnë të jetojnë, trashëgimitë e tyre vazhdojnë të shkëlqejnë dhe fytyrat e tyre vazhdojnë të qeshin nga një album i vjetër familjar që sot lidh në dashuri zemrat e gjashtë brezave.

### Forcë në Kohë Sprove

Në kohën kur isha 19 vjeçe, prindërit e mi dhe pjesa më e madhe e familjes më të afërt kishin vdekur dhe shumë prej pasurive që kisha trashëguar, kishin humbur ose ishin vjedhur. Por përsëri ka një gjë që as koha, fatkeqësitë natyrore apo madje edhe vdekja nuk mund ta shkatërrojnë ndonjëherë: ura që shtrihet në të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen që e ndërtoi secili prej pjesëtarëve të familjes sime. Për shkak

të zellit të tyre, fija që i lidh së bashku zemrat tona, ka dhënë provën që është më e fortë se çdo sprovë tokësore dhe më ka dhënë forcën për të kapërcyer rrethana të vështira.

Kur prindërit dhe gjyshërit e mi vdiqën, unë ndjeva një dhimbje aq të thellë sa që pyeta veten nëse do të kisha forcë të mjaftueshme për të vazhduar përpara. Por unë e ndjeva ndikimin e tyre nga përtej velit dhe ai [ndikim] më ndihmoi të fitoja një dëshmi të patundur për jetën pas vdekjes dhe më vonë për ordinancat e tempullit.

Nuk mbaj mend se si ishte mamaja ime dhe as nuk i kam takuar stërgjyshërit e mi, por çdo herë që e marr albumin e vjetër të familjes unë shoh veten time në sytë e tyre. Unë jam kjo që jam për shkak të të gjithë atyre që erdhën para meje, dhe përvojat dhe urtësia e tyre kanë formuar karakterin tim dhe më kanë udhëhequr gjatë shtegut tim.

Shpesh mendoj për familjen time në anën tjetër të velit dhe për sakrificat që ata bënë që unë të kisha një jetë më të mirë. Mendoj për ordinancat e tempullit të cilat na mundësojnë që një ditë të jemi sërish së bashku si një familje. Dhe mendoj për Shlyerjen e Jezu Krishtit, i cili e bëri të mundur të gjithë këtë. Ai pagoi çmimin që ne të mund të jetojmë. Për këtë ne e duam Atë dhe e adhurojmë Atë me mirënjohje sot dhe përgjithmonë. ■

*Autorja jeton në Nju-Jork, SHBA.*





**Nga Plaku Leri R. Lorens,**  
i Të Shtatëdhjetëve





# Lufta Vazhdon

*Lufta që filloi në qiell, vazhdon deri më sot.  
Në fakt, beteja po ndizet ndërkohë që shenjtorët  
përgatiten për kthimin e Shpëtimtarit.*

**K**ushdo që ndjek lajmet ndërkombëtare, do të bjerë dakord se ne jetojmë në një kohë “luftëra[sh] e ushtima luftërash” (DeB 45:26). Për fat të mirë, çdo njeri në tokë është një veteran lufte. Ne kemi qenë duke u ndeshur me ushtritë e të ligut në një luftë të vazhdueshme që filloi në sferën paratokësore përpara se të lindeshim.

Ngaqë nuk kishim marrë ende trupa fizikë, ne luftuam në Luftën në Qiell pa shpata, pushkë ose bomba. Por luftimi ishte po aq i ashpër sa çdo luftë bashkëkohore dhe pati miliarda viktima.

Lufta para lindjes u zhvillua me fjalë, ide, debat dhe bindje (shih Zbulesa 12:7–9, 11). Strategjia e Satanit ishte t'i frikësonte njerëzit. Ai e dinte se frika është mënyra më e mirë për ta shkatërruar besimin. Ai mund të ketë përdorur argumente si këto: “Është shumë e vështirë”. “Është e pamundur të kthehemi të pastër.” “Ka shumë rrezik.” “Si e dini se mund të mirëbesoni në Jezu Krishtin?” Ai ishte shumë xheloz ndaj Shpëtimtarit.

Fatmirësisht, plani i Perëndisë triumfoi mbi gënjeshttrat e Satanit. Plan i Perëndisë përfshiu lirinë morale të zgjedhjes për njerëzimin dhe një flijim të madh. Jehovahi, i njohur prej nesh si Jezu Krishti, doli vullnetar që të ishte ai flijim – që të vuante për të gjitha mëkatet tona. Ai ishte i gatshëm ta jepte jetën e Tij për vëllezërit dhe motrat e Tij, kështu që ata të cilët pendoheshin, mund të ktheheshin të pastër e më së fundi të bëheshin si Ati i tyre Qiellor. (Shih Moisiu 4:1–4; Abraham 3:27.)

Përparësia tjetër që e ndihmoi Jehovahën të fitonte zemrat e fëmijëve të Perëndisë, ishin dëshmitë e fuqishme, të dhëna nga përkrahësit e Tij, të udhëhequr nga Mikaeli, kryeengjëlli (shih Zbulesa 12:7, 11;

*Në Luftën në Qiell, ne e deshëm dhe e mbështetëm Atin tonë në Qiell. Ne donim të bëheshim si Ai.*

DeB 107:54). Në jetën para lindjes, Adami u quajt Mikael dhe Satani u quajt Lucifer, që do të thotë “dritëmbartësi”<sup>1</sup>. Ai mund të duket si një emër i çuditshëm për princin e errësirës (shih Moisiu 7:26), por shkrimet e shenjta na mësojnë se Satani ishte “një engjëll i Perëndisë, që ishte në autoritet në praninë e Perëndisë” përpara se të binte (shih DeB 76:25–28).

Si mund të binte aq poshtë një shpirt me aq shumë dituri e përvojë? Ishte për shkak të krenarisë së tij. Luciferi ngriti krye kundër Atit tonë në Qiell ngaqë ai e dëshironte mbretërinë e Perëndisë për veten e vet.

Në bisedën e tij klasike “Beware of Pride” [“Ruhuni nga Krenaria”], Presidenti Ezra Taft Benson (1899–1994) dha mësim se Luciferi “donte të nderohej mbi të gjithë të tjerët” dhe se “dëshira e tij krenare ishte të hiqte nga fronti Perëndinë”<sup>2</sup>. Ju e keni dëgjuar gjithashtu që Satani donte ta shkatërronte lirinë e zgjedhjes së njeriut, por kjo nuk ishte e vetmja arsye pse ai nuk u pranua më nga Perëndia. Ai u dëbua nga qielli për ngritjen krye kundër Atit e Birit (shih DeB 76:25; Moisiu 4:3).

Përse unë dhe ju luftuam kundër djallit? Ne luftuam për shkak të besnikërisë. Ne e deshëm dhe e mbështetëm Atin tonë në Qiell. Ne donim të bëheshim si Ai. Luciferi pati një qëllim të ndryshëm. Ai dëshironte ta zëvendësonte Atin (shih Isaia 14:12–14; 2 Nefi 24:12–14). Përfytyroni se si tradhtia e Satanit i lëndoi Prindërit tanë Qiellorë. Në shkrimet e shenjta, ne lexojmë se “qiejt vajtuan për të” (DeB 76:26).

Pas një fushate të zjarrtë, Mikaeli dhe ushtritë e tij triumfuan. Dy të tretat e ushtrive qiellore zgjodhën ta ndiqnin Atin (shih DeB 29:36). Satani dhe pasuesit e tij u dëbuan nga qielli, por ata nuk u dërguan menjëherë në errësirën



e mëtejshme. Së pari, ata u dërguan në këtë tokë (shih Zbulesa 12:7–9), ku do të lindej Jezu Krishti dhe ku do të kryhej flijimi i Tij shlyes.

Përse u lejuan ushtritë e Satanit që të vinin në tokë? Ato erdhën që të siguronin kundërshtim për ata që po provohen këtu (shih 2 Nefi 2:11). A do të dëbohen ata më së fundi në errësirën e mëtejshme? Po. Pas Mijëvjeçarit, Satani dhe ushtritë e tij do të dëbohen përgjithmonë.

Satani e di që ditët e tij janë të numëruara. Në Ardhjen e Dytë të Jezusit, Satani dhe engjëjt e tij do të lidhen për 1.000 vjet (shih Zbulesa 20:1–3; 1 Nefi 22:26; DeB 101:28). Teksa afrohet ai afat përfundimtar, forcat e të ligut po

luftojnë me dëshpërim për të pushtuar sa më shumë shpirta që mundën.

Gjon Zbuluesit iu tregua Lufta në Qiell si pjesë e një vegimi të madhërishtëm. Atij iu tregua se si Satani u dëbua poshtë në tokë që ta tundonte njerëzimin. Ky ishte reagimi i Gjonit: “Mjerë ju banorë të tokës e të detit, sepse zbriti djalli drejt jush duke pasur zemërim të madh, duke ditur se ka pak kohë” (Zbulesa 12:12).

Pra si i harxhon Satani ditët e tij, duke e ditur që nuk ka kohë për ta humbur? Apostulli Pjetër shkroi që “djalli, sillet rreth e qark si një luan vrumbullues, duke kërkuar cilin mund të përpijë” (1 Pjetër 5:8).

Çfarë e motivon Satanin? Ai kurrë nuk do të ketë një trup, kurrë nuk do të ketë bashkëshorte ose familje dhe kurrë nuk do të ketë plotësi të gëzimit, prandaj ai dëshiron t'i bëjë të gjithë burrat e gratë “të mjeruar sikurse është ai vetë” (2 Nefi 2:27).

Djali i vë në shënjestër të gjithë njerëzit, por veçanërisht ata që kanë potencialin më të madh për lumturi të përtjetshme. Në mënyrë të qartë, ai është xheloz për këdo që është në shtegun e ekzaltimit. Shkrimet e shenjta na mësojnë se Satani “u shpall luftë shenjtoreve të Perëndisë dhe i mbështjell ata përreth” (DeB 76:29).

Lufta që filloi në qiell, vazhdon deri më sot. Në fakt, beteja po ndizet ndërkohë që shenjtoret përgatiten për kthimin e Shpëtimtarit.

Presidenti Brigam Jang (1801–1877) profetizoi “se Kisha do të përhapej, përparonte, rritej e zgjerohej dhe, në përpjesëtim të drejtë me shpërndarjen e Ungjillit mes kombeve të tokës, po ashtu do të rritej fuqia e Satanit”<sup>3</sup>.

Mendoj se ne të gjithë do të binim dakord që kjo profeci po përmbushet teksa e shohim ligësinë të depërtojë pa u ndier në shoqëritë e botës. Presidenti Jang dha mësim se ne kemi nevojë t'i studiojmë taktikat e armikut me qëllim që ta mundim atë. Do të tregoj për katër strategji të provuara të Satanit dhe disa ide se si t'i kundërshtojmë ato.

## Strategjitë e Satanit

**1. Tundimi.** Djalli është i pacipë për sa i përket futjes së ideve të liga në mendjet tona. Libri i Mormonit na mëson se Satani pëshpërit mendime të papastra e të pakëndshme

dhe mbjell mendime dyshimi. Ai na ngacmon që të veprimë sipas nxitjeve vartësuese dhe të kënaqim egoizmin dhe lakminë. Ai nuk dëshiron që ne ta dallojmë se prej nga po vijnë këto ide, prandaj pëshpërit: “Unë nuk jam djall, pasi nuk ka asnjë” (2 Nefi 28:22).

Si mund ta kundërshtojmë këtë tundim të drejtpërdrejtë? Një nga mjetet më të efektshme është thjesht ta përzëmë Satanin. Kjo është ajo që do të bënte Jezusi.

Rrëfimi i Dhiatës së Re për Shpëtimtarin në malin e tundimeve është udhëzues. Pas çdo tundimi që djalli ia paraqiti Atij, Jezusi përdori një teknikë mbrojtëse me dy faza: së pari, Ai e urdhëroi Satanin të largohej; më pas Ai citoi shkrimin e shenjtë.

Më lejoni t'ju jap një shembull: “Shporru, Satan”, urdhëroi Jezusi, “sepse është shkruar: ‘Adhuro Zotin, Perëndinë tënde, dhe shërbeji vetëm atij’” (Mateu 4:10). Vargu pasues shënon: “Atëherë djalli e la; dhe ja, u afruan engjëjt dhe i shërbenin” (Mateu 4:11). Mbrojtja e Shpëtimtarit ishte shumë e efektshme!

Biografia e Presidentit Hibër J. Grant (1856–1945) jep ide se si Presidenti Grant, kur ishte i ri, e kundërshtoi djallin. Kur Presidenti Grant e kuptoi se Satani po i pëshpëriste, duke u përpjekur të mbillte dyshime në zemrën e tij, ai thjesht tha me zë të lartë: “Zoti Djall, qepe”<sup>4</sup>.

Ju keni të drejtën t'i thoni Satanit të largohet kur përballeni me tundimin. Shkrimet e shenjta na mësojnë: “Kundërshtoni djallin dhe ai do të largohet nga ju” (Jakob [Bibël] 4:7).

Pjesa tjetër e mbrojtjes së Shpëtimtarit ishte të citonte shkrimin e shenjtë. Ka fuqi të madhe në mësimin përmendsh të shkrimit të shenjtë, siç bëri Jezusi. Vargjet e shkrimeve të shenjta mund të bëhen një arsenal i municionit shpirtëror.

Kur tundoheni, ju mund të thoni me zë urdhërime të tilla si: “Mbaje mend ditën e shtunë për ta shenjtëruar”, “Doni armiqtë tuaj” ose “Virtyti duhet t'i stolisë mendimet e tua pa pushim” (Eksodi 20:8; Lluka 6:27; DeB 121:45). Fuqia e shkrimeve të shenjta jo vetëm që e tremb Satanin, por ajo gjithashtu e fut Shpirtin në zemrën tuaj, ju jep sërish siguri dhe ju forcon kundrejt tundimit.

**2. Gënjeshtat dhe mashtrimi.** Shkrimet e shenjta zbulojnë se Satani është “ati [i] gënjeshtrave” (2 Nefi 9:9).



Mos i besoni kur ai pëshpërit mesazhe të tilla si: “Kurrë nuk e bën diçka siç duhet”, “Je shumë mëkatar për t’u falur”, “Nuk do të ndryshosh kurrë”, “Askush nuk shqetësohet për ty” dhe “Nuk ke asnjë talent”.

Një tjetër prej gënjeshtërave të tij të përdorura shpesh është sa vijon: “Ke nevojë ta provosh gjithçka të paktën një herë – thjesht për të fituar përvojë. Një herë nuk do të të lëndojë.” E fshehta e vogël ndotëse që ai nuk dëshiron që ju ta dini, është se mëkati është vartësues.

Një gënjeshtër tjetër e efektshme që Satani do ta provojë te ju, është kjo: “Kushdo tjetër po e bën atë. Është në rregull.” Nuk është në rregull! Prandaj i thoni djallit se nuk dëshironi të shkoni në mbretërinë telestiale – edhe nëse kushdo tjetër po shkon atje.

Megjithëse Satani do t’ju gënjejë, ju mund të mbështeteni

te Shpirti që t’ju thotë të vërtetën. Kjo është arsyeja pse dhurata e Frymës së Shenjtë është kaq thelbësore.

Djalli është quajtur “mashtuesi i madh”<sup>5</sup>. Ai përpiqet ta falsifikojë çdo parim të vërtetë që paraqet Zoti.

Mbani mend, falsifikimet nuk janë të njëjta me të kundërtat. E kundërta e së bardhës është e zeza, por një falsifikim për të bardhën mund të jetë e bardha e çngjyrosur apo grija. Falsifikimet kanë ngjashmëri me gjënë e vërtetë me qëllim që t’i mashtrojnë njerëzit jodyshtues. Ato janë një variant i shtrembëruar i diçkaje të mirë dhe ashtu si paratë e falsifikuara, janë të pavlefshme. Më lejoni ta ilustrtoj.

Një nga falsifikimet e Satanit për besimin është besëtytnia. Falsifikimi i tij për dashurinë është epshi. Ai e falsifikon priftërinë duke paraqitur intrigat e priftërisë dhe i imiton mrekullitë e Perëndisë me anë të magjisë.

*Ju mund të mbështeteni te Shpirti për ta dalluar të vërtetën. Kjo është arsyeja pse dhurata e Frymës së Shenjtë është kaq thelbësore.*



Martesa midis një burri e një gruaje shugurohet nga Perëndia, por martesa midis të njëjtit seks është vetëm një falsifikim. Ajo nuk sjell as pasardhës as ekzaltim. Edhe pse imitimet e tij mashtrojnë shumë njerëz, ato nuk janë gjëja e vërtetë. Ato nuk mund të sjellin lumturi afatgjatë.

Perëndia na paralajmëroi rreth falsifikimeve të Doktrina e Besëlidhjet. Ai tha: “Ajo që nuk lartëson, nuk është prej Perëndisë dhe është errësirë” (DeB 50:23).

**3. Grindja.** Satani është ati i grindjes. Shpëtimtari dha mësim: “Ai nxiti zemrat e njerëzve, që të grinden me zemërim me njëri-tjetrin” (3 Nefi 11:29).

Djali ka mësuar nga shekujt e përvojës se, atje ku ka grindje, Shpirti i Zotit do të largohet. Prandaj, që kur e bindi Kainin të vriste Abelin, Satani i ka ndikuar motrat e vëllezërit që të zihen. Ai gjithashtu nxiti probleme në martesat,

mes anëtarëve të lagjes dhe midis dysheve misionare. Ai kënaqet kur i sheh njerëzit e mirë të debatojnë. Ai përpiqet të fillojë debate familjare pikërisht përpara kishës të dielën, pikërisht përpara mbrëmjes familjare të shtëpisë të hënën në darkë dhe kurdoherë që një çift planifikon të frekuentojë një sesion tempulli. Koha e tij është e parashikueshme.

Kur ka grindje në shtëpinë tuaj ose vendin tuaj të punës, menjëherë ndaleni çfarëdo që po bëni, dhe kërkonit të bëni paqe. Nuk ka rëndësi se kush e filloi.

Grindja shpesh fillon me hedhjen e fajit. Jozef Smithi dha mësim që “djalli na lajkaton se jemi shumë të drejtë, kur ne përqendrohemi tek të metat e të tjerëve”<sup>6</sup>. Kur mendoni për këtë, vetëdrejtësia është veçse një falsifikim i drejtësisë së vërtetë.

Satanit i pëlqen shumë të shpërndajë grindje në Kishë. Ai specializohet në vënien në dukje të fajeve të udhëheqësve të Kishës. Jozef Smithi i paralajmëroi shenjtorët se hapi fillestar drejt braktisjes është të humbasim vetëbesimin tek udhëheqësit e Kishës.<sup>7</sup>

Pothuajse e gjithë literatura antimormone bazohet në gënjeshtër rreth karakterit të Jozef Smithit. Armiku punon shumë për ta diskredituar Jozefin ngaqë mesazhi i Rivendosjes varet nga rrëfimi i Profetit për atë që ndodhi në Korijen e Shenjtë. Djalli po vepron më shumë sot sesa ndonjëherë më parë për t'i bërë anëtarët që t'i vënë në dyshim dëshmitë e tyre për Rivendosjen.

Në ditët e hershme të periudhës sonë të kujdestarisë ungjillore, shumë vëllezër priftërorë nuk qëndruan besnikë ndaj Profetit, gjë për të cilën ndien keqardhje më pas. Një prej tyre ishte Liman E. Xhonsoni, i cili u shkishërua për sjellje të padrejtë. Më vonë ai shprehu hidhërim që e kishte lënë Kishën: “Do të lejoja që të më pritej dora e djathtë, po të mund ta besoja atë përsëri. Në atë kohë isha plot gëzim e hare. Ëndrrat e mia ishin të këndshme. Kur zgjohesha në mëngjes shpirti im ishte i gëzuar. Isha i lumtur ditë e natë, plot paqe, gëzim dhe mirënjohje. Por tani është errësirë, dhembje, hidhërim, mjerim i skajshëm. Kurrë nuk kam parë një çast të lumtur që atëherë.”<sup>8</sup>

Mendoni rreth këtyre fjalëve. Ato qëndrojnë si paralajmërim për të gjithë anëtarët e Kishës.

Unë jam një i kthyer në besim në Kishë. U pagëzova kur

isha një i ri beqar në moshën 23-vjeçare duke frekuentuar shkollën mjekësore në Arizonë të SHBA-së. E di nga vetë përvoja ime se si Satani vepron me kërkuesit që t'i pësjtjellojë e shkurojë ata kur po kërkojnë të vërtetën.

Gjatë gjithë rinisë sime, i kisha parë shembujt e shokëve të mi shenjtorë të ditëve të mëvonshme. Më kishte lënë mbresë mënyra se si silleshin në jetën e tyre. Mora vendimin të mësoja më shumë rreth Kishës, por nuk doja t'i tregoja askujt se po studioja mormonizmin. Për t'iu shmangur shtytjes nga shokët e mi, vendosa ta bëja hetimin tim një kërkim vetjak.

Kjo ishte shumë vite përpara internetit, prandaj shkova në bibliotekën publike. Gjeta një kopje të Librit të Mormonit dhe një libër të quajtur *A Marvelous Work and a Wonder [Një Punë e Mrekullueshme dhe një Çudi]*, nga Plaku LeGrand Riçards (1886–1983), i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve. Fillova t'i lexoja këto libra me dëshirë të madhe dhe mendova se ishin frymëzues.

Ndërkohë që shpirti im kishte dëshirë të mësonte më shumë, Satani filloi të më pëshpëriste në vesh. Ai më tha se, me qëllim që të isha tërësisht i paanshëm, më nevojitej të lexoja se çfarë ishte shkruar nga kritikët e Kishës gjithashtu. Shkova sërish në bibliotekën publike dhe fillova të kërkoj përreth. Sigurisht, gjeta një libër që e diskreditonte Profetin Jozef.

Më pësjtjelloi leximi i këtij libri antimormon. E humba atë shpirt dhe ndikim të ëmbël që e kishte udhërrëfyer kërkimin tim. U zemërova dhe isha gati ta braktisja hetimin tim për të vërtetën. Po lutesha për një përgjigje ndërkohë që lexoja literaturë antimormone!

Për habinë time, mora një telefonatë nga një shoqe e shkollës së mesme, e cila po frekuentonte Universitetin "Brigam Jang". Më ftoi të vija dhe ta vizitoja atë në Jutë,



duke premtuar se do të më pëlqente shumë udhëtimi piktoresk. Ajo nuk kishte asnjë ide se po studioja fshehurazi rreth Kishës së saj.

E pranova ftesën. Shoqja ime sugjeroi që ne të shkonim në Solt-Lejk-Siti për të vizituar Sheshin e Tempullit. Ajo u habit nga përgjigja ime plot entuziazëm. Ajo nuk kishte asnjë ide se sa i interesuar isha të mësoja të vërtetën rreth Jozef Smithit dhe Rivendosjes.

Motrat misionare te Sheshi i Tempullit ishin shumë ndihmuese. Pa e ditur, ato u dhanë përgjigje shumë prej pyetjeve të mia. Dëshmitë e tyre më ndikuan që të "k[isha] dyshim të dyshimet [e mia]"<sup>9</sup> dhe besimi im filloi të rritej. Fuqia e një dëshmie të përzemërt nuk mund të vlerësohet sa duhet.

**Djali vë në shënjestër çdo njeri,  
por veçanërisht ata që kanë  
potencialin më të madh për  
lumturi të përrjetshme.**

Edhe shoqja ime e ndau dëshminë e saj me mua dhe më ftoi të lutesha e t'i kërkoja Perëndisë nëse Kisha ishte e vërtetë. Përgjatë udhëtimit të gjatë me makinë për t'u kthyer në Arizonë, fillova të lutem me besim – për herë të parë “me një zemër të sinqertë, me qëllim të vërtetë” (Moroni 10:4). Në një çast gjatë atij udhëtimit, m'u duk sikur e tërë makina ime u ndriçua me dritë. Mësova vetë se drita mund ta largojë errësirën.

Pasi kisha vendosur të pagëzohesha, djalli ndërmoi një përpjekje të fundit. Ai veptoi me familjen time, e cila bëri gjithçka që kishte fuqi, për të më shkurajuar dhe ata nuk pranuan të merrnin pjesë në pagëzimin tim.

Pavarësisht nga kjo u pagëzova dhe dalëngadalë zemrat e tyre u zbutën. Filluan të më ndihmonin të kërkoja historinë time familjare. Pak vite më vonë pagëzova vëllanë tim më të vogël. Shoqja që më ftoi ta vizitoja në Jutë, është tani bashkëshortja ime.

**4. Shkurajimi.** Satani e përdor me efektshmëri këtë mjet mbi shenjtoret më besnikë kur gjithçka tjetër dështon. Mua, kur filloj të ndihem i shkurajuar, më ndihmon që thjesht të dalloj se kush po përpriqet të më rrëzojë. Kjo më nevrifikos aq sa të gëzohem – thjesht që ta zemëroj djallin.

Disa vite më parë, Presidenti Benson dha një bisedë të titulluar “Do Not Despair” [“Mos u Dëshpëroni”]. Në atë bisedë kuptimplote, ai paralajmëroi: “Satani po përpriqet gjithnjë e më shumë t'i mposhtë shenjtoret me dëshpërim, shkurajim, trishtim e depresion”<sup>10</sup>. Presidenti Benson i nxiti anëtarët e Kishës që të ishin vigjilentë dhe ai dha 12 sugjerime realiste për ta luftuar shkurajimin.

Sugjerimet e tij përfshijnë shërbimin ndaj të tjerëve; të punuarin shumë dhe shmangien e përtacisë; të ushtruarin e zakoneve të mira të shëndetit, që përfshijnë ushtrimin fizik dhe ngrënien e ushqimeve në gjendjen e tyre natyrore; kërkimin e një bekimi priftëror; dëgjimin e muzikës frymëzuese; numërimin e bekimeve tuaja; dhe caktimin e synimeve. Dhe mbi të gjitha, siç na mësojnë shkrimet e shenjtës, ne duhet të lutemi gjithmonë që të mund ta mposhtim Satanin (shih DeB 10:5).<sup>11</sup>

*Satani dridhet kur e sheh  
Shenjtorin më të dobët të gjuhëzohet.*<sup>12</sup>

Është e rëndësishme të dimë se ka kufij të fuqisë së të ligut. Kreu-Perëndi i cakton ata kufij dhe Satani nuk lejonet t'i kapërcejë ata. Për shembull, shkrimet e shenjtës na sigurojnë se “fuqi nuk i është dhënë Satanit për t'i tunduar fëmijët e vegjël” (DeB 29:47).

Një tjetër kufizim domethënës është që Satani nuk i njeh mendimet tona, në qoftë se nuk ia themi atij. Zoti shpjegoi: “S'ka asnjë tjetër, përveç Perëndisë, që i di mendimet e tua dhe qëllimet e zemrës tënde” (DeB 6:16).

Ndoshta kjo është arsyeja përse Zoti na ka dhënë urdhërimet të tilla si: “Mos mermërit” (DeB 9:6) dhe “Mos fol keq për të afërmin tënd” (DeB 42:27). Nëse ju mund të mësoni t'i vini fre gjuhës suaj (shih Jakob [Bibël] 1:26), nuk do të përfundoni duke i dhënë shumë informacion djallit. Kur dëgjon mermëritje, ankim dhe kritikë, ai mban shënime plot kujdes. Fjalët tuaja negative ia nxjerrin në pah dobësitë tuaja armikut.

Unë kam lajme të mira për ju. Ushtritë e Perëndisë janë më të mëdha sesa ushtritë e Luciferit. Mund të shihni përrëth dhe të mendoni me vete: “Bota po bëhet gjithnjë e më e ligë. Satani duhet të jetë duke e fituar luftën.” Mos u mashtroni. E vërteta është që ne jemi më të shumtë në numër sesa armiku. Mbani mend, dy të tretat e fëmijëve të Perëndisë zgjedhën planin e Atit.

Vëllezër e motra, sigurohuni që po luftoni në anën e Zotit. Sigurohuni që po mbartni shpatën e Shpirtit.

Është lutja ime që, në fund të jetës suaj, ju mund të thoni me Apostullin Pal: “Luftën e mirë e luftova, e përfundova vrapimin, e ruajta besimin” (2 Timoteut 4:7). ■

#### SHËNIME

1. Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjtës, “Lucifer”, scriptures.lds.org.
2. Ezra Taft Benson, “Beware of Pride”, *Ensign*, maj 1989, f. 5.
3. *Discourses of Brigham Young*, përzgji. John A. Widtsoe (1954), f. 72.
4. Shih Francis M. Gibbons, *Heber J. Grant: Man of Steel, Prophet of God* (1979), f. 35–36.
5. Shih, për shembull, Diter F. Uhtdorf, “Ju Keni Rëndësi për Të”, *Liahona*, nëntor 2011, f. 20; Gordon B. Hinckley, “The Times in Which We Live”, *Liahona*, janar 2002, f. 86.
6. *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2007), f. 484.
7. Shih *Mësimet: Jozef Smith*, f. 339.
8. Lyman E. Johnson, në Brigham Young, *Deseret News*, 15 gusht 1877, f. 484.
9. Diter F. Uhtdorf, “Ejani, Bashkohuni me Ne”, *Liahona*, nëntor 2013, f. 23.
10. Ezra Taft Benson, “Do Not Despair”, *Ensign*, nëntor 1974, f. 65.
11. Shih Ezra Taft Benson, “Do Not Despair”, f. 65–67.
12. William Cowper, në Robert Andrews, përmb., *The Concise Columbia Dictionary of Quotations* (1987), f. 78.

*Skaidritja është një nga njerëzit më të lumtur që kam takuar ndonjëherë. Jeta e saj duket plotësisht e përsosur. Por kur ishte fëmijë ajo jetonte me nënën e saj të alkoolizuar, e cila ishte e paafte të kujdesej për të dhe motrën e saj. Skaidritja i mbajti dorën motrës së saj ndërsa ajo vdiq nga uria. Duke filluar nga mosha 8 vjeç, Skaidritja jetoi në një varg shtëpish birësimi. Atë e rrahën, e dhunuan dhe ia ndaluan që të lutej. Atë e trajtuan si skllave. Për gjatë viteve, ajo mendoi [seriozisht] për vetëvrasjen.*

*Vite më vonë, në kërkim të shpësës, Skaidritja hyri në një shtëpi mbledhjesh të shdm.*

LESLI NILSSON, FOTOGRAFE

## Skaidrite Bokuma

Liepaja, Letoni

“Një motër misionare më përshëndeti dhe buzëqeshi. Unë mendova se ajo ishte një engjëll. Që prej asaj dite, jeta ime ka ndryshuar. Kanë kaluar 17 vite tashmë dhe të gjitha mendimet për t’i dhënë fund jetës sime janë zhdukur. Sot, unë jam optimiste. Kur kam barrë [në jetë], i ndaj ato me Perëndinë. Kam mësuar të mbështetem tek Ai për çdo gjë. Jeta është e bukur për mua.”

Mësoni se si t’i dalloni dhe t’i ndihmoni ata që mund të jenë duke marrë parasysh vetëvrasjen, në internet në [lds.org/go/41739](https://lds.org/go/41739).







## JU LUTEM, MOS E VINI ATË KËNGË

Kohë më parë, unë dhe familja ime kjetonim në Verakruz të Meksikës, ku fëmijët e mi ndiqnin shkollën fillore. Çdo mëngjes, teksa i ndihmoja tre fëmijët e mi të përgatiteshin për në shkollë, ne dëgjonim radion – stacionin më të pëlqyer në qytet – me një program shumë të këndshëm që drejtohej nga një folës i ri i radios.

Ne filluam të dëgjonim një këngë që të mbetej në mendje. Ndërsa fillova t'i kushtoja më shumë vëmendje tekstit të këngës, kuptova se gjërat që thoshte, edhe pse jo vulgare, përçonin nënkuptim dhe ishin të vrazhda.

I thashë vendosmërisht fëmijëve të mi: “Ne nuk mund ta dëgjojmë këtë lloj gjuhe”. Ndoshta ata as që nuk i kushtuan vëmendje tekstit të këngës, por vërtet i kushtuan mjaftueshëm vëmendje sa ta këndonin nën zë melodinë e saj.

Ata më panë tek ia mbylla zërin sistemit stereo dhe më pyetën se çfarë po bëja. “Unë do t'i them folësit të radios ta heqë atë këngë nga programi.” Habia e tyre më dha guximin që të merrja masa të mëtejshme.

Ata nuk mund ta besonin atë dhe as unë, por unë e ngrita receptorin dhe i telefonova stacionit të radios. Nuk prisja të merrja përgjigje por, për habinë time, i njëjti folës i radios që sapo kishim dëgjuar në emision, iu përgjigj telefonatës sime pothuajse menjëherë.

Unë i thashë se nuk isha dakord që të dëgjohej ajo këngë, pasi shumë

**K**ur ne dëgjuam në radio një këngë që të mbetej në mendje, unë fillova t'i kushtoja më shumë vëmendje tekstit të këngës.

familje e dëgjonin radion në atë orë të mëngjesit. Ai më pyeti se me çfarë do të sugjeroja unë që ta zëvendësonte atë, por sjellja e tij ishte aq e edukuar sa unë kërkova vetëm që ai të mos e vinte atë këngë gjatë kohës kur fëmijët ishin në shtëpi.

Unë kurrë nuk e mora vesh nëse telefonata ime po transmetohej, por unë qeshë thjesht mirënjohëse që folësi i radios më kishte dëgjuar. Dhe për disa nga ditët e ardhshme, unë mund ta shihja që kërkesa ime që plotësuar.

Ajo përvojë më konfirmoi se ne duhet të jemi të guximshëm kur është në dorën tonë që të marrim vendime dhe të bëjmë atë që është e nevojshme për t'i mbrojtur fëmijët tanë nga ndikimet negative. Ndërsa e bëjmë këtë, Fryma e Shenjtë mund të vazhdojë të jetë shoqëruesi ynë i vazhdueshëm. ■

Maria Hernandez, Teksas, SHBA



# PORTOFOLI I HUMBUR

Kohët e fundit u shpërngula në një shtëpi të re dhe u kërkova disa anëtarëve të Kishës që të më ndihmonin me një projekt në shtëpinë time. Në mes të projektit, unë u largova për të blerë disa materiale që na nevojiteshin për të mbaruar. Pasi e mbaruam projektin, unë kuptova se nuk e kisha portofolin tim. Më zuri paniku sepse brenda portofolit tim gjendeshin të gjitha dokumentet e mia vetjake bashkë me paratë që sapo kisha marrë nga një klient atë mëngjes. I ripërshkrova hapat për te vendi ku kisha bërë blerjet por nuk pata fat. Shkova në shtëpi dhe kërkova për të parë nëse më kishte rënë diku por përsëri nuk e gjeta. Fillova të merrja në konsideratë mundësinë që do të më duhej të siguroja kopje të reja të të gjitha dokumenteve. Më pas para se të largohej nga shtëpia ime, një mik më pyeti: “A je lutur tanimë?”

Menjëherë mendova: “Sigurisht që jam lutur tashmë!”

Por në të vërtetë, nuk isha lutur me qëllim të vërtetë. Në vend të kësaj, unë desha të imponoja vullnetin tim mbi Atin Qiellor dhe në njëfarë mënyre ta bëja detyrë të Tij që të më ndihmonte për ta gjetur portofolin tim. Por më pas m'u kujtua shkrimi i shenjtë tek Isaia 55:8: “Duke qenë se mendimet e mia nuk janë mendimet tuaja, dhe as rrugët tuaja nuk janë rrugët e mia, thotë Zoti”.



Kërkova Atit Qiellor që t'i përgjigjej lutjes sonë me qëllim që ta forconte besimin e gruas dhe të fëmijëve të mi.

Të dielën shkova në Kishë dhe një anëtar, i cili kishte qenë me mua një ditë më parë, më tha se i ishte lutur me zell Atit Qiellor që unë të mund ta gjeja portofolin tim. Ai tha se e kishte ndier që unë do ta gjeja atë. Më vonë, teksa u ula për studimin tim vetjak, fillova të lexoja *Receiving Answers to Our Prayers [Të Marrim Përgjigje për Lutjet Tona]* nga Plaku Xhin R. Kuk, anëtar nderi i Të Shtatëdhjetëve. Faqja e parë tregonte një histori me një problem njësoj si i imi: I biri i Plakut Kuk kishte humbur portofolin e tij, kështu që familja u mbloodh dhe iu lut së bashku Zotit që ata të mund ta gjenin atë.

Pasi e lexova atë përvojë, e vura në praktikë atë që mësova, dhe i mbloodha së bashku gruan dhe fëmijët. Ne formuam një rreth dhe çdo person

bëri një lutje, duke iu përgjigjur Zotit që të na ndihmonte ta gjenim portofolin nëse ishte vullneti i Tij.

Unë e kisha dëshmuar më parë fuqinë e lutjes por, më pas, teksa po lutesha privatisht, i kërkova Atit Qiellor që t'i përgjigjej lutjes sonë për ta forcuar besimin e bashkëshortes dhe të fëmijëve të mi.

Të nesërmen një burrë më mori në telefon. Ai tha se e kishte gjetur portofolin tim, përfshirë paratë. Unë qava si fëmijë sepse lutja ime kishte marrë përgjigje dhe besimi i familjes sime u forcua.

Unë e di se Ati Qiellor, edhe pse ka kaq shumë fëmijë për t'u kujdesur, i përgjigjet secilit prej nesh sipas kohës së Tij dhe në mënyrën e Tij. ■  
Luiz Marselino, Goiás, Brazil

## E SHPËTUAR NË KORRIDOR

**B**ashkëshorti im shpesh duhet të punojë të dielave, duke ma lënë mua përgjegjësinë për t'i çuar e vetme katër djemtë tanë në Kishë. Veçanërisht një të diel gjatë mbledhjes së sakramentit, dy vogëlushët e mi po grindeshin me njëri-tjetrin. Nëse e vija njërin nga djemtë e mi të shfaqte interes për një libër, e donte edhe i vëllai. U përpoqa me ushqime të shpejta, lodra dhe [fletë për] ngjyrosje, por asgjë nuk pati sukses. Isha shumë e lodhur me djemtë e mi, të cilëve as që u shkonte ndërmend të uleshin të qetë për një orë.

Nxora një lodër të vogël nga çanta dhe ia dhashë djalit tim njëvjeçar. Papritmas një britmë u lëshua nga djali im trevjeçar, Tajsoni, teksa e goditi vëllanë e tij më të vogël, në përpjekje për t'ia marrë lodrën. U turpërova ndërsa po i nxirja jashtë në korridor dy kalamajtë që ulërinin dhe grindeshin.

Fytyra m'u njom menjëherë nga lotët e nxehtë. Përse duhej të ishte kaq e vështirë? Unë po bëja atë që Ati Qiellor donte që unë të bëja, duke e sjellë familjen time në Kishë, apo jo? Por nuk mund të vazhdoja më. Ishte rraskapitëse dhe e sikletshme që të përpiqesha t'i mbaja e vetme djemtë e mi gjatë mbledhjes së sakramentit çdo javë. Unë nuk kisha më dëshirë të vija.

Rashë në këto mendime për vetëm 15 sekonda dhe më pas një motër që nuk e njihja mirë, erdhi pas meje jashtë në korridor. Emri i saj ishte motra Bjus. Zakonisht ajo ulej e vetme, pasi bashkëshorti i saj shërbente në peshkopatë dhe fëmijët i kishte të rritur.

Isha shumë e lodhur me djemtë e mi, të cilëve as që u shkonte ndërmend të uleshin të qetë për një orë.





## U KRYE!

Ajo tha: “Ti këtu je gjithnjë e vetme! E shoh që po përpiqesh shumë fort. A mund të ulet Tajsoni me mua?” Nuk po mendoja dot as edhe një përgjigje! Unë thjesht tunda kokën teksa ajo e mori për dore dhe e shoqëroi atë, tanimë të qetë dhe të gëzuar, sërish në sallën kishtarë.

I fshiva lotët, mora të voglin tim dhe me pëkulësi u ktheva sërish në sallën kishtarë për ta shijuar në paqe pjesën e mbetur të mbledhjes.

Të dielën tjetër teksa hymë në mbledhjen e sakramentit, Tajsoni po kërkonte mikeshën e tij të re. Natën ai lutej [duke thënë]: “Faleminderit Atë Qiellor për motrën Bjus. E dua atë kaq shumë!”

Kanë kaluar mbi tri vite dhe Tajsoni ende shpesh e kërkon motrën Bjus në sallën kishtarë. Vitin e kaluar ajo u thirr për të qenë mësuesja e Fillores së Tajsonit. Ai ishte djaloshi më i lumtur në gjithë botën.

Jam kaq mirënjohëse për motrën Bjus dhe gatishmërinë e saj për t'i dashur dhe për t'u shërbyer të tjerëve. Unë e di se ne mund ta bekojmë jetën e të tjerëve kur shërbejmë ashtu siç shërbeu Shpëtimtari. ■

Kristi Ljuis, Juta, SHBA

Gjatë intervistave të mia si peshkop, një të diel pasdite, pata kënaqësinë që të ulesha me një mik të mirë për të folur rreth disa sfidave me të cilat ai po përballej. Pasi i dëgjova shqetësimet e tij për disa minuta, ndjeva se ajo që i nevojitej atij, ishte vazhdueshmëri në leximin e shkrimeve të shenjta. U kujtova gjithashtu se, si peshkopi i tij, edhe unë duhet të isha më i qëndrueshëm në studimin tim të shkrimeve të shenjta, e cila ishte diçka me të cilën isha duke u përpjekur. Kështu që, unë sugjeroja që ne të bëheshim “ortakë përgjegjësie” në përpjekje për të studiuar më me qëndrueshmëri.


Çdo ditë, pasi mbaronim së lexuari shkrimet tona të shenjta, ne do t'i dërgonim me mesazh njëri-tjetrit fjalët *U krye!* Dijenia që dikush tjetër po priste për të dëgjuar a e kishte përfunduar tjetri leximin vetjak të shkrimeve të shenjta për ditën, ishte një shtysë e madhe për të dy. Nëse njëri prej nesh harronte, marrja e mesazhit ishte një kujtues. Nëse personi tjetër nuk dërgonte mesazh, atij nuk i kërkohesh llogari. Ne e lamë njëri-tjetrin ta ndërmerrem këto sfida pa e bërë personin tjetër të ndihej fajtor.

Ne e filluam sfidën gjashtë muaj më parë dhe unë nuk mbaj mend një ditë që ne i lamë pa lexuar shkrimet tona të shenjta. Ky vëlla u ngrit gjatë mbledhjes së agjërimit dhe dëshminë e tij për ndikimin pozitiv që studimi ditor i shkrimeve të shenjta kishte mbi të dhe familjen e tij.

Jam mirënjohës për këtë vëlla dhe për miqësinë e tij, si dhe për mesazhet e tij të përditshme. Unë e kam parë se si teknologjia, kur përdoret siç duhet, mund ta përmirësojë jetën tonë. Jam gjithashtu mirënjohës për shkrimet e shenjta dhe mënyrën se si ato dëshmojnë për Krishtin. Unë e di se sakrificat shlyese e Shpëtimtarit e bënë të mundur që secili prej nesh të kthehet për të jetuar me Të një ditë. ■

Aleks Uibli, Kolumbia Britanike, Kanada

Ne u bëmë “ortakë përgjegjësie” në përpjekje për t'i studiuar shkrimet e shenjta më me qëndrueshmëri.





### **LIAHONA JUAJ VETJAKE**

“Bekimi juaj nuk duhet të paloset me kujdes dhe të ruhet diku. Nuk është që të vihet në kornizë ose të bëhet publik. Përkundrazi, është që ta lexoni. Është që ta doni. Është që ta ndiqni. Bekimi juaj patriarkal do t’ju udhëheqë përmes natës më të errët. Do t’ju udhëheqë përmes rreziqeve të jetës. . . . Bekimi juaj patriarkal është për ju një Liahonë vetjake që t’ju hartojë kursin dhe t’ju udhëheqë në rrugën tuaj.”

**President Thomas S. Monson, “Your Patriarchal Blessing: A Liahona of Light”, *Ensign*, nëntor 1986, f. 66.**

# Të Kuptuarit e Bekimit Tuaj Patriarkal

Nga Elli Arnell dhe Margaret Uillden

**J**eta është plot me ujëra të parrahura: *Në cilën shkollë duhet të shkoj? Çfarë duhet të studioj? A duhet të shkoj në një mision? Me kë duhet të martohem?* Nëse do t'ju jepej një hartë vetjake për të lundruar nëpër vendimet e jetës, a do ta ndiqnit atë?

Ati Qiellor dhe Jezu Krishti na e kanë dhënë një hartë të tillë – bekimet patriarkale – që të na japin drejtim në jetën tonë. Edhe pse na jepet dhurata e lirisë së zgjedhjes për të marrë vendime sipas vetë vullnetit tonë të lirë, bekimet patriarkale mund të hedhin dritë mbi atë se cilat shtigje do të sjellin lumturinë më të madhe.


Por thjesht ta kemi një hartë nuk mjafton. Ne duhet ta studiojmë, kuptojmë dhe zbatojmë domethënien brenda hartës. Në mënyrë të ngjashme, teksa arrini të kuptoni gjuhën e përdorur në bekimin tuaj patriarkal – udhërrëfyesin tuaj vetjak në jetë – ju do të jeni në gjendje të dalloni se cili jeni në sytë e Perëndisë dhe çfarë mund të bëheni.

**Zbuloni Prejardhjen Tuaj**

Para së gjithash, bekimi juaj patriarkal shpall prejardhjen tuaj ose fisin e veçantë prej dymbëdhjetë fiseve të Jakobit (që më vonë u quajt Izrael) të cilit i përkisni. Edhe pse ne nuk jemi të gjithë pasardhës të mirëfilltë të Jakobit, shkrimet e shenjta na mësojnë se anëtarët e Kishës pranohen në shtëpinë e Izraelit: “Sepse të gjithë ata që e marrin këtë Ungjill, do të quhen sipas emrit tënd e do të llogariten si fara jote dhe do të ngrihen e do të të bekojnë ty, si atin e tyre” (Abraham 2:10).

Shelisa Shrepeli nga Juta, SHBA, thotë: “Njohuria se jam nga shtëpia e Jakobit më ndihmon të kuptoj qëllimin tim në këtë jetë dhe përse thirrrem në thirrje të caktuara në Kishë”.

Bekimi juaj patriarkal gjithashtu mund të përshkruajë ndonjë bekim përkatës që e shoqëron fisin tuaj të veçantë. Për shembull, shumë anëtarë të Kishës i përkasin fisit të Efraimit, një fis që ka përgjegjësinë e pashoqe për t'i shpërndarë botës mesazhin



**Përcaktimi i pjesëve të bekimit tuaj mund t'ju ndihmojë të gjeni drejtim për jetën tuaj.**

e ungjillit të rivendosur (shih Ligji i Përtërirë 33:13–17; DeB 133:26–34).

**Gjeni Këshillë Vetjake**

Kur përdoret siç duhet, një hartë e ndihmon një udhëtar që të mos ta humbasë udhën. Në mënyrë të ngjashme, në këtë udhëtim tokësor, bekimi juaj patriarkal mund të ofrojë këshillë dhe drejtim për jetën tuaj. Bekimi juaj patriarkal nuk ju tregon thjesht çfarë

## ORIENTIME PËR STUDIMIN

- Përcaktoni këshillat, paralajmërimet, talentet dhe premtimet në bekimin tuaj patriarkal. Lutuni rreth mënyrës se si ato mund të gjejnë zbatim për ju në fazën tuaj të tanishme të jetës.
- Studiojeni bekimin tuaj tërësisht dhe shpesh gjatë gjithë jetës suaj. E njëjta fjali mund të ketë kuptime të shumëfishme për ju në kohë të ndryshme.
- Mbani mend që një bekim patriarkal nuk përmend çdo fushë të jetës suaj. Edhe pse një synim i rëndësishëm nuk përmendet në bekimin tuaj, ai ende mund të jetë një gjë e rëndësishme për të cilën të përpiqeni.
- Jini të bindur ndaj ungjillit. Bekimet në bekimin tuaj patriarkal janë në varësi të drejtësisë suaj.
- Caktoni synime që të kërkoni dhuntitë dhe të zhvilloni talentet e përmendura në bekimin tuaj.
- Mendoni për ku jeni drejtuar në jetë dhe ku dëshironi të jeni në fund të fundit. Si përputhen synimet tuaja me bekimin tuaj patriarkal?
- Merrni parasysh të bëni një kopje të bekimit tuaj patriarkal që ta përdorni për studimin. Ju mund të shkruani ide, të nënvizoni fjalë që ju bien në sy, dhe të shënoni shkrime të shenjta që lidhen me bekimin tuaj.

të bëni, por mund të ofrojë ide të individualizuara se cilat shtigje – nëse ndiqen me besim – mund t’ju ndihmojnë të dini se kur e përputhni jetën tuaj me vullnetin e Atit Qiellor. Teksa e studioni bekimin tuaj patriarkal dhe kërkoni të jetoni në një mënyrë që e fton Shpirtin e Zotit, ju mund të gjeni siguri, gëzim dhe drejtim.

Gabriel Paredes nga Lima në Peru thotë: “Një pjesë të këshillës që m’u dha mua në bekimin tim, kam qenë në gjendje ta vë në jetë tërësisht me familjen time vetëm pasi u vulosa me bashkëshorten time.

Kohët e fundit po e pyetnim veten se çfarë mund të bënim për ta forcuar e ndërtuar familjen tonë të re. Pyetja jonë mori përgjigje nëpërmjet bekimit tim patriarkal. Në të unë këshillohem që t’u jap përparësi respektit, tolerancës dhe dashurisë në familjen time, sepse këto janë disa nga themelet e rëndësishme të ungjillit të Jezu Krishtit.

Teksa jemi përqendruar në këtë, unë dhe bashkëshortja ime kemi qenë në gjendje t’i kapërcejmë problemet. Ne ende kemi sfida herë pas here si familje, por jemi të lumtur. Ndjeva sikur Zoti po më kujtonte se si mund ta kisha familjen që Ai më premtoi. E di që Zoti flet nëpërmjet bekimeve patriarkale dhe që këshilla në to duhet të përdoret në jetën tonë.”

### Vërjuani Veshin Këshillimeve

Një hartë nuk do të shënojë domosdoshmërisht çdo rrezik përgjatë udhës por, për fat të mirë, bekimet patriarkale shpesh trumbetojnë paralajmërimet për të na mbrojtur përgjatë udhës.

Disa prej këtyre këshillimeve ndihmojnë për të na mbrojtur nga ndikimi i Satanit; të tjerat mund të na japin dritë rreth mënyrës se si mund ta mposhtim njeriun natyror brenda nesh.

Për Keitlin Kerrin nga Juta, disa prej këshillimeve në bekimin e saj patriarkal nuk ishin menjëherë të qarta, por studimi i mëvonshëm i bekimit të saj dha ide të reja.

“Kur e mora bekimin tim patriarkal, unë u paralajmërova rreth njerëzve që do të përpiqeshin të më largonin nga e vërteta nëpërmjet ideve që më pëlqenin. Nuk mendova shumë për të; pata besim të palëkundshëm në doktrinën që më ishin mësuar.

Megjithatë, vitin pasues po ndeshesha me ide dhe filozofi që, në sipërfaqe, dukeshin të rrënjësura në paanësi e dashuri, por nuk ishin. Këto mesazhe dukej se vinin nga çdo anë: media, shkolla, madje miqtë më të afërt. Edhe pse e dija që këto filozofi ishin në kundërshtim me planin e Perëndisë, e gjeta vetveten duke dëshiruar që t’i mbështetja si këto ide të reja të botës *ashtu edhe* Kishën. Shpejt e kuptova se ‘askush nuk mund t’u shërbejë dy zotërinjve’ (Mateu 6:24) dhe se unë nuk duhej të mbështetesha tek urtësia e njerëzve. Ati Qiellor u dha zgjidhje dyshimeve të mia nëpërmjet shkrimeve të shenjta dhe i foli paqe mendjes e zemrës sime. Si rrjedhojë, dëshmia ime është forcuar dhe jam bërë më e palëkundur në mbrojtjen e asaj që e di se është e vërtetë.”

### Zhvilloni Dhunti e Talente

Bekimi juaj patriarkal gjithashtu mund të përmendë dhunti e talente



shpirtërore që Zoti jua ka dhënë për ta ngritur mbretërinë e Tij. Nëse bekimi juaj përmend një talent që është i panjohur për ju, kjo mund të jetë ngaqë mund të mos e keni pasur ende rastin për ta zbuluar ose zhvilluar këtë talent. Nëpërmjet kërkimit të zellshëm dhe ndihmës së Zotit, ju mund të arrini ta mishëroni këtë talent dhe shumë të tjerë.

Zhvillimi i talenteve tuaja ju ndihmon të dalloni gjërat e pashoqe që ju jepni si ndihmesë në veprën e Zotit. Xhoana Blekuell nga Kalifornia, SHBA, i përsiat dhuntitë dhe talentet në bekimin e saj kur ndihet e tunduar që ta krahasojë vetveten me të tjerët: “Teksa hedh vështrimin te fjalët në bekimin tim patriarkal, më vjen ndërmend se jam bekuar me dhuntitë që më janë dashur personalisht për t’i mposhtur sprovat dhe për të marrë pjesë në përshpejtimin e veprës së Zotit.

Bekimi im më tregon për aftësinë time për të dashur, falur e pasur

kurajën që të shoqërohem me njerëzit përreth meje. Kur i kam praktikuar këto dhunti, Zoti më ka bekuar me një dëshirë në rritje që të takohem e lidhem me njerëz të rinj e kultura të reja. Si rrjedhim, është rritur dëshmia ime që ne jemi të gjithë fëmijë të një Ati të dashur Qiellor dhe unë kam qenë në gjendje t’u shërbej të tjerëve, ndërkohë që secili prej nesh përpiqet të bëhet më shumë si Krishti.”

### Kërkojini Bekimet e Premtuara

Së fundi, bekimet tona patriarkale zbulojnë bekimet e premtuara të Atit Qiellor për ne nëse i qëndrojmë besnikë Atij. Nuk ka garanci se kur do të përmbushen këto premtime, por ne mund ta dimë se, për aq kohë sa e jetojmë me bindje ungjillin, ato do të përmbushen, qoftë në këtë jetë apo në jetën që vjen.

Serxhio Gutierres nga Nevada, SHBA, mbështetet në një premtim në bekimin e tij patriarkal kurdoherë që ndihet i shqetësuar rreth

planeve të tij të ardhshme të karrierës: “Me raste ndihem i shqetësuar rreth pasigurisë së të ardhmes sime, por ka një premtim në bekimin tim patriarkal që gjithmonë ma qetëson mendjen. Ky premtim më ndihmon ta di se, për aq kohë sa punoj shumë dhe mbetem besnik, unë do të kem burimet e nevojshme që të jem në gjendje të kujdesem për familjen time dhe që të ndërtoj Kishën. Nuk e di ende saktësisht se çfarë shtegu karriere dëshiroj të ndjek, por pasja e këtij premtimi më jep besim e vetëbesim.”

Nëse e keni pyetur veten ndonjëherë se cili është vullneti i Atit Qiellor për ju, ju nuk jeni i vetëm. Zoti e kuptoi se ju do të përballeshit me shumë shtigje të ndryshme që mund t’i ndiqnit në jetën tuaj, prandaj Ai ju ka dhënë një hartë vetjake që ta mbani jetën tuaj në përputhje me ungjillin e Tij. Bekimet patriarkale nuk mund t’i marrin vendimet tona për ne, por mund të na çojnë drejt zbulësës sonë vetjake. Nëpërmjet bekimeve tona patriarkale, na tregohet se si zëmë vend në planin e Zotit për ta mbledhur Izraelin nëpërmjet të mësuarit për fisin tonë; na jepen këshilla, këshillime dhe premtime vetjake; dhe na mësohet rreth dhuntive e talenteve të pashoqe që Ati Qiellor na ka dhënë për t’i shërbyer Atij. Për aq kohë sa përpiqeni të jetoni në përputhje me të gjitha këto elemente të vetë bekimit tuaj patriarkal, ju mund të dini se vendimet tuaja kanë qenë brenda vullnetit të Zotit për jetën tuaj. ■

*Autoret jetojnë përkatësisht në Illinois, SHBA, dhe Nju-Jork, SHBA.*



**Zoti ju ka dhënë një hartë vetjake që ta mbani jetën tuaj në përputhje me ungjillin e Tij.**

# Përgatitja për një Udhëtim të Ri

Nga Karina Martins Pereira Korreia de Lima

**G**jatë javëve që çuan në martesën dhe vulosjen time në tempull, unë fillova të bëhesha pak nervoze rreth të gjitha gjërave që duhej të bëja përpara se të krijoja familjen time të re. Pavarësisht gjithë gëzimit të atij çasti, unë u ndjeva e mbingarkuar rreth organizimit të rutinës sonë të re, administrimit siç duhet të financave tona, gjetjes së një depoje për gjërat tona personale dhe për të gjitha përgjegjësitë e mia të reja si një bashkëshorte. Doja të sigurohesha që ta nisnim martesën tonë në mënyrën e duhur duke krijuar hapësira në vepërimtaritë tona për gjëra të rëndësishme si zbatimi i urdhërimeve dhe kalimi i kohës së bashku si bashkëshort e bashkëshorte pavarësisht jetës sonë të zënë me punë.

Teksa dita e dasmës afrohej, u befasova nga një seri makthesh që përfshinin të gjitha llojet e shqetësimeve që mund të preknin një familje.

Për shkak se unë vij nga një familje e dashur por me problematika, e kërcënuar nga zënka të vazhdueshme e të rënda si dhe nga zemra të thyera, ëndrrat e këqija më prekën mua më shumë se ç'duhej. Kështu që një natë, pas disa netëve të ngjashme me to, u zgjova duke djersitur dhe vendosa ta ndiqja këshillën që Motra Nill F. Mariot, Këshilltare e Dytë në Presidencën e Përgjithshme të Të Rejave, dha në bisedën e saj “Dorëzimi i Zemrave Tona Perëndisë” (*Liahona*, nëntor 2015, f. 30–32). I mbylla sytë dhe u luta: “I dashur Atë Qiellor, çfarë mund të bëj që t’i mbaj këto gjëra të këqija larg familjes sime?”

Përgjigjja më goditi aq shpejt e aq fuqishëm sikur dikush të kishte hapur një derë në kokën time dhe të ma kishte vendosur mendimin atje. Zëri i qetë e i ulët më nxiti: “Thjesht bëj atë që duhet të bësh. Ji besnike në çdo hap.” Shpirti më pëshpëriti disa këshilla specifike dhe unë ndjeva

**Sikurse Nefi që lundroi drejt së panjohurës, edhe unë duhej të ushtroja besim në Zot për krijimin e një familjeje.**

se po t’i bëja ato gjëra, gjithçka do të ishte mirë.

Unë buzëqesha dhe e ndjeva kraharorin të më mbushej me ngrohtësi. Të gjitha shqetësimet papritmas u harruan, sepse e dija që ishte e vërtetë. E kisha ndier Frymën e Shenjtë më parë, por kurrë aq fort sa e ndjeva atë natë. Ndjeva dashurinë e Atit tonë Qiellor



dhe të Shpëtimtarit tonë të më rrethonte dhe e dija se ngushëllimi dhe shpëtimi i familjes sime ishin po aq të rëndësishëm për Ta sa ishin edhe për mua.

Si një sigurim më shumë, një histori nga shkrimet e shenjta më erdhi në kujtesë – çasti kur Zoti e urdhëroi Nefin të ndërtonte një anije: “Dhe ndodhi që Zoti më foli, duke thënë: Ti do të ndërtoosh një anije *sipas mënyrës që unë do të të tregoj*, që unë të mund të mbart njerëzit e tu përmes këtyre ujërave” (1 Nefi 17:8; theksimi i shtuar).

Nefi dhe familja e tij kishin qenë në vendin e shkretë për shumë vite, duke i duruar të gjitha llojet e mundimeve. Ai mund të ketë pasur druajtje të niste një udhëtim përmes detit dhe [mund] ta kishte lejuar frikën e tij që të bëhej më e fortë sesa besimi i tij. Por nuk pati. Ai i pranoi udhëzimet e Perëndisë dhe iu bind atyre. Ai kishte besim se premtimet e Tij do të përmbusheshin. Zoti nuk i tha kurrë Nefit se stuhitë nuk do të ndodhnin ose që dallgët nuk do ta goditnin anijen. Por Ai i tha Nefit se, nëse ai do t'i ndiqte udhëzimet e Tij, ai do të ishte në gjendje ta udhërrëfente familjen e tij të sigurt përmes oqeanit për në tokën e premtuar.

Kuptova se edhe unë kisha udhëtuar përmes një vendi të shkretë për shumë vite, por tani isha përballë detit, duke u përgatitur për një udhëtim të ri: martesën. Isha thirrur – dhe mendoj se kështu ndodh për të gjitha familjet shenjtoje të ditëve të mëvonshme – për të ndërtuar një anije duke ndjekur udhëzimet e Perëndisë.

Porsa unë dhe bashkëshorti im u martuam, shqetësimet erdhën vërtet. Unë u sëmura dhe ne e patëm të vështirë t'i mbanim të ekuilibruara çështjet tona financiare dhe të vinim në zbatim të gjitha zakonet e mira që kishim vendosur të ndiqnim.

Por këshilla që kisha marrë atë natë, mbeti në zemrën time. Ne përditë u përpoqëm të mësonim dhe ta ruanim si thesar fjalën e Perëndisë në zemrën tonë, t'i ndiqnim shembujt e mirë të udhëheqësve tanë të dashur – përfshi Krishtin – dhe të përmirësonim vetë sjelljen tonë. Unë fitova një dëshmi më të fortë për lutjen dhe e provova me të vërtetë dashurinë e Atit për ne. Unë fillova të mirëbesoja më shumë dhe të kisha më pak frikë. Ne e kuptuam që vështirësitë, të cilat hasëm, ishin kthyer në hapa përmirësimi. Sot shtëpia jonë duket si një copëz qielli.

Ne jemi ende në fillimin e udhëtimit tonë, por martesë dhe krijimi i një familjeje ishin zgjedhja më e mirë që kam bërë ndonjëherë. Zemra ime është e mbushur plot me gëzim kur mendoj për ordinancën e tempullit që morëm dhe e di se ajo u vulos nëpërmjet autoritetit të Perëndisë. Sa më shumë e kuptoj rëndësinë e familjes në planin e Atit Qiellor dhe shenjtinë e besëlidhjes që bëjmë, aq më shumë dua t'i ndihmoj familjet e tjera që të marrin të njëjtën ordinancë.

Unë mësova se nuk kemi përse të shqetësohemi rreth asaj që do të ndodhë, sepse “Perëndia nuk na ka dhënë frymë frike, por forcë, dashurie dhe urtësie” (2 Timoteut 1:7). Ne thjesht duhet të jemi të bindur, t'i ndjekim udhëzimet e dhëna nëpërmjet shkrimeve të shenjta dhe fjalët e profetëve të ditëve moderne dhe të kërkojmë në lutje për më shumë udhëzime vetjake. Nëse i bëjmë këto gjëra, ne mund ta kalojmë oqeanin e këtyre ditëve të fundit me vetëbesimin se, pavarësisht se çfarë lloj shqetësimi na godet, njerëzit tanë të dashur do të jenë të sigurt. ■

*Autorja jeton në Parana të Brazilit.*



# Si Mund të Studioj në **MENDJEN TIME** dhe

Zbuloni se çfarë mund të bëni kur keni pyetje.

**C**farë duhet të bëni kur keni një pyetje rreth diçkaje doktrimore, historike ose vetjake? Si ta gjeni një përgjigje? Zoti premton: “Unë do të të them në mendjen tënde dhe në zemrën tënde, me anë të Frymës së Shenjtë” (DeB 8:2). Si e përdorni mendjen *dhe* zemrën tuaj për ta dalluar frymëzimin? Ja tek janë disa ide.

## MENDJA

### Studioni, Lutuni, Dëgjoni

Plaku Robert D. Hejls, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, tha se, kur jemi duke marrë “vendime madhore për jetën . . . , Ati Qiellor pret që ne ta përdorim lirinë tonë të zgjedhjes, ta studiojmë situatën në mendjen tonë sipas parimeve të ungjillit dhe t’i paraqitim Atij një vendim në lutje” (“Fryma e Shenjtë”, *Liahona*, maj 2016, 105).

Është e njëjta gjë për çdo pyetje. Teksa studioni, lutuni sinqerisht rreth përgjigjeve që gjeni përgjatë udhës. Fryma e Shenjtë do t’ju japë nxitje – qoftë me anë të ideve, fjalëve në mendjen tuaj, ose kujtuesve të tjerë vetjakë – për t’ju udhërrëfyer drejt përgjigjeve të mëtejshme që ju nevojiten.

### Përdorini Burimet

Hetojini shkrimet e shenjta, përfshi Udhëzuesin e Shkrimeve të Shenjta dhe ndihmat e tjera për studimin. Mund të hetoni edhe burime të tjera shdm, të tilla si biseda të konferencave të përgjithshme, Gospel Topics [Temat e Ungjillit] në LDS.org, revistat e Kishës, Joseph Smith Papers Project [Projektin e Shkresave të Jozef Smithit] dhe më tepër. (Shih në faqen 54 për listën e burimeve të dobishme të Kishës.)

### Bisedoni rreth Saj

Mos kini frikë që të kërkoni ndihmë. Plaku Ronald A. Rasband, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dha nxitjen: “Do t’ju jap një sfidë . . . Ju duhet të mendoni për dikë [i cili mund t’ju ndihmojë të gjeni përgjigje] – një mik/e të besuar, një prind ose prindërit, një gjysh/e, mësues/e, anëtar të peshkopatës [ose] këshillues . . . - dhe duhet të merrni përgjigje për këto pyetje” (Face to Face broadcast, 20 janar 2016). Provojeni një herë! Bisedoni me dikë të cilit i mirëbesoni, rreth pyetjeve tuaja dhe gjejini përgjigjet së bashku.

Lutuni

Dëgjoni

Bisedoni

ILUSTIMI NGA JOSH TALBOT

# me ZEMRËN TIME?


Studioni

Studioni

Lutuni

Dëgjoni

Durimi



## PËRGJIGJE NGA PERËNDIA

“Bërja e pyetjeve të sinqerta është një pjesë e rëndësishme për ndërtimin e besimit dhe ne i përdorim të dyja, si intelektin tonë edhe ndjenjat tona. Zoti tha: ‘Unë do të të them në mendjen tënde dhe në zemrën tënde’ [DeB 8:2]. Jo të gjitha përgjigjet do të vijnë menjëherë, por shumica e pyetjeve mund të gjejnë zgjidhje nëpërmjet studimit të sinqertë dhe kërkimit të përgjigjeve nga Perëndia.”

Plaku Nil L. Andersen, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, “Besimi Nuk Vjen nga Rastësia, por nga Zgjedhja”, *Liahona*, nëntor 2015, f. 65.

## ZEMRA

### Studioni, Lutuni, Dëgjoni

Këta janë hapa të rëndësishëm për të përsiatur me mendjen dhe me zemrën tuaj njëkohësisht. Presidenti Diter F. Uhtdorf, Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë, tha: “Nëse dëshironi ta rrokni të vërtetën shpirtërore, ju duhet të përdorni mjetet e duhura. Nuk mund të fitoni një kuptueshmëri të së vërtetës shpirtërore me mjete që nuk janë në gjendje ta nxjerrin atë në pah” (“Marrja e një Dëshmie për Dritën dhe të Vërtetën”, *Liahona*, nëntor 2014, f. 22). Fryma e Shenjtë është mjeti nëpërmjet të cilit ne i mësojmë gjërat shpirtërore. Ndaj, kur të luteni e ta dëgjoni Shpirtin, me kohë, ju do të jeni në gjendje të gjeni përgjigje.

### Jini të Duruar

Presidenti Uhtdorf shpjegoi gjithashtu: “Sa më shumë që i drejtojmë zemrën e mendjen tonë për te Perëndia, aq më shumë dritë qiellore pikon në shpirtrat tanë. . . . Dalëngadalë, gjërat që më parë dukeshin të turbullta, të zymta apo të largëta, bëhen të qarta, të shkëlqyera dhe të afërta për ne” (“Marrja e një Dëshmie për Dritën dhe të Vërtetën”, f. 22). Kërkimi i përgjigjeve mund të jetë një proces i gjatë. Por, nëse jeni të gatshëm t’i dëgjoni përgjigjet, edhe nëse duhet kohë, ju do t’i gjeni ato.

### Ushtrojeni Dallimin e Nxitjeve

Sa më shumë t’i dalloni nxitjet dhe të jeni të gatshëm të veproni kur Shpirti i pëshpërit zemrës suaj, aq më e lehtë bëhet që t’i njihni nxitjet e tjera në të ardhmen. Mund të “ndie[ni] që është e drejtë” ose të përjetoni “mpirje të mendimit” nëse është e gabuar (shih DeB 9:8-9). Mund të ndieni edhe një ndjenjë kujtuese të butë, një ndjenjë paqeje ose një ndjenjë tjetër që është e posaçme për ju. Zoti ju njuh dhe Ai e di se si ju do ta kuptoni Shpirtin. Ai do t’ju japë udhërrëfim të dashur që është vetëm për ju. Ndaj vazhdoni të dëgjoni dhe vazhdoni të ushtroheni. ■


# PËRSHTATENI *për Vetën* STUDIMIN TUAJ TË UNGJILLIT

*Hidhuni një sy këtyre këshillave për studimin e ungjillit dhe gjetjen e përgjigjeve për pyetjet tuaja shpirtërore.*

**Nga Betani Bartolomeu**

Revistat e Kishës

**S**i studioni kur jeni duke kërkuar përgjigje për një pyetje shpirtërore ose madje kur thjesht jeni duke u përpjekur t'i kuptoni më mirë shkrimet e shenjta? Dua të them ju – vetë. Gjithsecili ka zakone të ndryshme studimi për shkollën, por ndonjëherë harrojmë se mund ta individualizojmë edhe studimin tonë të ungjillit. Herën tjetër që do të keni një pyetje shpirtërore ose doktrinale, provojini disa nga këto sugjerime për të zbuluar se çfarë mund të funksionojë më mirë për ju.





## 1. KRIJONI

Bëni një listë, një tabelë ose një hartë. (Shihni më poshtë për një shembull.)

Bëni një rrjet studimi. Hidhni në letër fjalë dhe ide dhe lidhni ato me vija dhe rrahë qarkues për të treguar se si lidhen ato.

### KRIJONI NJË LISTË, NJË TABELË OSE NJË HARTË

**N**ganjëherë është e dobishme që t'i organizoni nga ana pamore mendimet tuaja gjatë studimit të ungjillit duke i vendosur ato në ndonjë lloj liste, tabele ose harte. Ja tek është një shembull i tipit të tabelës që dikush mund të krijojë kur studion letrat e Palit në Dhiatën e Re. Ju mund të krijoni një listë, tabelë ose hartë tuajën duke përdorur çfarëdolloj formati që ju ndihmon më së shumti. Bëhuni krijues! Gjeni mënyra zbavitëse për ta organizuar studimin tuaj të ungjillit.

LETRAT E PALIT			
LETRA	I SHOQËRUAR ME NJË SHOK MISIONI?	PO SHKRUANTE NGA ... ?	TEMAT KRYESORE TË LETRËS
Shembull: 1 Timoteut	Nuk përmendet	Laodicea (shih shënimin në fund të 1 Timoteut 6)	Doktrina e vërtetë, Shpëtimtari, lutja, besimi dhe dashuria hyjnore, cilësitë e udhëheqjes, braktisja, përkujdesja për të varfrit, qëndrimi në besnikëri, shmangia e pasurive tokësore

## 2. SHKRUANI

Shënojin mendimet dhe mbresat që merrni gjatë studimit tuaj të shkri-meve të shenjta, në një ditar studimi dhe rishikojni shpesh ato mendime.

Hidhni në letër mendimet dhe mbresat pas lutjeve tuaja, edhe nëse mbresat nuk lidhen drejtpërdrejt me temën që po studioni. Shihni se çfarë po ju mëson Shpirti me kalimin e kohës.

Shkruajini pyetjet tuaja në një fletore, në telefonin tuaj ose në një fletore elektronike, pranë shtratit tuaj që t'ju kujtojnë dhe t'ju ndihmojnë të vazhdoni të mendoni rreth asaj që po mësoni çdo ditë.



### 3. DËGJONI DHE DISKUTONI

Bisedoni me një prind ose një udhëheqës të besuar. Jepini zgjidhje së bashku. Mund të duhet pak kohë, por të dy do të rriteni në proces e sipër.

Jepini mësim dikujt tjetër. Shpreheni me radhë atë që e dini *me të vërtetë*. Diskutoni rreth asaj që mësuat nga njëri-tjetri.

Dëgjojeni me zë të lartë shkrimet e shenjta ose histori dhe burime të tjera shdm.

### 4. BËNI KËRKIME

Kërkojini ndihmat për studimin në shkrimet e shenjta dhe në internet (shihni më poshtë për një listë me burime të dobishme shdm).

Kërkoni në LDS.org materiale filmike dhe këngë rreth asaj që po studioni.

Konteksti i studimit. Bëni kërkime për historinë ose kapitujt që e rrethojnë temën ose shkrimin e shenjtë që po studioni.

#### LËRINI T'JU NDIHMOJNË NDIHMAT PËR STUDIMIN

**K**a shumë burime me vlerë që janë në dispozicion në shkrimet e shenjta dhe në internet, për t'ju ndihmuar teksa studioni tema të rëndësishme. Ja tek është një listë me disa prej burimeve në dispozicionin tuaj dhe se në ç'vend t'i gjeni ato:



#### NË SHKRIMET E SHENJTA

- Udhëzuesi i Shkrimeve të Shenjta
- Kronologjia e Biblës (ngjarje nga Dhiata e Vjetër dhe e Re të vendosura në rend kronologjik me data të përafërta)
- Harmonia e Ungjijve (histori rreth Shpëtimtarit nga Ungjijtë e Mateut, Markut, Llukës dhe Gjonit të organizuara sipas ngjarjeve, vendeve dhe datave të përafërta)
- Përkthimi i Biblës prej Jozef Smithit
- Harta dhe fotografi
- Abbreviations guide [Udhëzuesi i shkurttimeve]



#### NË LDS.ORG

- Shkrimet e shenjta ([scriptures.lds.org](https://scriptures.lds.org))
- Konferenca e përgjithshme ([conference.lds.org](https://conference.lds.org))
- Gospel Topics [Temat e Ungjillit] ([topics.lds.org](https://topics.lds.org))
- Revista (liahona.lds.org)
- Historia e Kishës ([history.lds.org](https://history.lds.org))
- Ndihma për studimin ([scriptures.lds.org](https://scriptures.lds.org))
- Mësime dhe burime për mësimdhënien ([lds.org/go/41754a](https://lds.org/go/41754a))
- LDS Media Library [Biblioteka Filmike SHDM] ([lds.org/media-library](https://lds.org/media-library))
- Ndihmë për sfidat ([lds.org/go/41754b](https://lds.org/go/41754b))



#### BURIME TË TJERA NË INTERNET

- Historia familjare ([familysearch.org](https://familysearch.org))
- Mormon Channel ([mormonchannel.org](https://mormonchannel.org))
- Shkrimet e shenjta që citohen në konferencën e përgjithshme ([scriptures.byu.edu](https://scriptures.byu.edu))
- Redaksia Mormone ([mormonnewsroom.org](https://mormonnewsroom.org))
- Puna misionare dhe shpërndarja e ungjillit ([mormon.org](https://mormon.org))
- Joseph Smith Papers Project [Projekti i Shkresave të Jozef Smithit] ([josephsmithpapers.org](https://josephsmithpapers.org))



## 5. VEPRONI

Aktroni histori nga shkrimet e shenjta ose burime të tjera. Si ju ndihmon ta kuptoni më mirë atë që po studioni, kur e vini veten tuaj në vendin e atij personi? Si do të ishin situata të ngjashme në jetën tuaj?

Bëni një zinxhir shkrimesh të shenjta që i lidh përgjigjet që gjeni në shkrimet e shenjta. (Shihni më poshtë për një shembull.)

### BËNI NJË ZINXHIR PËR STUDI-MIN E SHKRIMEVE TË SHENJTA

**N**donjëherë është e dobishme të mbani shënim shkrime të shenjta të ndryshme që trajtojnë të njëjtën temë. Kontrolloni tek Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta për shkrime të shenjta që lidhen me temën që po studioni. Më pas përdorni poshtëshënimet dhe kontekstin për t'i lidhur me shkrimet e shenjta, [që japin] më tepër informacion mbi të njëjtën çështje. Shkruajeni shkrimin e shenjtë që vijon te zinxhiri në anë të shkrimit të mëparshëm e kështu me radhë. Mund të kërkonti edhe në bisedat e konferencës rreth një teme të posaçme që t'ju ndihmojnë në kërkimin tuaj (shihni listën e temave në [conference.lds.org](http://conference.lds.org)). Një shembull është zinxhiri i studimit të shkrimeve të shenjta mbi temën e shpresës.

### ZINXHIRI I STUDIMIT TË SHKRIMEVE TË SHENJTA

Shkrime të Shenjta rreth shpresës:

Fillimi: Moroni 7:40



Ethëri 12:4



Moroni 7:3



Doktrina e Besëlidhje 138:14



Moroni 7:41



Fundi: Alma 46:39 (Shkruani Moroni 7:40 në anën ngjitur me këtë shkrim të shenjtë.)

Biseda rreth shpresës:

- Peshkopi Din M. Dejvis, "Bekimet e Adhurimit", konferenca e përgjithshme e tetorit 2016.
- Plaku Pol V. Xhonsón, "Dhe Vdekja Nuk Do Të Jetë Më", konferenca e përgjithshme e prillit 2016.
- Presidenti Diter F. Uhtdorf, "Ai do t'ju Vendosë mbi Supet e Tij dhe do t'ju Çojë në Shtëpi", konferenca e përgjithshme e prillit 2016.
- Plaku L. Uitni Klejton, "Zgjidhni të Besoni", konferenca e përgjithshme e prillit 2015.
- Presidenti Bojd K. Paker (1924-2015), "Arsyeja për Shpresën Tonë", konferenca e përgjithshme e tetorit 2014.
- Presidenti Henri B. Ajring "Një Trashëgimi e Paçmueshme e Shpresës", konferenca e përgjithshme e prillit 2014. ■





**Nga Plaku  
Kuentin L. Kuk**

i Kuorumit të  
Dymbëdhjetë  
Apostujve

## SI TË GJEJMË PAQE TË VËRTETË

**A**spirata qiellore e njerëzve të mirë kudo, ka qenë dhe përherë do të jetë për paqen në botë. Nuk duhet të dorëzohemi asnjëherë në arritjen e këtij synimi. Por, Presidenti Jozef F. Smith (1838–1918) dha mësim: “Botës kurrë nuk mund t’i vijë ai shpirt paqeje dhe dashurie . . . derisa njerëzimi ta marrë të vërtetën e Perëndisë dhe mesazhin e Perëndisë . . . e ta njohë fuqinë dhe autoritetin e tij, i cili është hyjnor”.

Ne sinqerisht shpresojmë e lutemi për paqen e përbotshme, por ne e arrijmë pikërisht si individë dhe familje atë lloj paqeje që është **shpërbli-mi i premtuar për drejtësinë**.

Kjo paqe është dhuratë e premtuar e misionit dhe e sakrificës shlyese të Shpëtimtarit.

Paqja nuk është thjesht siguri ose mungesë lufte, dhune, konflikti dhe grindjeje. Paqja vjen ngaqë **dimë se Shpëtimtari e di cilët jemi dhe e di se kemi besim tek Ai, se e duam Atë dhe i zbatojmë urdhërimet e Tij**, madje e veçanërisht, edhe mes sprovave dhe tragjediive shkaktërruese të jetës (shih DeB 121:7–8).

“Ku mund të gjej paqe? Ku kam ngushëllim, kur tjera burime nuk më shërojnë?” (“Ku Mund të Gjej Paqe?” *Himne*, nr. 67). **Përgjigjja është Shpëtimtari**, i cili është burimi dhe autori i paqes. Ai është “Princ i paqes” (Isaia 9:5).

**Përlujta e vetes** para Perëndisë, **bërja e lutjeve** gjithmonë, **pendimi** për mëkatet, **hyrja në ujin e pagëzimit** me një **zemër të thyer e shpirt të penduar** dhe **kthimi në dishepuj të vërtetë** të Jezu Krishtit, janë shembuj shumë të mirë të drejtësisë që shpërblehet me paqe të qëndrueshme.

Kisha është një strehë ku pasuesit e Krishtit e arrijnë paqen. Disa të rinj në botë thonë se janë shpirtërorë, por jo fetarë. Të ndihesh shpirtëror është një hap i parë i mirë. Megjithatë, është Kisha vendi ku ne **shoqërohemi, marrim mësim dhe ushqehemi me fjalën e mirë** të Perëndisë. Më e rëndësishmja, është autoriteti i priftërisë në Kishë ai që siguron **ordinancat dhe besëlidhjet e shenjta** që i lidhin familjet tok dhe e kualifikojnë secilin prej nesh që të



kthehet te Perëndia, Ati, dhe te Jezu Krishti në mbretërinë çelestiale. Këto ordianca sjellin paqe ngaqë ato janë besëlidhje me Zotin.

Tempujt janë vendi ku ndodhin shumë prej këtyre ordiancave të shenjta dhe janë gjithashtu burim i një strehimi paqësor nga bota. Ata që i **vizitojnë rrethinat e tempujve** ose marrin pjesë në shtëpinë e hapur të tempullit, gjithashtu e ndiejnë këtë paqe.

*Shpëtimtari është burimi i paqes së vërtetë*. Madje edhe me sprovat e jetës, në saje të Shlyerjes së Shpëtimtarit dhe të hirit të Tij, jetesa e drejtë do të shpërblehet me paqe vetjake (shih Gjoni 14:26–27; 16:33). ■

*Nga një bisedë në konferencën e përgjithshme të prillit 2013.*

# Libra të Harruar, Dëshmi e Mbajtur Mend

*Sytë e të gjithëve ishin drejtuar nga unë. A mund ta mbroja Kishën vetëm me dëshminë time të thjeshtë?*

Nga Abigeil D. Ferrer

**N**jë vit unë kisha si qëllim që të përmirësoja të mësuarin tim shpirtëror. Kudo merrja me vete libra Kishe, broshura, manuale dhe shkrime të shenjta, përfshirë edhe në shkollë, pasi isha e uritur për fjalën e Perëndisë. Por përpjekjet e mia u vakën kur u ngarkova me studimin e një provimi të radhës me alternativa.

Një ditë mësuesja jonë hapi një diskutim në të cilin ajo u kërkoi të gjithë studentëve në dhomë që nuk ishin katolikë, të ngriheshin në këmbë. Isha e vetmja shenjtorë e ditëve të mëvonshme në klasë. Gjashtë studentë të tjerë u ngritën gjithashtu.

Më pas, na pyeti: Cilës kishe i përkisni? Kush ishte themeluesi? Si u krijua kisha juaj?

Unë u përgjigja e fundit. U bëra nervoze kur kuptova se nuk i kisha sjellë librat e mi të Kishës, por u përpoqa të kujtoja gjërat që kisha studiuar. Në mendje më erdhi një varg nga Bibla:

“Ki besim tek Zoti me gjithë zemër dhe mos u mbështet në gjykimin tënd; pranoje në të gjitha rrugët e tua, dhe ai do të drejtojë shtigjet e tua” (Fjalët e Urta 3:5–6).

Unë qëndrova përpara klasës me guxim dhe e harrova frikën time.

Thashë se jam një anëtare e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Tregova historinë e një djaloshi, Jozef Smith, i cili pa Perëndinë. Ndjeva një djegie në kraharor dhe lot më rrodhën nga sytë. Unë tregova se Kisha ishte organizuar më 6 prill 1830 dhe dëshmovava se një profet i Perëndisë ishte thirrur dhe priftëria ishte rivendosur. Unë dëshmovava se e dija që e gjitha kjo ishte e vërtetë.

Orët e shumta të studimit të ungjillit ia kishin vlejtur. Më kishin ndihmuar që të mbroja besimin tim dhe ta ndaja ungjillin. Isha krenare kur disa javë më vonë, katër nga shokët e mi të klasës u bashkuan me mua në kishë.

Ajo përvojë më mësoi rëndësinë e dëshmisë. Në fillim unë pyesja veten se përse Zoti nuk më kishte nxitur që t'i sillja me vete librat atë ditë. Ata do më kishin ndihmuar që t'u përgjigjesha shkëlqyeshëm pyetjeve që u parashtruan. Por më pas e kuptova se ne nuk duhet të mësojmë përmendsh çdo gjë rreth Kishës ose të mbështetemi në referenca – ne duhet ta studiojmë, ta jetojmë dhe ta ndajmë ungjillin, duke u mbështetur te Fryma e Shenjtë. Unë mund të mos i kem pasur librat me vete, por kisha dëshminë time. ■

*Autorja jeton në Kagajan të Filipineve.*



# ATA E PANË ATË

*Këta individë e panë njëmend Shpëtimtarin e ringjallur, por edhe ju mund të jeni një dëshmitar i Krishtit në vetë mënyrën tuaj.*

**S**i mendoni se do të ishte ta dëshmonit Shpëtimtarin e ringjallur? Për qindra njerëz në kohën e Jezusit, nuk u desh ta përfytyronin – ata e jetuan. Shkrimet e shenjta tregojnë për së paku një duzinë rastesh të shënuara në Dhiatën e Re dhe disa të tjera në Librin e Mormonit kur Zoti i ringjallur iu shfaq njerëzve. Këta individë dëshmuan një prej mrekullive më të mëdha në histori: Jezu Krishtin tek e mposhti vdekjen dhe e bëri të mundur për secilin prej nesh që të jetojmë sërish. Tejet e pabesueshme, apo jo?

Pra, çfarë do të thotë saktësisht të jesh një dëshmitar i Krishtit? Le t'u hedhim një sy disa prej këtyre çasteve në shkrimet e shenjta dhe të mendojmë se në ç'mënyrë mund të jemi edhe ne dëshmitarë të Krishtit edhe pa e parë Atë fizikisht.

## **Maria Magdalena**

Maria Magdalena ishte dëshmitarja e parë. Mëngjesin e së dielës pas Kryqëzimit, ajo erdhi te varri me disa gra të tjera për të vajosur trupin e Zotit. Kur Maria zbuloi një varr të zbrazët, ajo qau. Dikush iu afrua nga prapa dhe e pyeti: "O grua, pse po qan?" Përfytyrojeni habinë e saj kur zbuloi se ishte Jezusi, i ngritur nga vdekja. (Shih Gjoni 20:1-18.)



PENNANT © ISTOCK/GETTY IMAGES

## Dy Dishepujt Rrugës për në Emaus

Kleopa dhe një dishepull tjetër po ecnin rrugës për në Emaus kur me ta u bashkua një i panjohur. Ata nuk e njohën shoqëruesin e tyre të ri por, gjatë vaktit të tyre të mbrëmjes së bashku, i panjohuri theu bukën. Pastaj atyre iu çelën sytë dhe e kuptuan se gjatë gjithë kohës kishin qenë duke udhëtuar me Shpëtimtarin. “Po a nuk na digjej zemra përbrenda...?” e pyetën ata njëri-tjetrin, duke e përsiatur pohimin që kishin ndier se Ai vërtet kishte qenë me ta. (Shih Lluca 24:13-34.)



## Dhjetë Apostujt


Dy dishepujt që kishin udhëtuar për në Emaus me Krishtin, u kthyen në Jerusalem dhe u treguan dhjetë prej Apostujve rreth përvojës së tyre. Ndërkohë që ata po flisnin, Vetë Shpëtimtari iu shfaq atyre, duke thënë: “Shikoni duart e mia dhe këmbët e mia, sepse unë jam. Më prekni dhe shikoni, sepse një frymë nuk ka mish e eshtra, si po shihni se unë kam!” (Shih Lluca 24:36-41, 44-49.)

## Apostulli Thoma

Apostulli Thoma nuk ishte i pranishëm kur Shpëtimtari iu shfaq fillimisht Apostujve të tjerë, prandaj nuk e besonte se Krishti ishte ringjallur. Një javë më vonë, Krishti iu shfaq përsëri Apostujve. Këtë herë Thoma ishte atje dhe për shkak se e pa Krishtin, e besoi që Ai ishte ngritur [nga vdekja]. Shpëtimtari e paralajmëroi Thomain që të mos besonte vetëm pasi kishte parë: “Sepse më ke parë, Thoma, ti ke besuar; lum ata që nuk kanë parë dhe kanë besuar!” (Shih Gjoni 20:24-29.)



PIKTURË E THOMAIT NGA BRIAN CALL



## Njëmbëdhjetë Apostujt në Detin e Tiberiadës

Një ditë, jo shumë kohë pas Ringjalljes, disa Apostuj shkuan për peshkim në Detin e Tiberiadës, por nuk patën shumë fat. Të nesërmen në mëngjes, Shpëtimtari iu shfaq atyre dhe i këshilloi që t'i hidhnin rrjetat në anën e djathtë të barkës. Kur e bënë këtë, rrjeta zuri aq shumë peshq sa që mezi mundën ta tërhiqnin! Pasi hëngrën së bashku, Shpëtimtari u dha mësim rreth rëndësisë së shërbesës ndaj të tjerëve, duke thënë: “Kulloti delet e mia”. Apostujt do ta shpenzonin të gjithë pjesën tjetër të jetës së tyre duke bërë pikërisht atë – duke u mësuar njerëzve rreth Krishtit – dhe në disa raste, ata madje dhanë jetën e tyre për këtë çështje. (Shih Gjoni 21:1-22.)

KRISHTI / RINGJALLUR NË DETIN E TIBERIADES, NGA DAVID UNDSLEY





NË BARI, NGA HOWARD LYON


## Nefitët në Kontinentin Amerikan

Gjatë Kryqëzimit, toka në kontinentin amerikan u rrënuar nga tërmete, zjarre, fatkeqësi të tjera natyrore dhe tri ditë errësirë për të shenjuar vdekjen e Shpëtimtarit. Më vonë, Krishti zbriti nga qielli dhe vizitoi një turmë prej 2500 vetash të mbledhur pranë tempullit në [tokën] Begati. Ai i ftoi njerëzit që t'i preknin shenjat e plagëve në duart, këmbët dhe brinjën e Tij, bëri një predikim dhe i bekoji fëmijët e nefitëve një e nga një. Akoma më shumë njerëz u mbledhën të nesërmen dhe Shpëtimtari i takoi dhe u dha mësim atyre. Dishepujt përfundimisht formuan Kishën e Krishtit dhe nefitët morën një dëshmi kaq të madhe, sa që si ata edhe lamanitët u kthyen në besim te Zoti. (Shih 3 Nefi 11-18; shih edhe 3 Nefi 8-10; 4 Nefi 1.)

## Dëshmitarët Atëherë dhe Tani

Krishti iu shfaq edhe shumë të tjerëve, përfshirë disa grave që kishin ardhur te varri për ta ndihmuar Maria Magdalenën ta vajoste trupin e Krishtit, një grupi me mbi 500 burra, Jakobit dhe Palit. (Shih Mateu 28:9; Veprat e Apostujve 9:4-19; 1 Korintasve 15:6-7; shih edhe 3 Nefi 19; 26:13.)

Ne mund të mos kemi mundësinë ta shohim Shpëtimtarin siç e panë këta dëshmitarë, por ju prapëseprapë mund të jeni një dëshmitar i Krishtit. Ju mund ta kërkontë vetë Shpëtimtarin, ashtu sikurse bëri Maria kur shkoi te varri, duke mësuar më shumë rreth Tij. Ose mund ta ushtroni besimin tuaj në Të, duke i zbatuar urdhërimet dhe duke i ndjekur këshillat e profetëve. Ose mund t'i dalloni bekimet e Shpëtimtarit në jetën tuaj, ashtu siç bënë dy dishepujt që po ecnin për në Emaus. Këtë periudhë pashke, mendoni se çfarë do të thotë të jesh një dëshmitar i Krishtit. Këta njerëz ishin me plot kuptimin e fjalës dëshmitarë që e panë njëmend Krishtin e ringjallur – por kjo nuk është e vetmja mënyrë se si mund ta dëshmoni Atë në jetën tuaj. ■



## MËSONI PËR TË

“Ndërsa ndieni dëshminë e Shpirtit të Shenjtë për [Krishtin] të konfirmuar dhe rikonfirmuar shpirtit tuaj në shumë përvoja dhe mjedise të ndryshme, ndërsa përpiqeni ta mbani lart dritën e shembullit të Tij në jetën tuaj ditë pas dite dhe ndërsa [u jepni] dëshmi [të tjerëve] dhe i ndihmoni ata të mësojnë për Të

dhe ta ndjekin Atë, ju jeni një dëshmitar i Jezu Krishtit.”

Plaku D. Tod Kristoferson, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, “Të Bëhesh një Dëshmitar i Krishtit”, *Liahona*, mars 2008, f. 63.

# HAPËSIRA JONË

## PERËNDIA NA JEP VEGLA PUNE

**U**ngji im është artist dhe bën anije të vogla prej druri në shishe qelqi. Duhet shumë kohë, përqendrim dhe përpjekje që t'i bësh ato.

Një ditë, i pashë të gjitha veglat e tij të punës dhe vura re se çdo vegël përdorej për një detaj të posaçëm ose për t'i dhënë formë anijes. Ndërsa e shikoja të punonte, u befasova nga mënyra se si i përdorte veglat e punës për t'i bërë këto anije. M'u kujtua historia kur Nefi ndërtoi një anije (shih 1 Nefi 17–18). Ai e ndërtoi atë sipas mënyrës së Zotit, jo sipas mënyrës së njeriut. Perëndia na jep vegla pune për t'i ndërtuar vetë anijet tona sipas mënyrës së Tij. Shkrimet e shenjta, besimi dhe dashuria e Perëndisë janë vegla pune që duhet t'i përdor në vetë jetën time për ta ndërtuar me kujdes anijen time vetjake pa ndonjë të çarë. Po mësoj çdo ditë të jem një dishepulle e Zotit. ■

Maria Mercedes G., Monagas, Venezuelë



## TË NDIHESH VETËM

**I**shte një pranverë e ftohtë në Danimarkë. Sapo e kisha filluar misionin tim kohëplotë dhe kisha vështirësi me dëshminë time. Isha një i kthyer në besim prej vetëm 19 muajsh dhe isha i mbushur me pasiguri rreth përballjes me një vend të huaj, një gjuhë që nuk e flisja, dhe një labirint rrugësh që as që ma merrte mendja se si t'i përshkoja. Lutjet e mia dikur të mbushura me mirënjohje shpejt u bënë akuza të athëta: “Perëndi, pse më ke lënë vetëm fare?”

Një mëngjes iu përgjerova Atij në lutje. Por në vend që ta pyesja “pse”

me zemërim në zemër, u luta për një dëshmi për të vërtetën e ungjillit dhe për heqjen e dyshimeve të mia.

Pasi u luta, i hapa shkrimet në mënyrë rastësore. U ndala te Ligji i Përtërirë 31:6: “Tregohuni të fortë dhe trima, mos kini frikë, mos u trembni prej tyre, sepse Zoti, Perëndia yt, është ai vetë që ecën me ty; ai nuk do të të lërë dhe nuk ka për të të braktisur”.

Zemra ime ishte plot me gëzim kur e kuptova përgjigjen e lutjes sime: Perëndia kishte qenë aty gjatë gjithë kohës. Ai thjesht po priste një lutje të sinqertë në vend të akuzave për braktisje.

Perëndia nuk do të më lërë kurrë, edhe kur gjithçka duket e pashpresë. Dhe ne mund ta ndiejmë dritën e dëllit të Tij nëpërmjet lutjes dhe shkrimeve të Tij të shenjta. ■

Klejton E., Teksas, SHBA

## ËSHTË RADHA JUAJ

**L**iahona i mirëpret përvojat dhe pikëpamjet tuaja për të jetuarin e ungjillit. Dorëzoheni historinë tuaj në [liahona.lds.org](http://liahona.lds.org) ose dërgojeni me postë elektronike te [liahona@ldschurch.org](mailto:liahona@ldschurch.org). Ju lutem, përfshini emrin tuaj të plotë, lagjen dhe kunjin dhe lejen nga prindi.



# PËRPARA, USHTARË TË KRISHTERË

“Burrat dhe gratë, të cilët dëshirojnë të hyjnë në mbretërinë  
çelestiale, do të kuptojnë që duhet të luftojnë çdo ditë  
për të mposhtur dobësitë dhe mëkatet e tyre.”

*Teachings of Presidents of the Church: Brigham Young (1997), f. 294.*



# “Si mund ta di se Perëndia po i dëgjon lutjet e mia?”

**L**utja është një bekim i madh dhe neve na premtohet se Ati Qiellor është përherë duke na dëgjuar, por shpesh duhet pak punë për t'i dalluar përgjigjet e Tij.<sup>1</sup>

Mendoni për këtë: Perëndia ose ju dëgjon ose nuk ju dëgjon. Nëse nuk ju dëgjon, atëherë sigurisht që nuk ka kuptim të luteni. Por nëse ju dëgjon (dhe Ai ju dëgjon!), ne duhet të zbulojmë se si të bisedojmë *vertet* me Të në lutje, si t'i dallojmë përgjigjet dhe si të ecim përpara me besim.

Kur mendojmë se Ai nuk është duke na dëgjuar, ndoshta duhet të përjetojmë pak rritje vetjake. Ju mund t'i bëni vetes disa pyetje: A jam i/e pastër? A janë motivet e mia të lavdërueshme? A jam i/e gatshëm/me të bëj atë që Ai kërkon?<sup>2</sup> Nëse përgjigja për secilën nga këto është “po”, ju mund të mirëbesoni se “Zoti, Perëndia yt, do . . . t'u japë përgjigje lutjeve të tua” (DeB 112:10). Mbani mend, ndonjëherë përgjigjet vijnë në mënyra të pakapshme ose të papritura.

Nëse disa prej atyre pyetjeve u jepni përgjigjen “jo”, nuk është kurrë tepër vonë! Bëni ndryshimet e nevojshme në jetën tuaj në mënyrë që të mund të keni Shpirtin. Jini të gatshëm të veproni sipas nxitjeve që merrni.

Dhe mos harroni që çdokush i merr përgjigjet në mënyra të ndryshme. Lutuni që Fryma e Shenjtë t'ju mësojë se si *ju* të mund t'i dalloni përgjigjet. Mund të mos jetë e lehtë t'i dalloni me të parën, por është si çdo aftësi tjetër: ushtrimi e bën të përsosur. Kini besim dhe mirëbesim se Ati Qiellor është *përherë* duke na dëgjuar.

## SHËNIME

1. Shih Mateu 7:7; Jakob [Bibël] 1:5–6; Alma 33:4–11; Doktrina e Besëlidhje 8:1–2.
2. Shih Richard G. Scott, “Learning to Recognize Answers to Prayer”, *Ensign*, nëntor 1989, f. 32.



## Dëgjojeni Shpirtin

Përpiquni ta dëgjeni Frymën e Shenjtë. Njerëzit e dëgjojnë Frymën e Shenjtë në

mënyra të ndryshme, ndaj ndoshta ju jeni duke dëgjuar për zërin e qetë e të ulët kur nxitja mund të vijë si një ndjenjë. Unë e di se Fryma e Shenjtë do t'ju tregojë gjithçka që ju duhet të dini – ju thjesht duhet të dëgjeni.

*Alisa G., moshë 13 vjeçe, Alberta, Kanada*

## Përgjigjet në Kishë

Një herë isha në mëdyshje të madhe nëse duhet të dilja në takim me një joanëtar. Një të diel në mbledhjen e sakramentit, një motër dha një bisedë që dukej sikur më drejtohej mua personalisht. Në atë çast, mora një garanci se Zoti i qe përgjigjur lutjes sime. Më përpara isha e pështjelluar lidhur me atë që duhej të bëja, por pastaj u ngushëllova nga Fryma e Shenjtë, i cili ma mbushi zemrën me gëzim e kurajë. Perëndia na përgjigjet nëpërmjet ndjenjave, mendimeve, shkrimeve të shenja dhe madje folësve në Kishë.

*Karen V., moshë 19 vjeçe, Minjas Gerais, Brazil*

## Kërkoje

Një herë pyeta veten nëse Perëndia mund t'i dëgjonte lutjet e mia dhe më pas e ndjeva përgjigjen në zemrën time. Dëgjova dikë të jepte dëshmi për lutjen dhe unë mund ta ndieja Frymën e Shenjtë. Këshilla ime e radhës do të ishte të pyesnit prindërit tuaj, peshkopin ose anëtarët e tjerë të lagjes suaj. Ju gjithashtu mund të luteni për ndihmë lidhur me këtë temë!

*Xhoshua S., moshë 13 vjeç, Oregon, SHBA*



### Kujtohuni se Cili Jeni

Unë e di se Perëndia na dëgjon, sepse lutja sjell ndjenja paqeje, lehtësimi dhe dashurie në zemrën

time. Unë e kuptoj që Ai më çliron nga shumë rreziqe ditë për ditë dhe që Ai e mbron familjen time dhe ndiej që Ai më do. Përpara se të shkoj në shkollë, gjithmonë e them temën e Të Rejave; ajo më ndihmon të kujtoj se unë jam një bijë e Atit Qiellor, i cili më do.

*Nikol M., moshë 19 vjeçe, Limë, Peru*

### Mirëbesoni në Të

Ati Qiellor i dëgjon gjithmonë lutjet tona, por ndonjëherë duket sikur Ai nuk po u përgjigjet atyre sepse Ai mund të mos na përgjigjet me mënyrën ose në kohën që ne duam që Ai të përgjigjet. Ne duhet të jemi të gatshëm t'ia nënshtrojmë vullnetin tonë vullnetit të Tij dhe të kemi besim se Ai e di se çfarë është më e mira për ne. Ati Qiellor na do dhe do të përpiqet gjithnjë të na ndihmojë të mësojmë dhe të rritemi ndërsa Ai u përgjigjet lutjeve tona.

*Mosia M., moshë 17 vjeç, Juta, SHBA*

### Lutuni me Sinqeritet

Pas lutjes suaj, ju mund t'u vini veshin ndjenjave dhe qëllimeve që vijnë në zemrën tuaj. Njëra prej tyre mund të jetë përgjigja për lutjen tuaj. Kur ne lutemi me qëllim të vërtetë dhe një zemër të sinqertë, Ati ynë Qiellor përgjigjet sipas besimit që kemi në Të. Ai nuk përgjigjet thjesht për të kënaqur kureshtjen tonë.

*Zhan Klod N., moshë 16 vjeç, Kasai-Central, Republika Demokratike e Kongos*



### Lutja e një Fëmije

Unë e di se Ati Qiellor i dëgjon lutjet e mia për shkak të këtyre fjalëve në këngën e

Fillores "A Child's Prayer" ["Lutja e një Fëmije"] (*Children's Songbook*, f. 12): "O Ati Qiellor, a je Ti atje? A i përgjigjesh lutjes së çdo fëmije? Disa thon' qielli është shumë larg, Por sa her' lutem, e ndiej atë pran'." Kur e kujtoj atë këngë, unë e di se Ai po më dëgjon, sepse e ndiej Shpirtin dhe dashurinë e Tij të pafundme për mua. Kur kujtoj se Ai më do, unë ndiej ngushëllim dhe e di se Ai i dëgjon lutjet e mia.

*Elain B., moshë 16 vjeçe, Karolina e Veriut, SHBA*

### Kërkoni dhe do të Merrni

Nëpërmjet shkrimeve të shenjta, neve na është mësuar se Perëndia do t'i dëgjojë gjithnjë lutjet tona dhe do t'u përgjigjet atyre nëse ne i drejtohem Atij me besim dhe qëllim të vërtetë. Në zemrën tonë ne do të ndiejmë pohimin se Ai vërtet na dëgjon, një ndjenjë paqeje dhe qetësie.



### MOS U DORËZONI

"Jini të bindur, mbajini mend kohët kur ju e keni ndier

Shpirtin në të kaluarën, dhe kërkoni me besim. Përgjigja juaj do të vijë dhe ju do ta ndieni dashurinë dhe paqen e Shpëtimtarit. Mund të mos vijë aq shpejt ose në formën që ju e dëshironi, por përgjigja do të vijë. Mos u dorëzoni!"

*Plaku Xhejms B. Martino, i Të Shtatëdhjetëve, "Kthehuni tek Ai dhe Përgjigjet Do Të Vijnë", Liahona, nëntor 2015, f. 59.*

Ne gjithashtu mund të ndiejmë se gjithçka do të shkojë mirë kur e ndjekim vullnetin e Atit. Nëse kemi dyshime se Ai na dëgjon, ne duhet të kërkojmë udhërrëfim në shkrimet e shenjta dhe më pas të pyesim nëse ato gjëra që lexojmë, janë të vërteta.

*Konstanca L., moshë 20 vjeçe, Bío Bío, Kili*

## PYETJA PASUESE

"Si mund t'u kërkoj miqve të mi që të mos flasin ashpër ose në mënyrë të pahijshme për të tjerët?"

Dërgojeni përgjigjen tuaj dhe, nëse dëshironi, një fotografi me rezolucion të lartë deri më 15 maj 2017 në [liahona.lds.org](http://liahona.lds.org) (klikoni te "Dorëzo një Artikull") ose nëpërmjet postës elektronike në adresën [liahona@ldschurch.org](mailto:liahona@ldschurch.org).

Ju lutemi, përfshini informacionin vijues: 1) emrin e plotë, 2) datën e lindjes, 3) lagjen ose degën, 4) kunjin ose distriktin, 5) lejen tuaj me shkrim dhe, nëse jeni nën moshën 18 vjeç, lejen me shkrim të prindit tuaj (mesazhi elektronik pranohet) për botimin e përgjigjes dhe të fotografisë suaj.

Përgjigjet mund të redaktohen lidhur me gjatësinë apo qartësinë.

# Andrei dhe Fjala e Keqe

Nga Xhuli C. Donaldson

Bazuar në një ngjarje të vërtetë

“Do të përpiqem të pendohem, të përmirësohem, të lutem” (Children’s Songbook, f. 98).

“**T**i mendon se je më i mirë se gjithë të tjerët ngaqë nuk shan”, tha Nikolai në pushim të madh.

“Kjo nuk është e vërtetë”, tha Andrei.

“Atëherë përse nuk thua një fjalë të pistë? Vetëm një? Nuk bëhet nami. Të gjithë shajnë.”

Andrei ngriti supet. “Thjesht nuk dua.”

Andrei e dinte se të shaje ishte e gabuar dhe e bën Frymën e Shenjtë të largohet. Andrei donte që ta kishte me vete Frymën e Shenjtë. Prandaj nuk shau.

Andrei ishte i ri në shkollë dhe, deri tani, Nikolai ishte i vetmi në klasën e tij të gjashtë që donte të ishte shoku i tij. Por Nikolai e bezdiste çdo ditë që të shante. Dhe çdo ditë Andrei lodhej pak më shumë për të thënë “jo”. Përveç kësaj, Andrei kishte frikë se Nikolai nuk do të ishte më shoku

i tij dhe atëherë ai do të ishte me të vërtetë i vetmuar.

“Thjesht thuaj vetëm një fjalë të pistë”, tha Nikolai pas shkolle. “Pastaj do të të lë të qetë.”

Më në fund Andrei ishte kaq i lodhur nga të qenit i bezdisur sa tha një fjalë të pistë – një që

nuk ishte *shumë* e keqe. Nikolai pohoi me kokë.

“Në rregull, tani je njëri prej nesh.”

Pas kësaj, Andreit i folën edhe miqtë e tjerë të Nikolait. Ata hanin drekë me të dhe luanin futboll me të në pushim të madh. Por të qenit në grupin e





miqve të Nikolait ishte si të ecje mbi rërë thithëse. Sa më shumë kohë që Andrei kalonte me ta, aq më shumë ai fliste dhe vepronte si ata. Dhe të gjithë ata shanin. Shumë. Ata qeshnin dhe e fyenin njëri-tjetrin. Ata thoshin gjëra të pahijshme për mësuesit e tyre. Ata zemëroheshin dhe silleshin shumë keq. Dalëngadalë Andrei filloi të zemërohej më shpesh dhe gjente gjithnjë e më tepër arsye për të sharë.

Një natë, kur mami dhe babi kishin dalë, Andrei dhe motra e tij e madhe, Katja, u futën në sherr se cilin program të shikonin. Madje përpara se Andrei të mendohej, një fjalë e pistë doli nga goja e tij.

Katja u duk e shokuar. “Do t’i them mamit.”

Andrei vrapoi për te dhoma e tij dhe përplasi derën. Çfarë problemi kishin të gjithë? Përse e zemëronin gjatë gjithë kohës? Kur prindërit u kthyen në shtëpi, Andrei e hapi paksa derën e tij dhe e dëgjoi Katjan të thoshte: “Mami, Andrei më shau”.

“Çfarë?” Mami u duk e habitur. “Andrei nuk do të shante kurrë.”

Andrei e mbylli derën dhe u lëshua mbi shtrat. Ai mendoi se sa shumë kishte ndryshuar që kur filloi të shante. Kishte kaluar shumë kohë që kur e kishte ndier Frymën e Shenjtë.

Andrei u gjuhëzua pranë shtratit të tij dhe u lut. “Atë i dashur Qiellor, më vjen shumë keq që kam qenë i pasjellshëm dhe i zemëruar. Më vjen keq që fillova të shaj. Do të përmirësohem.”

Teksa Andrei po lutej, një ndjenjë e ngrohtë ia mbushi zemrën atij. Për herë të parë që kur kishte filluar të shante, ai u ndie me të vërtetë i lumtur. Ai e dinte se Perëndia e donte atë dhe mund ta ndiente Frymën e Shenjtë. U ndie i falur dhe e dinte se mund të ndryshonte dhe të bëhej më i mirë.

Pas lutjes së tij, ai i tha të ëmës të vërtetën dhe i kërkoi ndjesë Katjas. Pas kësaj, Andrei u ndie më mirë. Pendimi e bëri të ndihej mirë.

Të nesërmen në shkollë, Andrei nuk hëngri drekë me grupin e Nikolait. Në vend të kësaj, ai u ul pranë disa fëmijëve që nuk i njihje. Do të kërkonte kohë, por Andrei e dinte se do të gjente shokë që ishin të mirë e të lumtur dhe nuk shanin. Ashtu si ai. ■

Autorja jeton në Juta, SHBA.



## SFIDA E ZTD

“Unë do t’i përdor me nderim emrat e Atit Qiellor dhe të Jezu Krishtit. Unë nuk do të shaj ose të përdor fjalë të pahijshme” (Standardet e Mia të Ungjillit).

Në një rënë anë të një cope letre, shkruani ose vizatoni se si ju bëjnë të ndiheni fjalët e mira. Në anën tjetër, shkruani ose vizatoni se si ju bëjnë të ndiheni fjalët e këqija.

Lexoni Levitikun 19:12. Përse është e rëndësishme që t’i përdorim me respekt emrat e Atit Qiellor dhe të Jezu Krishtit?

Pyeteni një prind apo një udhëheqës përse ne duhet të përdorim një gjuhë të mirë dhe mënyrën se si i ka bekuar kjo ata.

Unë e sfidoj veten që të . . .

---



---



---





Nga Plaku  
Dejvid A. Bednar,  
i Kuorumit të  
Dymbëdhjetë  
Apostujve

# Si mund ta ndihmoj familjen time të jetë e fortë?



Tregojini familjes suaj se i doni ata dhe shfaqeni atë me mënyrën se si veproni.



Jepni dëshminë tuaj për gjërat që i dini se janë të vërteta prej dëshmisë së Frymës së Shenjtë. Ndani dëshminë tuaj me njerëzit që ju doni më shumë.



Me dëshirë bashkohuni me familjen tuaj në lutje familjare dhe studim të shkrimeve. Jini të përfshirë aktivisht në mbrëmjen familjare në shtëpi dhe bëjeni atë argëtuese.



Jini besnikë në të nxënit, në të jetuarit dhe në dëshirën për ungjillin e rivendosur të Jezu Krishtit.



**Nga  
Xhoi D. Xhons,**  
Presidente e  
Përgjithshme  
e Filllores

## Përgatituni për TEMPULLIN Çdo Ditë

**K**ur isha nëntë vjeçe, kisha një mësuese të mrekullueshme Fillloreje që quhej motra Kohlër. Unë isha shumë e turpshme dhe ajo ishte aq e mirë, sa që mua më pëlqente shumë të isha me të. Një ditë ajo i dha secilit prej nesh një copë letre. Ne të gjithë shkruam se çfarë donim të bënim kur të rriteshim. Unë shkrova: “Të shkoj në kolegji dhe të martohem në tempull”. E ngjita letrën mbi derën e dollapit tim. Gjatë natës, drita nga llamba e rrugës shkëlqente përmes dritares sime. Ngrija sytë te copa ime e letrës. Ajo më kujtonte që unë doja të shkoja në tempull.

Asokohe, kishte vetëm 12 tempuj në botë. Doja të shkoja tek të gjithë.

Kurdoherë që nëna dhe babai planifikonin pushime, ata gjithmonë e çonin familjen tonë në tempull. Ne jetonim në Oregon, SHBA. Tempulli më i afërt ishte 965 km larg në Kardston të Albertës në Kanada. Makina jonë nuk kishte ajër të kondicionuar. Vëllai, motra ime dhe unë uleshim në ndenjësën e pasme. Ne varnim një peshqir të lagur jashtë dritares së makinës. Më pas e vendosnim atë në qafë për t’u freskuar.

Ishte shumë emocionuese kur më në fund e shihnim tempullin. Unë nuk dija shumë rreth asaj që ndodhte aty, por prindërit e mi ishin gjithmonë të lumtur kur dilnin.



E dija se tempulli ishte shumë i rëndësishëm.

E dija se ishte shtëpia e Zotit. (Në foto, unë jam ajo me këmishë të bardhë).

Pasi mbusha 12 vjeçe, arrita të bëja pagëzime në disa tempuj. Më pas, kur takova burrin tim të ardhshëm, zbulova se edhe ai e pëlqente shumë tempullin! Ne u martuam në Tempullin e Mantit në Jutë.

Ju mund të përgatiteni për tempullin çdo ditë. Shkoni në tempull kur të mundeni. Prekuni muret e tij. Kur nipi im, Xharet, ishte 11 vjeç, punoi mbi historinë familjare çdo të diel me të atin. Ai gjeti shumë emra paraardhësish. Tani që është 12 vjeç, ai po bën pagëzime në tempull për këta paraardhës!

Kur jeni në tempull, ju mund të ecni atje ku ecën Jezusi. Është shtëpia e Tij. Unë shpresoj që ju do të luteni çdo ditë që Ati Qiellor t’ju ndihmojë të përgatiteni për të hyrë në tempull dhe për të ndier dashurinë e Tij. ■

# Yllka Ndriçon

**Nga Xhejn Mek-Braj**

Bazuar në një ngjarje të vërtetë

*“It’s nice to be here with you in Primary” [“Është mirë të jem me ju në Fillore”]*

(Children’s Songbook, f. 254).

Yllka rregulloi rrobat. Ende i dukej e çuditshme të vishte një fustan për në kishë. Në kishën e saj të vjetër, vajzat vishnin pantallona të gjata ose të shkurtra të dielën. Por në kishën e saj të re, jo. Ajo dhe nëna e vet sapo ishin pagëzuar në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme.

Yllka psherëtiu kur u pa në pasqyrë. Ishte e emocionuar që do të shkonte në kishë për herë të parë zyrtarisht si një anëtare, por ishte edhe në ankth. Më përpara, ajo rrinte me mamën gjatë gjithë kohës në kishë. Por këtë herë ajo do të shkonte në Fillore.

Yllka i shkeli syrin pasqyrimin të vet. Po sikur të mos përshtatej? Po sikur fëmijët e tjerë të mos ta kishin qejf?

“Yllka? A je gati?” thirri mami.



Yllka zbriti shkallët. “A dukem mirë?” pyeti ajo.

Mami buzëqeshi.

“Dukesh bukur.”

Yllka u ngërdhesh.

“Ti ashtu do të thuash. Se je mami im.”

“Ke të drejtë. Unë *njëmend* ashtu do të them. Sepse është e vërtetë.”

Yllka i dha një buzëqeshje të vogël. Mami gjithnjë kishte një mënyrë për ta bërë të ndihej më mirë. Por ende kishte një lëmsh

në stomak. Po sikur asnjëri nga fëmijët e tjerë të mos dëshironte t’i fliste? Ajo kishte shokë në shkollë, por nuk ishin anëtarë të kishës së saj të re. Ajo uronte të kishte qoftë edhe një shoqe që të shkonte në kishë me të.

“Sapo m’u kujtua se kam diçka për të bërë”, i tha mamit.

U kthye duke i ngjitur shkallët me vrap dhe u gjunjëzua anës shtratit. “Atë i dashur Qiellor, të lutem më ndihmo të zë shokë të rinj. Unë besoj se ajo që më mësuam misionarët, është e vërtetë, por kam frikë.”

Yllka qëndroi në gjunjë dhe mbajti vesh. Pas një çasti ajo ndjeu një ndjenjë të ëmbël, të paqte dhe nuk ishte më aq në ankth.



Në kishë, Yllka dhe mami u ulën pranë një familjeje me tri vajza të vogla. Prindërit u prezantuan dhe filluan të bisedonin me mamin përpara se të fillonte mbledhja. Yllka i ndihmoi vajzat të ngjyrosnin një vizatim të Jezusit.

Peshkopi Endrjus u afrua drejt tyre. “Motra Kaningam! Yllka! Sa mirë që ju shikoj sot!” Ai i dha secilës një buzëqeshje të ngrohtë dhe u shtrëngoi dorën. Yllka e kishte harruar sa i sjellshëm ishte gjithsecili në kishë. Ndoshta do të zinte një shoqe në fund të fundit.

Pas mbledhjes së sakramentit, Yllka shkoi në Fillore. U hodhi një sy fëmijëve të tjerë teksa u ul me ankth. Ata po flisnin me njëri-tjetrin dhe nuk dukej se e vunë re. Yllkës iu ndrydh zemra. Do të rrinte vetëm sidoqoftë.

Më pas, një vajzë e vogël në moshën e Yllkës hyri në dhomë. “Edhe ajo duket në ankth”, mendoi Yllka. “Mund të shkoj t’i flas.”

Yllka mori frymë thellë, pastaj eci drejt vajzës. “Ç’kemi, unë quhem Yllka. Jam e re. Do të ulesh pranë meje?” Yllka mbajti frymën. A do të donte vajza të bëhej shoqja e saj?

Goja e vajzës u hap në një gjysmë buzëqeshje. “Unë jam Sara. Edhe unë jam e re. Familja ime sapo u shpërngul këtu nga Ontario.”



“Unë dhe mami im u pagëzuam dy javë më parë”, tha Yllka. “Nuk jam e sigurt se çfarë duhet të bëj.”

Buzëqeshja e Sarës u bë akoma më e madhe. “Epo do ta zbulojmë bashkë.”

Yllka dhe Sara u ulën me klasën e tyre. Ndonjëherë Yllka shkëmbente shikime me Sarën dhe buzëqeshje. Sara ia kthente buzëqeshjen. Yllka ndihej e qetë dhe e lumtur. Ajo e dinte se Ati Qiellor i ishte përgjigjur

lutjes së saj dhe e kishte ndihmuar të gjente një shoqe.

Në klasë, mësuesja i kërkoi Yllkës dhe Sarës të prezantoheshin.

Yllka doli përpara. “Quhem Yllka Kaningam. Unë dhe mami im u pagëzuam dy javë më parë.” Ajo ndali dhe një buzëqeshje iu avit në fytyrë teksa shihte nga shoqja e saj e re. “Dhe kjo është shoqja ime Sara.” ■

*Autorja jeton në Kolorado, SHBA.*

## MENDONI RRETH KËSAJ

Si mund ta mirëpresësh dikë që është i ri në kishë?

# Ji një Dritë!

Nga Elizabeta Pinborou

Duaj

Mos Bëj Thashetheme

Fal

Përkrah

Nxit

Fto

Dëgjo

Ji një Mikel

*“Mbani lart dritën tuaj që të ndriçojë tërë botën. Vini re, unë jam drita që ju duhet të mbani lart” (3 Nefi 18:24).*

**N**e mund të jemi një dritë për të tjerët duke qenë një mik/e i/e vërtetë. Lexoji idetë më poshtë dhe shto disa nga të tuat. Sa herë që të shkruash emrin e dikujt të cilit dëshiron t'i tregosh dashuri, ngjyrose pak më shumë diellin.

1. **Duaji të tjerët:** Ti mund të bësh një ndryshim të madh në jetën e tyre! Krishti ka dashuri për ta, prandaj përpiku t'ua tregosh atyre atë dashuri.

**Kush:** \_\_\_\_\_

2. **Fal:** Nëse dikush të lëndon, përpiku t'i shohësh gjërat nga pikëpamja e tij. Mund ta ndihmosh zemrën e tij të zbutet nëse e fal.

**Kush:** \_\_\_\_\_

3. **Nxiti:** Përgëzoji miqtë e tu për pikat e tyre të forta. Shiko më të mirën tek ata edhe nëse u duhet të përmirësohen. Kur je më i/e miri/a që mund të jesh, i ndihmon edhe ata!

**Kush:** \_\_\_\_\_

4. **Dëgjoje Frymën e Shenjtë:** Fjalët e tua mund ta ndryshojnë një situatë nga të keqe në një të mirë. Fryma e Shenjtë mund të të ndihmojë të dish çfarë të thuash dhe si të tregosh dashamirësi.

**Kush:** \_\_\_\_\_

5. **Mos bëj kurrë thashetheme:** Fjalët e pasjellshme mund të lëndojnë. Jepu mirëbesim të tjerëve dhe shpërfilli mendimet e këqija.

**Kush:** \_\_\_\_\_

6. **Përkrahi miqtë e tu:** Thjesht ardhja në një ngjarje sportive apo një shfaqjeje shkollore të një miku/mikeshe mund ta ndihmojë atë ta ndiejë dashurinë tënde.

**Kush:** \_\_\_\_\_

7. **Ftoji të tjerët të mësojnë rreth ungjillit:** Edhe nëse ata nuk e pranojnë atë që thua, ti e ke treguar se interesohesh aq sa ta ndash ungjillin me ta.

**Kush:** \_\_\_\_\_

8. **Bëhu mik/e me lloje të ndryshme njerëzish:** Të tjerët kanë shumë mirësi për të dhënë. Krishti i ndihmoi dhe i deshi të gjithë njerëzit pavarësisht nga gjithçka.

**Kush:** \_\_\_\_\_

# Misionarët e Parë

*Përdorini këto për të rrëfyer tregimet e historisë së Kishës!*



Samuel Smith



Hajrëm Smith



Parli P. Prat

***Pasi u organizua Kisha, Ati Qiellor donte nga të gjithë që të dëgjonin rreth ungjillit. Misionari i parë ishte vëllai i Jozef Smithit, Samueli. Edhe Hajrëmi, vëllai më i madh i Jozefit, u dha mësim të tjerëve rreth ungjillit. Një ditë, një njeri i quajtur Parli P. Prat i tha Hajrëmit se e kishte kaluar gjithë ditën duke lexuar Librin e Mormonit. Hajrëmi i dha atij më shumë mësim rreth Kishës dhe ai u pagëzua. Pastaj Parli shërbeu në një mision! Ai u bë një udhëheqës në Kishë.***

Gjej më shumë figura të shkrimeve të shenjta për historinë e Kishës në [liahona.lds.org](http://liahona.lds.org).



# Duke Menduar Për Jezusin

**Nga Lindsej Taner**

Bazuar në një ngjarje të vërtetë

**M**ia ishte e emocionuar. Kjo ishte Mhera e saj e parë në Kishë! Misionarët i treguan familjes së saj rreth kësaj Kishe. Ata vendosën të vinin.

Mia shikoi përreth. Ajo pa një mbulesë të bardhë mbi një tavolinë. Diçka ishte poshtë saj.

“Çfarë ka nën atë mbulesë?” pyeti Mia një nga misionaret.

Motra Hensën buzëqeshi. “Është sakramenti.”

*Sakramenti.* Kjo [po që] ishte një fjalë e madhe. Mia i kishte dëgjuar

misionarët t’i tregonin Mamit dhe Babit në lidhje me të. Por ajo nuk ishte e sigurt se çfarë ishte.

Të gjithë kënduan një këngë. Dy burra ngritën mbulesën e bardhë. Tabaka me bukë ishin poshtë saj! Mia i pa ata tek e ndanë bukën në copëza.

Pas këngës një burrë bëri një lutje. Burra të tjerë ia pasuan bukën të gjithëve.

“Buka na ndihmon të kujtojmë trupin e Jezusit”, pëshpëriti Motra Garsia.



Mia mori një copëz bukë. Ajo e përfytyroi Jezusin duke qëndruar përballë saj.

Pastaj vijoi një lutje tjetër. Burrat pasuan tabaka me gota të vogla me ujë.

“Uji na ndihmon të kujtojmë gjakun e Jezusit”, pëshpëriti Motra Garsia. “Ai vdiq për ne sepse Ai na do.”

Mia mori një gotë me ujë. Ajo mendoi se sa shumë Jezusi e donte atë. Ajo ndjeu sikurse Ai

po i jepte një përqafim të madh.

Më vonë Motra Hensën i dha Mias një figurë të vogël të Jezusit. “Ne e hamë bukën dhe e pimë ujin që të kujtojmë Jezusin dhe të pretojmë se do ta ndjekim Atë.” Ajo buzëqeshi. “Çfarë mendove për sakramentin?”

Mia pa figurën e Jezusit. Ajo kujtoi ndjenjën e ngrohtë që pati. Ajo buzëqeshi. “Ishte i mrekullueshëm! Unë e dua Jezusin.” ■

*Autorja jeton në Kaliforni të SHBA-së.*

# Jezusi Na Dha Sakramentin

Nga Kim Ueb Raid




Jezusi e dinte që koha e Tij në tokë thuajse po i afrohej fundit. Ai i mbledhi Apostujt e Tij së bashku për Darkën e Fundit. Ai u dha atyre sakramentin dhe u kërkoi që ta kujtonin gjithmonë Atë.



Jezusi shkoi në një kopsht për t'u lutur. Ai vuajti për të gjitha mëkatet dhe gjërat trishtuese në jetën e çdo personi. Më pas Ai vdiq në kryq dhe u varros në një varr.

Mëngjesin e së dielës pasi Jezusi vdiq, disa gra erdhën te varri. Guri te dera ishte rrokullisur dhe varri ishte bosh! Ku ishte Jezusi?



Ai ishte përsëri i gjallë! Maria Magdalena pa Jezusin. Ai i vizitoi Apostujt e Tij në mënyrë që ata të ishin gati të jepnin mësim ungjillin pasi Ai të kthehej në qiell.



Kur marr sakramentin, unë kujtoj Jezusin. Unë kujtoj që Ai jetoj dhe vdiq, dhe u ringjall për mua që unë të mund të jetoj përsëri! ■





# Zambakët e Pashkës



Zambakët e bardhë dhe të bukur të Pashkës mund të na kujtojnë ditën e mrekullueshme kur Jezusi u ringjall. Në këtë figurë janë fshehur pesë zambakë të bardhë. Sa herë të gjeni një zambak, thoni një gjë që keni mësuar rreth Jezusit.





**Nga Plaku  
Brus R. Mek-Konki  
(1915–1985),**

i Kuorumit të  
Dymbëdhjetë  
Apostujve

## FUQIA E PERËNDISË

*Besimi është fuqi dhe fuqia është priftëri.*

**P**erëndia është Perëndi ngaqë Ai është mishërimi i gjithë besimit dhe gjithë fuqisë, dhe gjithë priftërisë. Jeta që Ai jeton, quhet jetë e përjetshme.

Dhe shkalla në të cilën ne bëhemi si Ai është shkalla në të cilën ne e fitojmë besimin e Tij, marrim fuqinë e Tij dhe e ushtrojmë priftërinë e Tij. Dhe kur ne të jemi bërë si Ai në kuptimin e plotë dhe të vërtetë [të fjalës], atëherë edhe ne do të kemi jetë të përjetshme.

Besimi dhe priftëria shkojnë krahas krahas. Besimi është fuqi dhe fuqia është priftëri. Pasi fitojmë besim, ne marrim priftërinë. Më pas, nëpërmjet priftërisë, ne rritemi në besim derisa, duke pasur gjithë fuqinë, ne bëhemi si Zoti ynë.

Koha jonë këtu në vdekshmëri është veçuar si një kohë prove dhe testimi. Është privilegji ynë ndërsa jemi këtu [në tokë] që ta përsosim besimin tonë dhe të rritemi në fuqinë e priftërisë. . . .

Priftëria e shenjtë bëri më shumë për t'i përsosur njerëzit në kohën e Enokut sesa në ndonjë kohë tjetër. E njohur atëherë si urdhri i Enokut (shih DeB 76:57), ishte fuqia me anë të së cilës ai dhe populli i tij u ngritën në



qie. Dhe ata u ngritën në qiell ngaqë patën besim dhe e ushtrojnë fuqinë e priftërisë.

Ishte me Enokun që Zoti bëri një besëlidhje të përjetshme se të gjithë ata që e merrnin priftërinë, do të kishin fuqi, nëpërmjet besimit, për t'i qeverisur dhe kontrolluar të gjitha gjërat në tokë, për të sfiduar ushtritë e kombeve dhe për të qëndruar në lavdi dhe ekzaltim përpara Zotit.

Melkizedeku ishte një njeri i një besimi të tillë “dhe populli i tij solli drejtësi dhe fitoi qiellin, dhe kërkoi qytetin e Enokut” (Përkthimi prej Joseph Smith-it, Zanafilla 14:34). . . .

Çfarë, pra, është doktrina e priftërisë? Dhe si duhet të jetojmë ne si shërbëtorë të Zotit?

Kjo doktrinë është që Perëndia, Ati ynë, është një qenie e përlëvdur, e përsosur dhe e ekzaltuar, i cili ka gjithë

pushtetin, gjithë fuqinë dhe gjithë sundimin, i cili i di të gjitha gjërat dhe është i pafundëm në të gjitha cilësitë e Tij, dhe që jeton në një njësi familjare.

Është që Ati ynë i Amshuar e gëzon këtë status të lartë lavdie dhe përsosurie, dhe fuqie ngaqë besimi i Tij është i përsosur dhe priftëria e Tij është e pafundme.

Është që priftëria është vetë emri i fuqisë së Perëndisë dhe, nëse duam të bëhemi si Ai, ne duhet ta marrim dhe ushtrojmë priftërinë ose fuqinë e Tij ashtu si Ai e ushtron atë. . . .

Është që ne kemi fuqi, me anë të besimit, për t'i qeverisur dhe kontrolluar të gjitha gjërat, si tokësore edhe shpirtërore; për të kryer mrekulli dhe për ta përsosur jetën; për të qëndruar në praninë e Perëndisë dhe për të qenë si Ai ngaqë e kemi fituar besimin e Tij, përsosuritë e Tij dhe fuqinë e Tij, apo me fjalë të tjera, plotësinë e priftërisë së Tij.

Kjo, pra, është doktrina e priftërisë, mbi të cilën nuk ka dhe nuk mund të ketë ndonjë gjë më të madhe. Kjo është fuqia që ne mund të fitojmë nëpërmjet besimit dhe drejtësisë. . . .

Me të vërtetë ka fuqi në priftëri – një fuqi të cilën ne kërkojmë ta marrim për ta përdorur, një fuqi për të cilën ne lutemi me devotshmëri që të qëndrojë mbi ne dhe mbi pasardhësit tanë përgjithmonë. ■

*Nga një fjalim në sesionin e përgjithshëm të priftërisë të titulluar “The Doctrine of the Priesthood” [“Doktrina e Priftërisë”], Ensign, maj 1982, f. 32–34; gërmëzimi i standardizuar.*



**UNË KAM EDHE DELE TË TJERA,  
NGA ELSPETH JANG**

Zoti i ngritur vizitoi “delet e tjera” të Tij (3 Nefi 15:21) në Amerikë dhe tjetërkund. Nefitët “. . . ndien gjurmët e gozhdëve në duart e tij dhe në këmbët e tij; dhe këtë e bënë duke vajtur një nga një, derisa ata të gjithë shkuan përpara dhe panë me sytë e tyre dhe ndien me duart e tyre, dhe mësuuan me siguri, dhe dëshmuuan se ishte ai, për të cilin ishte shkruar nga profetët, se do të vinte.” (3 Nefi 11:15).

# Gjithashtu në Këtë Botim

## PËR TË RINJTË NË MOSHË MADHORE

### Të Kuptuarit e **Bekimit Tuaj Patriarkal**

Bekimet patriarkale nuk na thonë gjithçka që do të ndodhë në jetën tonë, por ato sigurojnë një hartë vetjake e cila mund të na udhëheqë për te lumturia e madhe që Ati Qellor ka ruajtur për secilin prej nesh.



f. 44

## PËR RININË



f. 58

### ATA E PANË **ATË**

Ata qenë dëshmitarë të Krishtit të ngritur.  
Si mund të qëndrojmë ne si dëshmitarë sot?

## PËR FËMIJËT

### Jezusi Na Dha Sakramentin

Ne e marrim sakramentin çdo javë. Por a e dinë fëmijët tuaj pse?



f. 76



KISHA E  
**JEZU KRISHTIT**  
E SHENJTORËVE TË  
DITËVE TË MËVONSHME